



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 466 Akti

Nr. 553 Vendimi
Tiranë, më 18.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 12.7.2022 dhe 18.7.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elsa Kareçi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Elsa Kareçi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Elsa Kareçi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi ndonjë gjendje konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Me vendimin nr. 2, datë 15.6.2022, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
6. Në datën 16.6.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 6.7.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 5.7.2022, subjekti i rivlerësimit, dërgoi me anë të postës elektronike kërkesë për zgjatje të afatit për paraqitjen e parashtrimeve për një afat 10-ditor, duke qenë se është në pritje të marrjes së informacionit nga shtetasi P. Sh. dhe disa përgjigjeve nga institucione të ndryshme shtetërore.
8. Me vendimin nr. 3, datë 6.7.2022, trupa gjykuese vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit për zgjatjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve me 10 ditë, duke qenë se kërkesat e saj, drejtuar institucioneve të ndryshme, mbajnë një datë shumë më të vonë se data e dërgimit të rezultateve të hetimit. Gjithashtu, trupa gjykuese informoi subjektin se përgjigjet e institucioneve përkatëse mund ti paraqesë pranë Komisionit deri/edhe në seancën dëgjimore.
9. Në datat 7 dhe 8.7.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike dhe në formë fizike shpjegimet e saj dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht.

10. Pas shqyrtimit të shpjegimeve e provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 7.7.2022, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

11. Në datën 12.7.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

13. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

VLERËSIMI I PASURISË

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 28.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Elsa Kareçi, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Elsa Kareçi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument

ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

19. Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit

20. Tokë bujqësore, marrë me aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë 20.2.1997, e ndodhur në fshatin ***, Durrës. Në bazë të ligjit nr. 7501 "Për tokën". Sipërfaqe 18.000 m². Pjesa takuese: 16.6 %. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

20.1. Në lidhje me këtë pasuri, nga aktet në dosje¹, rezultoi se:

- Me AMTP-në nr. ***, datë 20.2.1997, i është dhënë në pronësi familjes së shtetasit S. A. K. (babai i subjektit) tokë bujqësore me sip. 18.000 m², në fshatin ***, Durrës. Subjekti ka qenë pjesë e gjendjes familjare në datën 1.8.1991.

- ASHK-ja Durrës konfirmoi se pasuria ndodhet në z. k. ***, fshati ***, e cila është zonë kadastrale e paazhornuar².

- Kjo pasuri është deklaruar në DPFD-në e vitit 2003, si dhe në DPV-në e vitit 2004 njësoj si në deklaratën *Vetting*, me të njëjtën pjesë takuese dhe burim krijimi, ligjin nr. 7501.

20.2. Në lidhje me të ardhura nga toka bujqësore, rezulton se si të tilla janë deklaruar: në DPV-në i vitit 2004, në shumën 300.000 lekë; në DPV-në vitit 2011, në shumën 200.000 lekë; në DPV-në e vitit 2012, në shumën 50.000 lekë; në DPV-në e vitit 2013, në shumën 45.000 lekë; dhe në DPV-në e vitit 2014, në shumën 100.000 lekë.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore.

- Gjatë hetimit subjekti ka informuar se³ për të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore nuk disponon fatura dhe se ka qenë, pikërisht, mosdisponimi i këtyre faturave dhe dokumentacionit justifikues për krijimin e të ardhurave, arsyeja e mosdeklarimit të tyre në deklaratën *Vetting*.

- Subjekti ka vërtetuar pagimin e taksës së tokës⁴, por nuk vërtetoi të ardhura në vlera monetare nga toka bujqësore dhe, për këto arsye, ato nuk janë përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

20.3. Në lidhje me ndërtime apo investime të kryera mbi këtë pasuri rezultoi se:

- ASHK-ja⁵ ka informuar se subjekti dhe personat e lidhur nuk figurojnë aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal për përfshirje në procesin e legalizimit.

¹Shihni aktet në aneksin 4/2 dhe 27 në dosjen e ILDKPKI-së, deklaratat periodike vjetore dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit 2 dhe 3 në dosjen e Komisionit.

²Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.12.2021, në dosjen e Komisionit.

³Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. *** prot., datë 10. 2.2022, në dosjen e Komisionit.

⁴Shihni vërtetim nga Njësia Administrative Sukth, datë 7.2.2022 dhe vërtetim nga Bashkia Durrës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore, nr. *** prot., datë 8.02.2022, në dosjen e Komisionit.

⁵Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga ASHK, Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-në e vitit 2008 në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” është deklaruar investim familjar në vreshtari (pa deklaruar vlerën e këtij investimi), me burim kredinë në “Raiffeisen Bank”. Ndërsa në rubrikën “detyrimet financiare”, të po këtij deklarimi, subjekti ka deklaruar kredi personale në “Raiffeisen Bank”, datë 30.5.2008, në shumën 1.000.000 lekë, me afat 84 muaj. Subjekti ka sqaruar se ka investuar 70% të kësaj kredie, duke ia dhënë babait të saj për kryerjen e punimeve dhe blerjen e fidanëve⁶.

- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* investimin e kryer në këtë pasuri.

20.4. Në lidhje me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, rezultoi se:

- Me kontratë kredie të datës 30.5.2008⁷, subjekti ka përfituar një kredi në vlerën 1.000.000 lekë, me qëllim përdorimin për arsye personale. Subjekti e ka deklaruar këtë kredi në DPV-në 2008-2009.

- Në DPV-në e vitit 2010, në rubrikën “Detyrime financiare”, ka deklaruar *mbyllje e kredie personale nga i fejuari*.

- Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në datën 23.3.2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kredisë nga i fejuari, me burim të ardhura nga aktiviteti i tij që nga viti 1994. Gjatë procesit subjekti ka sqaruar⁸ se në datën 27.12.2010 ka shkuar në bankë së bashku me të fejuarin dhe ka derdhur në llogari shumën 802.000 lekë me përshkrim “derdhje për mbyllje kredie”. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se në datën 27.12.2010, subjekti ka depozituar shumën 802.000 lekë për shlyerjen e parakohshme të kredisë, e cila është mbyllur më 28.12.2010.

- Duke qenë se në përfundim të hetimit administrativ, ka pasur të dhëna të cilat tregonin se subjekti dhe ish-bashkëjetuesi kanë qenë në një marrëdhënie që nga viti 2009, pavarësisht se bashkëjetesa me z. E. Sh. është deklaruar në vitin 2012 (trajtuar hollësisht në vijim), deri në momentin e njoftimit të rezultateve të hetimit, subjekti dhe z. E. Sh. janë analizuar së bashku përgjatë vitit 2010, vit kur është shlyer kredia. Nga analiza financiare e këtij viti pasqyruar në tabelën vijuese, duket ata nuk kanë pasur të ardhura për shlyerjen e parakohshme të kredisë⁹.

Përshkrimi	2010
PASURI	10 082 104
Blerë tokë me sip. 2.000 m ² , ***, Tiranë, vlera 30.000 euro, gusht 2010, nga z. E.Sh.	4 164 300
Auto. tip “Grand Cherokee Jeep”, targa ***, blerë më 12.4.2010, nga z. E. Sh.	416 430
Blerë auto. tip “Daimler Chrysler”, targa ***, blerë më 21.5.2010, nga z. E. Sh.	832 860
<i>Ndryshimet e likuiditeteve</i>	<i>4 668 514</i>
Gjendja e likuiditeteve	5 182 821
TË ARDHURA dokumentuar	1 942 116
Të ardhura të subjektit nga paga	982 116
Të ardhura të bashkëjetuesit	960 000
SHPENZIME	1 478 253
Shpenzime jetese	273 240
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	0
Shpenzime transporti të brendshëm	165 071

⁶Për këtë arsye, shuma 700.000 lekë ose 70% e kredisë së marrë nga subjekti, është konsideruar si shpenzim në analizën e saj financiare.

⁷Shihni dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, në dosjen e Komisionit.

⁸Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. *** prot., datë 10.02.2022, në dosjen e Komisionit.

⁹Kjo pamundësi financiare vjen si rezultat i blerjes dhe krijimit të disa pasurive prej bashkëjetuesit, E. Sh. gjatë vitit 2010 si: tokë arë në *** 30.000 euro; automjet tip “Jeep”, në vlerën 3.000 euro, automjet tip “Daimler Chrysler” në vlerën 6.000 euro, si dhe të dy depozitave bankare të z. E. Sh., në “Intesa Sanpaolo Bank” të krijuara gjatë vitit 2010, të cilat më 31.12.2010 arrinin në vlerat rreth 3.000.000 lekë dhe rreth 10.000 euro.

Paguar kredia në “Raiffeisen Bank”	1 039 942
Mundësia për Kursime	-9 618 241

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se, pasi kredia bankare është mbyllur në vitin 2010 me kontribut të të fejuarit, ajo e ka shlyer z. E. Sh., duke i kthyer shumën 800.000 lekë, në vitin 2012, nëpërmjet tërheqjeve bankare në “Raiffeisen Bank”¹⁰ dhe “Credins Bank”¹¹. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare, në “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank”, ka rezultuar se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe se shumatat e tërhequra janë me burime të ligjshme nga pagat, duke përfshirë dhe pagat e prapambetura të fituara me vendim gjyqësor. Pra, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i kthyer bashkëjetuesit shumën 800.000 lekë, në vitin 2012.

20.5. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje pasurinë objekt verifikimi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente për të provuar të kundërtën konstatimeve, duket se: (i) subjekti nuk provoi me dokumente ligjshmërinë e të ardhurave nga shfrytëzimi i tokës bujqësore të deklaruara, ndër vite; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat e përfituara nga përdorimi i tokës bujqësore dhe investimin e kryer në vreshtari në vitin 2008; (iii) subjekti dhe bashkëjetuesi nuk kanë pasur mundësi financiare për të paguar në vitin 2010 shumën prej 800.000 lekësh, për të mbyllur kredinë në “Raiffeisen Bank”, për shkak të një balance negative në shumën 9.618.241 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

20.6. Në parashtrimet e saj, duke iu referuar dokumenteve shkresore të administruara gjatë hetimit, si dhe faktit që mbi këtë tokë është kryer investim në vreshtari, subjekti ka pretenduar se toka bujqësore është shfrytëzuar dhe ka gjeneruar të ardhura. Por, subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhura nga toka bujqësore, ndërkohë që ka pretenduar që në analizën financiare duhet t’i reduktohen shpenzimet e jetesës. Në lidhje me këtë pretendim, referuar praktikës së Komisionit apo edhe të Kolegjit¹² në raste të ngjashme, në kushtet kur subjekti ka provuar përdorimin dhe investimin mbi tokën bujqësore në fshatin ***, Sukth, ku ajo dhe familja e saj kanë jetuar, si dhe pagesën e taksës mbi tokën, në përfundim Komisioni çmoi të bëjë reduktimin e shpenzimeve të jetesës në masën 22%¹³. Vlen të theksohet se ky reduktim nuk e afekton analizën financiare të subjektit gjatë periudhës që ka jetuar në familjen prindërore¹⁴.

20.7. Në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të të ardhurave nga bujqësia, sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka parashtruar se kjo ka ndodhur, pikërisht, për shkak të mosdisponimit të dokumentacionit justifikues për krijimin e këtyre të ardhurave. Ndërsa, investimin e kryer në vitin 2008 ka vlerësuar të mos e deklarojë, pasi kredia e marrë gjatë këtij viti për këtë investim është mbyllur në vitin 2010, duke mos qenë më si detyrim financiar deri në momentin e deklaratës *Vetting*.

¹⁰Në datën 6.6.2012 subjekti ka tërhequr shumën prej 397.790 lekësh nga llogaria e saj në “Raiffeisen Bank”, me burim të ardhurat e përfituara në formë dëmshpërblimi nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 7.5.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹¹Në datat 25.4.2012 dhe 16.7.2012 ka tërhequr përkatësisht shumatat prej 700.000 lekë dhe 500.000 lekë nga llogaria e pagës në “Credins Bank”, me burim të ardhurat nga pagat.

¹²Vendimet e Komisionit nr. ***, datë 26.2.2020; nr. ***, datë 22.4.2021; nr. ***, datë 26.7.2019; si dhe vendimin nr. ***, datë 12.7.2021, të Kolegjit.

¹³Kjo përqindje përfaqëson vlerën mesatare të nëngrupeve “perimet” dhe “frutat”, bazuar në Anketat e Buxhetit të familjes, për vitet 2006 (Anketa e 1-rë) deri në vitin 2011.

¹⁴Me përjashtim të vitit 2010, i cili pa këtë reduktim do të kishte një balancë negative në shumën 174.940 lekë, balancë e cila përsëri nuk mund të konsiderohet shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

20.8. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi të bazuara argumentet e subjektit, sidomos në kushtet kur edhe pse investimi i kryer i përket një pasurie të familjes së origjinës, subjekti ka kryer deklarime të sakta e korrekte në DPV, në lidhje me këtë investim, të cilat janë në koherencë të plotë me: (i) deklaratimet gjatë pyetjes në ILDKPKI në vitin 2016; (ii) deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit; (iii) dokumentet shkresore të administruara që nga momenti i marrjes së kredisë në vitin 2008 deri në shlyerjen e parakohshme në vitin 2010, me ndihmesën e të fejuarit. Gjithashtu, u vërtetua se: (i) burimi i përdorur për investimin në vreshtari, me burim të ligjshëm (kredia e marrë pranë “Raiffeisen Bank”); (ii) subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për t’i kthyer z. E. Sh. shumën 802.000 lekë, me të cilën ishte shlyer kjo kredi; (iii) subjekti apo familja prindërore e saj, nuk kanë kryer investime të mëtejshme në pasurinë objekt verifikimi, përveç investimit në vreshtari në vitin 2008. Bazuar në këto fakte e rrethana, mosdeklarimi nga ana e subjektit në deklaratën *Vetting* i të ardhurave nga toka bujqësore dhe investimit të kryer në vreshtari në vitin 2008, në një pasuri të familjes së origjinës, përbëjnë pasaktësi të llojit formal që nuk shoqërohen me pasoja dhe, për rrjedhojë, nuk mund të penalizojnë subjektin, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁵.

20.9. Në lidhje me balancën negative të vitit 2010, kur është shlyer kredia në mënyrë të parakohshme me ndihmesë të ish të fejuarit, subjekti ka pretenduar se analiza e Komisionit duhet të kufizohet vetëm në mundësinë financiare të z. E. Sh., për krijimin e shumës 802.000 lekë dhe jo në vlerësimin e gjithë pasurisë së tij, duke sjellë në vëmendje edhe praktikën e Kolegjit¹⁶. Subjekti ka argumentuar se gjatë vitit 2010 shtetasi E. Sh. ka pasur të ardhura nga paga në shumën 960.000 lekë dhe se ai ka tërhequr nga shoqëria “****” sh.p.k., shumën prej 1.024.659 lekësh¹⁷. Sipas subjektit të ardhurat e mësipërme, e mbulojnë shumën prej 802.000 lekësh.

20.10. Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni vlerësoi se është e vërtetë që të ardhurat nga paga e z. E. Sh. për vitin 2010 janë në shumën 960.000 lekë, por nuk pranon argumentin që shuma 1.024.659 lekë të jetë tërhequr prej tij si ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., pasi ky është një interpretim i gabuar i pasqyrave financiare të vitit 2010 nga ana e subjektit. Për më tepër, gjatë vitit 2010 z. E. Sh. ka krijuar depozita personale në shuma të konsiderueshme, të cilat nuk mbulojnë me pagën e tij si i vetmi burim të ardhurash të ligjshme, fakt i cili nuk mund të neglizhohet nga Komisioni. Për këto arsye, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se z. E. Sh. nuk ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme shumën 802.000 lekë përdorur me qëllim shlyerjen e parakohshme të kredisë së saj në “Raiffeisen Bank”, në dhjetor të vitit 2010.

20.11. Nga ana tjetër, Komisioni vlerësoi të bazuar pretendimin e subjektit se ajo nuk mund të analizohet së bashku me z. E. Sh., në vitin 2010, pasi bashkëjetesa reale me të ka filluar në fund të vitit 2011 dhe është konsoliduar në janar të vitit 2012 (trajtuar hollësisht në paragrafët nr. 63 deri 65 të këtij vendimi). Në përfundim të procesit, subjekti është analizuar me familjen e origjinës deri në fund të vitit 2011 dhe nga janari i vitit 2012 është analizuar me ish-bashkëjetuesin E. Sh. Në këto kushte, u rishikua analiza financiare e subjektit për vitin 2010

¹⁵Shihni vendim nr. 22/2019 dhe vendim nr. 10, datë 14.4.2022, të Kolegjit .

¹⁶Vendimi nr. 15/2018, sipas të cilit Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur.

¹⁷Subjekti e argumenton këtë veprim duke analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., për vitin 2010 dhe konkretisht me zërin “Llogari/kërkesa të tjera të arkëtueshme”, në aktivin e bilancit të këtij viti, në cilin pasqyrohet shuma prej 1.024.659 lekësh, shumë e cila sipas subjektit përfaqëson tërheqjet e pronarit në vitin 2010.

dhe balanca negative e këtij viti, e cila vinte për shkak të krijimit të pasurive të z. E. Sh., ndryshoi nga -9.618.241 lekë në +9.155 lekë.

21. *Autoveturë tip “Audi”, blerë me kontratën nr. ***, datë 15.05.2008. Ky mjet nuk është targuar dhe përdorur nga ana ime për shkak se rezultoi në gjendje jo të mirë teknike dhe jashtë përdorimit. Burimi i blerjes, të ardhura nga shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz”. Vlera e blerjes: 200.000 lekë. ILDKPKI-ja ka konstatuar se mjeti nuk është targuar dhe është jashtë sistemit.*

21.1. Në lidhje me këtë pasuri, nga aktet në dosje¹⁸, rezultoi se:

- Me kontratë shitblerje automjeti, datë 15.5.2008, subjekti ka blerë nga shtetasi B. D. B. autoveturë tip “Audi”, viti 1997, me targa ***, në çmimin 200.000 lekë, ku pala blerëse deklaroi se ka marrë në dorëzim automjetin dhe se nuk ka asnjë lloj pretendimi për gjendjen teknike të këtij automjeti. Nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara¹⁹ nga subjekti i rivlerësimit dhe as përfshirje të shtetasit B. B. në veprimtari të krimin të organizuar²⁰.

- Mjeti është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2008, por pa deklaruar burimin e krijimit.

- Në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 23.3.2016, subjekti ka deklaruar se ky mjet është i pa regjistruar në DPSHTRR, pasi që nga momenti i blerjes kishte një defekt, që nuk u arrit të riparohet dhe është jashtë përdorimit. Mosregjistrimi i mjetit konfirmohet edhe nga DPSHTRR-ja.

- Të njëjtin qëndrim ka mbajtur subjekti edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ku ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me gjendjen teknike të mjetit, si dhe ka paraqitur deklaratë noteriale me datë 10.12.2021, të shtetasit N. B., i cili konfirmon deklaratet e subjektit.

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mospërputhjen e deklaratave, lidhur me gjendjen e mjetit me përshkrimin në kontratën e shitblerjes, në të cilën subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë lloj pretendimi mbi gjendjen teknike të automjetit. Në parashtrimet e saj, subjekti deklaroi se kjo mospërputhje ka të bëjë me faktin se kontratat janë tip të hartuara nga noterët dhe se ka qenë, pikërisht, gjendja teknike e automjetit që ka sjellë blerjen me çmim 200.000 lekë, pasi bisedat kishin qenë për vlerën 250.000 lekë.

21.2. Në lidhje me burimin e krijimit, u konstatua se:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga shitja e një mjeti tip “Mercedes-Benz”, ndërsa në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave” ka deklaruar: *“Të ardhura nga shitja e mjetit ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, me kantatën e nr. ***, datë 13.4.2008, shitur më shtrënjtë se është blerë, për shkak të shërbimeve të kryera këtij mjeti. Shuma: 500.000 lekë”*.

- Shitja e mjetit “Mercedes-Benz”, me targa ***, është kryer me kontratë nr. ***, datë 13.4.2008²¹ (pra, një muaj më parë se blerja e mjetit objekt verifikimi më 15.5.2008), sipas së cilës, subjekti i ka shitur këtë mjet shtetasit I. V. N., në çmimin 500.000 lekë. Kjo shitje është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2008.

¹⁸Shihni aneks 4/3 dhe 30 në dosjen e ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 8.5.2020, të DPSHTRR-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dosjen e Komisionit.

²⁰Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.12.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

²¹Shihni aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Në lidhje me origjinën e mjetit “Mercedes-Benz” të sipërpërmendur, u vërtetua se me kontratën shitblerje automjeti nr. ***, datë 16.8.2004, subjekti ka blerë nga shtetasi A. L., mjetin “Mercedes-Benz”, i cili ka qenë me targa ***, në shumën 300.000 lekë. Blerja e këtij automjeti është deklaruar në DPV-në e vitit 2004. Siç vërehet, subjekti e ka blerë mjetin në çmimin 300.000 lekë, në vitin 2004 dhe e ka shitur në çmimin 500.000 lekë, në vitin 2008. Në lidhje me këtë fakt në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë sqarime duke informuar se në vitin 2007 i ka bërë disa shërbime automjetit në vlerën 200.000 lekë dhe se duke qenë se nuk ka fituar në shitjen e këtij automjeti, pasi lekët ishin shpenzuar për dhënien e një pamjeje të re, nuk ka paguar tatim mbi fitimin. Ndërkohë, ka sqaruar se qëllimi i saj nuk ka qenë shitja e automjetit, përkundrazi, bëri të gjitha rregullimet e duhura për ta mbajtur për vete, por duke qenë se në dhjetor të vitit 2007 u vendos transferimi në Tiranë, përdorimi i këtij automjeti nuk ishte më i përshtatshëm dhe, për këtë arsye, vendosi ta shiste. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur dy deklarata të dy shtetasve të cilët konfirmojnë deklaratimet e saj, por subjekti nuk ka vërtetuar vlerën konkrete të shpenzimeve. Në këto kushte, të ardhurat nga shitja e automjetit në analizën financiare të vitit 2008, janë konsideruar në vlerën 300.000 lekë dhe jo në vlerën 500.000 lekë, sikurse është përcaktuar në kontratën e shitblerjes.

- Për të vërtetuar ligjshmërinë e shumës 300.000 lekë, që është edhe çmimi i blerjes së mjetit me targa ***, në vitin 2004, Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën 16.08.2004, sipas së cilës subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhur të ligjshme për të blerë mjetin.

21.3. Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan problematika në lidhje me mjetin objekt verifikimi. Sa i takon mosdeklarimit të burimit në DPV-në e vitit 2008, në parashtrime, subjekti deklaroi se kjo është një harresë gjatë plotësimit të kësaj deklaratë. Sipas saj, ajo e ka shitur automjetin tip “Mercedes-Benz”, në prill të vitit 2008 dhe pas një muaji me ato para ka blerë automjetin tip “Audi”, ndërkohë që, ka qenë konsistente në deklaratimet e saj si pranë ILDKPKI-së edhe gjatë procesit. Në vlerësim të këtyre rrethanave, por referuar edhe praktikës së Kolegjit²², kur pasaktësitë, ndër vite, nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri financiare, mosdeklarimi i burimit të krijimit në DPV-në e vitit 2008 nuk mund të jetë penalizues për subjektin e rivlerësimit.

22. *Blerë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, me kontratën nr. ***, datë 16.8.2004. Më pas i targuar nga ana ime ***. Burimi i blerjes, të ardhura nga paga e kursime familjare. Vlera e blerjes: 300.000 lekë. 0%. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

Ky automjet, pavarësisht se është shitur në vitin 2008, është deklaruar nga subjekti në rubrikën e pasurive në deklaratën *Vetting*, ku është deklaruar edhe si burim për blerjen e automjetit të trajtuar në paragrafin 21 të këtij vendimi.

23. *Blerë mobilie të përdorura nga kunati, shtetasi P. Sh. në nëntor të vitit 2015. Burimi i blerjes, para të marra me kredi nga “Raiffeisen Bank”, datë 28.10.2015. Vlera: 750.000 lekë. 100%. ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni ligjor justifikues lidhur me blerjen e mobileve.*

23.1. Në lidhje me këtë pasuri/shpenzim, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar *mobile të përdorura, blerë nga shtetasi P.Sh., në shumën 800 000 lekë.* Në rubrikën “Detyrime financiare”, të po këtij deklarimi, është deklaruar *kredi e marrë në “Raiffeisen Bank”, më 28.10.2015, në shumën 1.550.000 lekë, me afat 84 muaj, qëllimi i kredisë mbyllje overdrafti dhe arredim shtëpie.*

²²Shihni vendimet nr. 22/2019 dhe nr. 10, datë 14.4.2022, të Kolegjit.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime për mobilim në vlerë 750.000 lekë, në nëntor të vitit 2015. Burimi i blerjes, kredi e marrë në ‘Raiffeisen Bank’, në tetor 2015”.

- Nuk ka një dokument shkresor që të vërtetojë blerjen e mobileve nga kunati i subjektit P. Sh., por referuar deklarimeve të subjektit, marrëdhëniet familjare, si dhe faktit që subjekti e ka deklaruar këtë fakt në DPV-në për vitin 2015, nga ana e Komisionit, mungesa e një akti shkresor nuk u vlerësua si një problematikë.

- Ka një mospërputhje në deklaratimet e subjektit, në lidhje me vlerën e blerjes së mobileve, pasi në DPV-në e vitit 2015 deklarohet në shumën 800.000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 1, në shumën 750.000 lekë. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mospërputhjen e vlerave, subjekti duke konfirmuar²³ blerjen në vlerën 800.000 lekë në nëntor të vitit 2015, si dhe ka sqaruar se kjo ka ardhur për faktin në janar të vitit 2016 ajo i ka kthyer kunatit një mobilie, e cila nuk përshtatej me vendin ku ajo e kishte vendosur dhe, për pasojë, ai i kishte kthyer shumën prej 50.000 lekë. Për këto arsye, në deklaratën *Vetting* është deklaruar shuma prej 750.000 lekësh. Ndërkohë që, ka sqaruar se mosdeklarimi i të ardhurës nga kthimi i vlerës së mobileve në DPV-në e vitit 2016 ka qene një pasaktësi e saj.²⁴ Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka deklaruar se pavarësisht marrëdhëniet aktuale me ish-kunatin (pas zgjidhjes së martesës me shtetasin E. Sh.), me shumë vështirësi ka mundur të sigurojë deklaratën noteriale në datën 9.12.2021 lëshuar nga shtetasi P. Sh., në të cilën ai konfirmon të gjitha deklaratimet e subjektit, duke deklaruar, gjithashtu, se shumat janë likuiduar *cash*. Në përfundim, shpenzimi për mobilimin është konsideruar në shumën 800.000 lekë, duke marrë në cilësinë e provës deklarimin e subjektit të kryer në DPV-në e vitit 2015.

23.2. Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave, që kanë shërbyer për blerjen e këtyre mobileve, subjekti ka deklaruar një kredi të marrë në “Raiffeisen Bank”, datë 28.10.2015. Nga verifikimi i akteve në dosje²⁵, konstatohet se me kontratën e kredisë së datës 28.10.2015, subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi në cilësinë e kredimarrëses dhe dorëzanës L. B. (motra e bashkëjetuesit E. Sh.) ka marrë në “Raiffeisen Bank”, kredi në shumën 1.550.000 lekë, për arsye personale. Disbursimi i kësaj kredie është bërë në datën 28.10.2015, vërtetuar me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”. Kjo kredi është deklaruar saktësisht nga subjekti në DPV-të 2015 dhe 2016, duke dhënë sqarime mbi shumën e shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për shlyerjen e kësaj kredie, nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e saj.

Detyrimet financiare

24. *Overdraft nga “Credins Banka”, në vlerën 450.000 lekë disbursuar në datën 27.1.2015, me afat 12-mujor. Ky overdraft është mbyllur në datën 30.10.2015, shuma e detyrimit 0 (zero) lekë.*

25. *Overdraft nga “Credins Banka”, datë 11.12.2015, në shumën 200.000 lekë, shtuar overdraftit në datën 25.3.2016, bëhet 350.000 lekë, shtuar overdraftit, datë 14.6.2016, bëhet 500.000 lekë. Shuma e detyrimit: 499.553 lekë.*

²³Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

²⁴Shuma prej 50.000 lekësh, nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme në DPV-në për vitin 2016.

²⁵Shihni aktet në aneksin 4/8 në dosjen ILDKPKI-s` dhe dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr.1, në dosjen e Komisionit.

Me shkresën nr. *** prot., datë 12. 4.2022, “Credins Bank” ka përcjellë lëvizjet e llogarisë të subjektit në këtë bankë, nga ku evidentohet se deklaratimet e subjektit në lidhje me dy *overdraftet* e sipërpërmendura janë të sakta.

26. *Kredi e marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 28.10.2015, në shumën 1.550.000 lekë, me afat 84 muaj. Qëllimi i marrjes së kredisë, mbyllje overdraft (i datës 27.1.2015 “Credins Banka”) dhe arredim shtëpie. Shuma e detyrimit të mbetur 1.355.020.91 lekë.* Trajtuar në paragrafin nr.23.2. Sipas informacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se deklaratimet e subjektit janë të sakta²⁶.

27. Në deklaratën *Vetting* në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 7.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Shuma: 981.518 lekë*”.

Me qëllim verifikimin e këtij deklarimi gjatë hetimit administrativ, u evidentua se:

- Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e prapambetur nga Prokuroria e Rrethit Kavajë fituar me vendim gjyqësor, në shumën 981.500 lekë.

- Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 23.3.2016, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është derdhur nga Prokuroria e Përgjithshme me dy këste, në datën 16.3.2011, në shumën 581.518 lekë, në “Credins Bank” dhe në datë 9.2.2011 në shumën 400.000 lekë në “Raiffeisen Bank”.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti informoi se bazuar në këtë vendim ka përfituar pagën për kohën e punës së kryer jashtë orarit në shumën 1.080.245 lekë dhe kthimin e pagës së ndaluar në shumën 10.331 lekë. Më tej, subjekti ka informuar se nga vlera totale është mbajtur tatimi dhe vlera *neto* është paguar dhe transferuar në llogarinë e saj në dy këste, përkatësisht: kësti i parë në shumën 400.000 lekë në “Raiffeisen Bank” dhe kësti i dytë në shumën 581.518 lekë në “Credins Bank”. Subjekti paraqiti, gjithashtu, vendimin nr. ***, datë 7.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas së cilit është vendosur detyrimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të paguajë pagën për kohën e punës së kryer jashtë kohës normale të punës për shërbimin e gatishmërisë, për periudhën maj 2004 – gusht 2006, për disa prokurorë, ndër të cilët, edhe për subjektin Elsa Kareçi, në shumën 1.080.245 lekë, si dhe kthimin e pagës së ndaluar në shumën 10.331 lekë.

- Në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua se subjekti ka qenë e saktë në deklarin e të ardhurës objekt verifikimi.

28. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën: “*Njësia Administrative Nr. ***, rruga ‘***’, Nr. *** Tiranë*”, e cila pas verifikimeve u vërtetua të jetë adresa e banimit të shtëpisë së ish-bashkëshortit të subjektit, z. E. Sh.

Konstatime të tjera në lidhje me subjektin e rivlerësimit

29. Në DPV-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar pasuritë: (i) *truall ndërtimi me sipërfaqe 400 m² blerë nga bashkia Sukth. Vlera: 128.000 lekë. Pjesa zotëruese: 25 %. Datë krijimi më 11.10.2004;* (ii) *apartament 1+1+ ambiente të tjera ndihmëse, blerë nga N. K. B. Vlera: 7649 lekë. Pjesa zotëruese: 1/6. Datë krijimi më 11.10.95.*

²⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit, ku, nga lëvizjet e llogarisë së subjektit ka rezultuar se pas disbursimit të kredisë prej 1.550.000 lekësh në datën 28.10.2015, shuma prej 468.200 lekë është transferuar nga kjo llogari në “Raiffeisen Bank” të “Credins Bank”, me përshkrimin “*kalim për mbyllje OD Elsa Kareçi*” dhe shuma 1.031.000 lekë është tërhequr cash nga subjekti.

Me qëllim evidentimin e çdo lidhjeje të subjektit dhe kontribute të saj në këto dy pasuri, të cilat u vërtetuan të jenë përfituar nga familja e saj e origjinës, nga ana e Komisionit, u kryen verifikimet si vijojnë:

29.1. Në lidhje me pasurinë “truall me sip. 400 m²”, u konstatua se:

- Në asnjë prej deklarimeve në vijim dhe as në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri, investime të kryera mbi të apo përdorimin e saj.
- Në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 23.3.2016²⁷, subjekti ka shpjeguar se arsyeja e deklaramit të këtyre pasurive ka qenë për shkak se në atë kohë ka qenë në një certifikatë me familjen dhe ka deklaruar gjithçka që ka qenë në emër të familjes, përfshirë dhe pjesët sipas përbërjes së familjes. Për truallin me sipërfaqe 400 m² ka paraqitur: (i) vendim nr. *** prot., nga Bashkia Sukth, për dhënie leje shesh ndërtimi, z. S. K., në bazë të vendimit nr. ***, datë 7.5.2003, të Këshillit Bashkiak Sukth, në sipërfaqen 400 m², për objekt me 2 kate mbi tokë; si dhe (ii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 11.10.2004, pagesë truall në shumën 128.000, nga z. S. K., për Bashkinë Sukth.
- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe nr. 3, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri nuk i përket asaj, por babait të saj, me të cilin ka qenë në të njëjtin trung në vitin 2004, kur e ka deklaruar. Subjekti i referohet shkresës zyrtare Drejtorisë Rajonale të Arkivit Shtetëror Sh**, Durrës²⁸, e cila ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 7.5.2003, të Këshillit të Bashkisë Sukth, sipas të cilit z. S. K. i është miratuar kërkesa për dhënien e truallit me sip. 400 m² për ndërtimin e një banese private (dokument i cili disponohej nga Komisioni), truall i paguar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 11.10.2004, në vlerën 128.000 lekë. Më tej, subjekti ka informuar se burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat familjare dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore.
- Në lidhje gjendjen juridike aktuale dhe investime të kryera në këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se pasuria nuk është zhvilluar, pretendim të cilin e ka vërtetuar me disa dokumente shkresore²⁹.
- Nga të gjitha provat e administruara, në përfundim të hetimit administrativ është vërtetuar që në truallin e blerë nga babai në vitin 2004 nuk ka ndërtim apo investim të kryer, përveç disa pemëve frutorë dhe se subjekti nuk u vërtetua të kishte të drejta pronësie apo reale përdorimi të kësaj pasurie në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* dhe jo vetëm. Por, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e paraqesë dokumente mbi gjendjen juridike aktuale të kësaj pasurie, për të cilën subjekti ka vijuar të deklarojë se zona për të cilën bëhet fjalë nuk është e azhonuar dhe se nuk disponon dokumente të tjera. Subjekti i referohet përgjigjes së ASHK-së Durrës, e cila me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë

²⁷Shihni shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, bashkëngjitur procesverbalit i datës 23.3.2016; vendim për dhënie leje shesh ndërtimi z. S. K., nr. *** prot., Bashkia Sukth, Durrës, në bazë të kërkesës, datë 10.3.2003, numri i kateve mbi tokë, mandatarkëtimi nr. ***, datë 11.10.2004, pagesë truall 128.000 lekë; kontratë shitblerje, datë 11.10.1995, me shitës N. K. B. dhe blerës S. A. K., P. Gj. K., L. S. K., Sh. S. K., për blerje banesë dhe të truallit, apartament nr. ***, pall. ***, Rruga ***, Durrës, me sipërfaqe 54 m², ndërsa truallin me sipërfaqe 36.6 m², në vlerën 7649 lekë.

²⁸Shihni dokumentin bashkëngjitur “Plotësim dokumentacioni pyetësor nr. 3”, protokolluar me nr. *** prot., datë 25.3.2022, në dosjen e Komisionit.

²⁹Shihni dokumentet në dosjen e Komisionit bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2: (i) kërkesë nr. *** prot., datë 1.12.2021 e shtetasit S. K., drejtuar Njesisë Administrative Sukth, ku ai duke informuar se mbi këtë truall të blerë prej Bashkisë Sukth, për arsye financiare, nuk ka bërë ndërtim, por vetëm ka mbjellë disa pemë frutore, ka kërkuar verifikimin e këtij fakti; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021 “Vërtetim fakti mbi gjendjen e ndërtimit” të Njesisë Administrative Sukth, sipas së cilës, pas verifikimit në terren nga ana e kësaj njësie është konstatuar se mbi truallin e blerë nga shtetasi S. K., për të cilin është dhënë leje sheshndërtimi me VKM nr.***, datë 7.5.2003, është i lirë dhe pa ndërtime; (iii) plan rilevimi i datës 21.10.2003 dhe planimetri e truallit me sip. 400 m², në pronësi të shtetasit S. K.; (iv) katër foto aktuale dhe një foto nga gjeoportali ASIG, të paraqitura nga Njësia Administrative Sukth, bashkë me përgjigjen e saj, nga të cilat nuk rezultojnë që mbi truall të ketë ndërtim.

1.12.2021, konfirmon se pasuritë e cituara në shkresë (toka dhe apartamenti objekt verifikimi), ndodhen në z. k. ***, fshati ***, e cila është zonë kadastrale e paazhornuar.

29.2. Në lidhje me apartamentin 1+1, u konstatua se:

- Në asnjë prej deklarimeve në vijim pas DPV-së për vitin 2004 dhe as në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka kryer deklarime për këtë pasuri, por me deklaratën *Vetting* ka paraqitur kontratë shitblerje datë 11.10.1995, sipas së cilës N. K. B. i shet blerësve S. A. K., P. Gj. K., L. S. K., Sh. S. K., banesë dhe truall me përshkrim apartament nr. ***, pall. ***, Rruga ***, Durrës, me sipërfaqe 54 m², ndërsa trualli me sipërfaqe 36.6 m², në vlerën 7649 lekë. Siç vërehet, subjekti Elsa Kareçi nuk është blerëse në këtë pasuri.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se deklarimi i pasurisë në DPV-në për vitin 2004 ka qenë për shkak se ka qenë në të njëjtin trung familjar me familjen e origjinës në kohën e blerjes së pasurisë, por ajo nuk është bashkëpronare në pasuri, pasi në momentin e blerjes së pasurisë ka qenë nën 18 vjeç, fakt i cili rezulton të jetë i vërtetë.

- Në lidhje me gjendjen juridike aktuale të kësaj pasurie, subjekti informoi se në zonën kadastrale në të cilën ndodhet kjo pasuri është e paazhornuar dhe se dokumenti i vetëm që disponohet nga familja e saj është kontrata e shitblerjes e datës 11.10.1995. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore³⁰.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje dy pasuritë objekt verifikimi të përfituara nga familja e saj e origjinës, nuk u evidentuan pronësi/bashkëpronësi/lidhje/kontribute të subjektit të rivlerësimit.

30. Gjatë hetimit administrativ, ASHK-ja Tirana Veri³¹ informoi Komisionin se në emër të shtetas Elsa S. Kareçi figuron e regjistruar pasuria e ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 71.3 m², në bashkëpronësi me të shtetasve F. K. dhe F. K. Nga verifikimi i dokumentacioni shoqërues, rezultoi se kjo shtetase është e datëlindjes 1951 dhe se kjo pasuri është përfituar nga këta shtetas me privatizim në vitin 1993, pra, nuk bëhet fjalë për subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi, e cila është e datëlindjes 1978.

31. Në lidhje me gjendjen *cash* deklaruar, ndër vite, u kryen verifikimet si vijojnë:

31.1. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime në *cash*, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Vitet	Deklaruar në DPV		Gjendje cash në fund të çdo viti, pas deklarimeve në pyetësorin nr. 3
	Shuma	Me fjalë	
DPV/2008	200 000 lekë	Kursime nga paga vjetore	200 000 lekë
DPV/2009	300 000 lekë	Kursime nga paga vjetore	500 000 lekë
DPV/2010	300 000 lekë	Kursime nga paga vjetore	800 000 lekë
DPV/2011	-		-
DPV/2012	-		-
DPV/2013	200 000 lekë	Kursime nga paga	200 000 lekë
DPV/2014	300 000 lekë	Kursime nga paga	300 000 lekë

³⁰Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti në dosjen e Komisionit: (i) shkresë “kërkim informacioni” protokolluar me nr. *** prot., datë 1.12.2021, nga ASHK-ja Durrës; (ii) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.12.2021, nga ASHK-ja Durrës, sipas së cilës konfirmohet se pasuria objekt shqyrtimi ndodhet në z. k. ***, fshati ***, e cila është një zonë kadastrale e paazhornuar dhe, si e tillë, është i pamundur identifikimi i pasurisë; (iii) vërtetim njësie me origjinalin nr. *** rep., datë 28.11.2021.

³¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.8.2020, nga ASHK-ja Tirana Veri në dosjen e Komisionit.

ut dhe pranë prokurorive ku subjekti ka ushtruar detyrën, nga ku nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi, apo procedime penale dhe pasurore ndaj tyre³⁴.

Në lidhje me bashkëjetesën me z. E. Sh.

34. Me këtë shtetas, subjekti ka lidhur martesë ligjore në datën 22.5.2019 dhe në vitin 2020, të cilën e ka zgjidhur me vendimin nr. ***, datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

34.1. Gjatë procesit të rivlerësimit, nga verifikimi i deklaramëve të subjektit, u konstatua se:

- Në DPFV-në e vitit 2003 – DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi dhe të regjistrimit në gjendjen civile, adresën: fshati ***, Sukth, Durrës (banesa/adresa e familjes prindërore).

- Në deklaratat periodike për vitet 2009 – 2011, në rubrikën, nëse disponohet vendqëndrim tjetër, subjekti ka deklaruar adresën: rruga “****”, Nr. ***, Tiranë (banesa e z. E. Sh.), ndërsa si adresë të regjistrimit në gjendjen civile është deklaruar adresa fshati, ***, Bashkia Sukth, Durrës (banesa/adresa e familjes prindërore).

- Në DPV-në e vitit 2012, adresa rruga “****”, Nr. ***, Tiranë (adresa e z. E. Sh.) është deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile.

- Në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 2.3.2016, duke lenë të kuptohet se kjo është adresa që i përket bashkëjetuesit, subjekti ka deklaruar se bashkëjetesa me shtetasin E. Sh. ka filluar që në nëntor të vitit 2011.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se për efekt bashkëjetese nga janari 2012 ka banuar në banesën e shtetasit E. Sh. në adresën: rruga “****”, Nr. ***, Tiranë.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se pavarësisht se në DPV-të 2009 – 2011 ka deklaruar si vendqëndrim tjetër adresën e të fejuarit, kjo është bërë për korrektesë, për shkak se qëndronte herë pas here tek ai. Gjithashtu, subjekti ka informuar se në nëntor 2011 ka qenë shtatzënë me fëmijën e parë e me probleme shëndetësore, prandaj ka qenë e detyruar të marrë raport mjekësor, pasi i ishte rekomanduar regjim shtrati. Për këto arsye, ka filluar të qëndrojë në banesën e të fejuarit që në nëntor 2011, por bashkëjetesa ligjore ka filluar në janar 2012, kur është kryer edhe regjistrimi në Gjendjen Civile³⁵. Ky fakt u konfirmua edhe nga shtetasi E. Sh. gjatë pyetjes së tij në datën 10.3.2022, nga Komisioni.

34.2. Pavarësisht se subjekti ka deklaruar bashkëjetesën ligjore me z. E. Sh., në janar të vitit 2012, kur ajo ka ndryshuar dhe adresën e gjendjes civile, në përfundim të hetimit administrativ, nga ana e Komisionit ka pasur dyshime në lidhje me një bashkëjetesë të mundshme të subjektit me të, në një periudhë më të hershme, e cila e ka pasur zanafillën që në vitin 2008, referuar rrethanave të renditura në rend kronologjik si vijojnë:

i) në maj të vitit 2008, nga të dhëna të sistemit *TIMS*, ka rezultuar që subjekti dhe z. E. Sh. kanë udhëtuar së bashku për në Maqedoninë e Veriut, ku kanë qëndruar një ditë;

³⁴Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 27.4.2022 nga SPAK-u; nr. *** prot., datë 5.5.2022 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. *** prot., datë 17.5.2022 nga Prokuroria e Rrethit Kavajë; nr. *** prot., datë 17.5.2022 nga Prokuroria e Rrethit Tiranë.

³⁵Shihni certifikatën familjare, lëshuar më 4.2.2016, nga ZGjC Sukth, në të cilën evidentohet se shtetasja Elsa Kareçi është ndarë nga trangu me martesë më 27.1.2012.

- ii) në datën 14.7.2008³⁶ rezulton një transaksion bankar i kryer nga subjekti në llogarinë e z.E.Sh., në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 300 euro;
- iii) subjekti ka deklaruar adresën e z. E. Sh. si vendqëndrim tjetër në DPV-të 2009 - 2011;
- iv) në përgjigje të pyetësorit nr. 2 , ka deklaruar që z. E. Sh. ishte i fejuari, ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se qëndronte herë pas here tek ai;
- v) në vitin 2010 shtetasi E. Sh. i ka dhënë subjektit shumën 802.000 lekë për mbylljen e kredisë së marrë nga subjekti në vitin 2008, në “Raiffeisen Bank”.

34.3. Në vlerësim të këtyre rrethanave, pavarësisht të dhënave për marrëdhënie të subjektit dhe z. E. Sh. që në vitin 2008, nga ana e Komisionit u vlerësua që këto marrëdhënie ishin konsoliduar në vitin 2009 e në vijim dhe, në këto kushte, deri në fazën e përfundimit të hetimit administrativ, Komisioni çmoi si kohë të fillimit të bashkëjetesës vitin 2009 dhe jo vitin 2012, që subjekti kishte deklaruar. Për këtë arsye, subjekti dhe z. E. Sh. janë analizuar së bashku, duke filluar nga ky vit, fakt që afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën financiare të subjektit. Me kalimin e barrës së provës, subjekti ka kundërshtuar periudhën e nisjes së bashkëjetesës në vitin 2009, duke pretenduar që bashkëjetesa faktike e saj me z. E. Sh. ka nisur në nëntor të vitit 2011, kur ajo është shpërngulur në banesën e tij, ndërsa *de jure*, bashkëjetesa ka nisur në vitin 2012, duke parashtruar dhe paraqitur një numër të konsiderueshëm argumentesh dhe provash shkrese për të hedhur poshtë dyshimet e Komisionit (trajtuar hollësisht në paragrafët nr. 63.2 dhe 63.3 të këtij vendimi).

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur/E. Sh.

35. Përpara se të analizoheshin pasuritë e deklaruara në deklaratat e interesave pasurore të z.E.Sh. dhe në funksion të kësaj analize, Komisioni evidentoi se:

- ky shtetas ka plotësuar deklaratën *Vetting* në datën 28.1.2017, në cilësinë e personit të lidhur, si bashkëjetues i subjektit të rivlerësimit Elsa Kareçi, në të cilën jenë deklaruar një numër i konsiderueshëm pasurish në emër të tij, në pjesën më të madhe përfituar me trashëgimi ligjore;
- subjekti ka deklaruar bashkëjetesën ligjore me këtë shtetas në janar të vitit 2012;
- në vitin 2014, kur i ka lindur detyrimi e në vijim, z. E. Sh. ka plotësuar deklaratat për kontrollin e pasurisë;
- z. E. Sh. dhe subjekti i rivlerësimit kanë lidhur martesën ligjore në datën 22.5.2019, të cilën e kanë zgjidhur me vendim gjyqësor të datës 4.11.2020, fakt i cili është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2020³⁷.

36. Gjatë hetimit administrativ, pasi i janë kërkuar sqarime e dokumente në lidhje me pasuritë e deklaruara nga ish-bashkëshorti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se ka disa rrethana personale, familjare e ligjore, të cilat i krijojnë vështirësi në kthimin e përgjigjeve, për shkak të mungesës së komunikimit me z. E. Sh. Konkretisht, subjekti bën me dije se e ka vënë në dijeni ish-bashkëshortin për kërkesat e Komisionit në lidhje me pasuri të deklaruara prej tij, duke i dhënë një kopje të pyetësorit e duke i kërkuar të plotësojë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Komisionit, çka është refuzuar prej tij, për arsye se nuk ka asgjë të përbashkët me subjektin dhe nuk ka pse t'i përgjigjet. Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se ka kontaktuar me vëllain e tij, shtetasin P. Sh., i cili ka refuzuar, gjithashtu, me arsyetimin se pronat për të cilat bëhet fjalë në pyetësor janë të përfituara me trashëgimi dhe me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe nuk ka arsye të japë shpjegime. Në këto rrethana, subjekti ka dhënë

³⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2021, të “Intesa Sanpaolo Bank”, nga ku ka rezultuar se në llogarinë e z. E. Sh. në euro, në datën 14.7.2008 është kryer veprimi me përshkrimin “blerje monedhë e huaj nga Elsa Kareçi, shuma 300 euro, kursi i këmbimit 124.34”.

³⁷Shihni DPV-në 2020 bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.12.2021, nga ILDKPKI-ja në dosjen e Komisionit.

informacione të kufizuara në lidhje me disa pasuri dhe të ardhura të ish-bashkëshortit, për të cilat ka pasur dijeni.

37. Sa i takon marrëdhënies me personin e lidhur/E. Sh., në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka parashtruar se:

- me vendimin nr. ***, datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur zgjidhja e martesës së subjektit me shtetasin E. Sh., ku dy fëmijët S. dhe S. Sh. i janë lënë subjektit për rritje dhe edukim, ndërsa ish-bashkëshortit i është caktuar detyrimi ushqimor për fëmijët dhe e drejta e takimit;
- për shkak të mosmarrëveshjeve të nisura që në periudhën e bashkëjetesës, ajo është larguar nga banesa bashkëshortore në gusht të vitit 2020, për të jetuar së bashku me vajzat e saj ne apartamente të marra me qira;
- aktualisht nuk ka asnjë marrëdhënie me shtetasin E. Sh., përveç nxjerrjes dhe pritjes së fëmijëve në ditët e takimit, apo në ndonjë aktivitet të fëmijëve;
- ish-bashkëshorti nuk paguan as detyrimin ushqimor për fëmijët dhe, për këtë arsye, në datën 19.11.2021 ka kërkuar nëpërmjet zyrës përmbartimore vënien në ekzekutim të vendimit të gjykatës;
- gjatë bashkëjetesës ajo nuk ka pasur dijeni për të ardhurat e ish-bashkëshortit, pronat dhe fazat që kanë lidhje me kthimin e tyre. Sipas subjektit, me procedurat lidhur me pasuritë e paluajtshme, gjykimet dhe regjistrimin apo shitjen e tyre, merrej ish-kunati i saj, shtetasi P. Sh., në bazë të prokurave që atij i ishin dhënë nga familjarët;
- me ish-bashkëjetuesin nuk kanë pasur marrëdhënie financiare, përveç një rasti në kohën e fejesës ku ai i ka paguar detyrimin e mbetur të kredisë së marrë në shumën 800.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2012, shumë të cilën ia ka kthyer në vitin 2010;
- të ardhurat e saj si subjekt rivlerësimi nuk kanë ndikuar në pasuritë e z. E. Sh., të cilat janë fituar me trashëgimi apo nga aktiviteti i tij tregtar dhe për të cilat ajo nuk ka pretendime;
- subjekti sjell në vëmendje se, sipas neneve 73 dhe 74 të Kodit të Familjes, regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor. Në këtë pasuri (në bashkësinë ligjore) përfshihet edhe pasuria e fituar nga bashkëshortët së bashku ose veç e veç, gjatë martesës. Në kushtet kur ata nuk kanë pasur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor do të zbatohet regjimi martesor i bashkësisë ligjore. Sipas nenit 77 të Kodit të Familjes, si pasuritë e fituara para lidhjes së martesës, të cilat janë në bashkëpronësi me persona të tjerë, ashtu edhe pasuritë e fituara me trashëgimi, bëjnë pjesë në pasuritë vetjake të bashkëshortit. Për këtë arsye, subjekti nuk e ka investuar gjykatën me padi për pjesëtim pasurie bashkëshortore, pasi nga bashkëjetesa dhe martesa nuk ka krijuar apo shtim të asnjë pasurie të paluajtshme, ndërsa për pasuritë e luajtshme janë kompensuar, sikurse ka sqaruar më lart.

37.1. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur si prova shkresore³⁸:

- vendimin nr. ***, datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është vendosur: zgjidhja e martesës ligjore të lidhur ndërmjet paditëses Elsa Sh. dhe të paditurit E.Sh.; rregullime mbi detyrimin ushqimor të fëmijëve; takimet me babain; marrjen e mbiemrit të vajzërisë së paditëses etj.;
- kontratë qiraje, datë 12.6.2020, agjencia imobiliare “****”, sipas së cilës qiramarrësja Elsa Sh. ka marrë me qira nga qiradhënësi O. H., me afat 1 vit;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.2.2022, të shtetasit O. H., i cili ka konfirmuar kontratën e qirasë të lidhur me subjektin për apartamentin dhe garazhin në pronësi të tij, duke konfirmuar, gjithashtu, pagesat e shpenzimit të energjisë dhe ujit;

³⁸Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorëve nr. 2 dhe 3 në dosjen e Komisionit.

- kërkesë “Për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv”, protokolluar me nr. ***, datë 19.11.2021, drejtuar përmbartuesit gjyqësor G. G.;
- kërkesë drejtuar ASHK Tiranë, protokolluar me nr. ***, datë 1.12.2021, ku nga subjekti është kërkuar informacion mbi pasuritë e shtetasit E. Sh.;
- shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga ASHK-ja Tiranë përmes së cilës subjektit Elsa Kareçi i është kthyer informacion se ajo nuk rezulton bashkëpronare në pasuritë për të cilat kërkohet informacion dhe, për këto arsye, nuk legjitimohet për të marrë të dhëna;
- kontratë qiraje e datës 16.6.2021e lidhur mes qiramarrëses Elsa Kareçi dhe qiradhënëses D.K. me objekt dhënie me qira apartamenti 2+1, në pronësi të qiradhënëses, me qira mujore 40.000 lekë, me aftat 21.6.2021 – 21.6.2023;

37.2. Në kushtet kur subjekti në shumicën e rasteve nuk ka paraqitur prova e dokumente shkresore në lidhje me sa i është kërkuar për pasuri të deklaruar nga personi i lidhur dhe ka informuar e dokumentuar mbi rrethana që kanë vështirësuar komunikimin me z. Sh., nga ana e Komisionit është pyetur si dëshmitar shtetasi E. Sh.. Në seancën e pyetjes në datën 10.3.2022, ky shtetas pavarësisht se ndodhej në një gjendje jo të qartë mendimesh, që dukej të ishte për shkak të konsumimit të alkoolit, konfirmoi deklaratimet e subjektit në lidhje me marrëdhëniet e acaruar ndërmjet tyre, si dhe dha disa sqarime në lidhje me pasuri të tij, të cilat janë përmbledhur në procesverbalin e kësaj date³⁹.

37.3. Në kushtet kur edhe në përfundim të hetimit administrativ Komisioni ka pasur mungesë informacioni e dokumentesh ligjore për pasuri të deklaruar nga ana e z. E. Sh. të krijuara përpara fillimit të bashkëjetesës me subjektin, të cilat do të mundësonin një vlerësim paraprak të deklaratimeve të tij, për një hetim sa më objektiv e shterues, i ka kaluar në mënyrë të detajuar subjektit barrën e provës për çdo paqartësi, mungesë dokumentacioni, mungesa burimesh financiare, etj, për çdo pasuri të deklaruar nga z. Sh. në deklaratën *Vetting* dhe jo vetëm.

Pasuri të deklaruar nga shtetasi E. Sh. në deklaratën *Vetting*

38. *Shtëpi banimi në Tiranë, rruga “****”, Nr. ***, sipërfaqe ndërtimi 170 m² dhe 60 m² oborr, kontratë dhurimi nga prindërit nr. ***, datë 8.8.1997. Pjesa takuese: 100%. Nuk është deklaruar vlere. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se mbetet e paqartë nëse në pasurinë shtëpi banimi në rrugën “****”, Tiranë, përfituar nëpërmjet dhurimit nga babai në vitin 1997, janë bërë investime të mëvonshme dhe nëse po, vlerat e shpenzuara dhe burimi financiar i përdorur.*

38.1. Në lidhje me këtë pasuri gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

- ASHK-ja Tirana Jug⁴⁰, referuar kartelës së pasurisë, informon se pasuria nr. ***, z. k. *** Tiranë, e llojit apartament me sipërfaqe totale 120 m², e ndodhur në rrugën “****”, figuron e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve E. Sh., P. Sh., R. Sh. dhe L. Sh., me datë regjistrimi 27.9.2018, me shënimin “dëshmi trashëgimie”.

- ZVRPP-ja Tiranë⁴¹ ka informuar se në emër të shtetasit E. Sh., sipas regjistrimit nr. ***, nr. rendor ***, viti 1997, figuron e regjistruar pasuria shtëpi banimi e përbërë nga tri dhoma, një sallone e një korridor, ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, e ndërtuar në një truall me sip. 690 m², e regjistruar me kontratë dhurimi nr. ***, datë 8.8.1997.

- FSHU-ja⁴² ka informuar se në emër të shtetasit E. Sh. rezulton kontrata me kod klienti ****, me datë hapje 12.3.2016, e cila nga dokumentet bashkëngjitur i përket një banese të ndodhur

³⁹Z. E. Sh. iu komunikua që ditën e nesërme të paraqitej për të nënshkruar procesverbalin e pyetjes, por ai nuk u paraqit.

⁴⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2021, të ASHK DV Tiranë Jug dhe dokumentet bashkëngjitur.

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.1.2017, të ZVRPP-së Tiranë, drejtuar prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e-mail të datës 7.9.2018, të ZQRPP-së drejtuar ILDKPKI-së në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.11.2021, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

në rrugën “****” Tiranë. Bashkëngjitur ka një vetëdeklarim për legalizim banese në rrugën “****”, që i përket vitit 2000, si dhe një deklaratë noteriale të vitit 2015 të shtetasit E. Sh., sipas së cilës ai banon në një banesë dykatëshe në po këtë rrugë.

38.2. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime e dokumente për të vërtetuar që pasuria shtëpi banimi sipas regjistrimit ***, nr. rendor ***, datë 1997, përkon me pasurinë nr. ***, z. k. *** (të dyja me të njëjtën adresë), si dhe të japë sqarime se kujt pasurie i përket vetëdeklarimi për legalizim bashkëlidhur shkresës së FSHU-së. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se bëhet fjalë për të njëjtën banesë, duke sqaruar se një fakt i tillë del nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë 23.5.1999, të Gjykatës Civile e Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit shtëpia me tri kate, njohur znj. N. Sh., ishte banesa që i ishte njohur më parë bashkëshortit të saj M. Sh., së cilës i ka bërë rikonstrukcion dhe shtesë dy kate. Për sa i përket vetëdeklarimit për legalizim të vitit 2000, subjekti deklaroi se ky vetëdeklarim nuk konfirmohet nga ASHK-ja (evidentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ) dhe se nënshkrimi dukshëm nuk i përket shtetasit E. Sh., i cili në të gjitha dokumentet e tjera ka një nënshkrim ku shënon edhe vitin e dokumentit, ndërsa në këtë dokument ky vit mungon. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente të tjera shtesë, por nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë 23.5.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, evidentohet fakti se paditësja N. Sh., nëna e ish-bashkëshortit të subjektit, i ka bërë rikonstrukcion banesës së ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, pasi ishte ndërtim i hershëm dhe shkalla e amortizimit ishte e lartë, duke shtuar dy kate. Në këto kushte dhe në analizë të të gjitha fakteve e rrethanave (analizuar hollësisht në paragrafin më poshtë), duket se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri.

38.3. Në lidhje me origjinën e pasurisë, nga aktet⁴³ në dosje rezultoi se:

- Me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 8.8.1997, z. M. Sh. (babai i bashkëshortit) i dhuron bashkëshortit të subjektit, z. E. Sh., një shtëpi banimi. Sipas kësaj kontrate, origjina e pronës rezultoi të jetë vendimi i Gjykatës Popullore Tiranë, datë 30.2.1960, nëpërmjet të cilit është vërtetuar fakti juridik i ndërtimit nga z. M. Sh. të një shtëpie banimi në lagjen “****”, në rrugën “****” me tri dhoma, një sallon dhe një korridor, ndërtuar në një truall prej 690 m², truall i cili i është dhënë z. M. Sh. nga Zyra e Kadastrës bashkë me vëllezërit F. dhe H.

- Me vendimin nr. ***, datë 23.5.1999, Gjykata Civile e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur të njohë pronare shtetasen N. Sh., nëna e z. E. Sh., mbi një shtëpi banimi trikatëshe, në rrugën “****”, pranë Q. S., Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 120 m².

- Me vendimin nr. ***, datë 21.5.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi lëshimin e dëshmisë testamentare për trashëgimlënësin M. Sh., duke përcaktuar si trashëgimtare të vetme testamentare bashkëshorten N. Sh.

- Sipas kartelave të pasurisë rezultoi pasuria nr. ****⁴⁴, z. k. ***, e llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe trualli dhe ndërtimi 120 m², figuron në pronësi të shtetasës N. Sh., me shënimin “vendim gjykate dhe leje ndërtimi”, regjistruar me nr. pasurie ***, apartament me sip. 120 m², me datë regjistrimi 5.12.2003 dhe me shënimin “leje ndërtimi”.

- Sipas vendimit nr. ***, datë 16.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultojnë si trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësës N. Sh. (vdekur më 17.2.2006) shtetasit P. Sh. i biri, R. Sh. e bija, E. Sh. i biri dhe L. Sh. e bija, të cilët trashëgojnë secili ¼ pjesë.

⁴³Shihni anekset 4/9 dhe 28 në dosjen ILDKPKI-së; shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.3.2022, nga ASHK-ja Tirana Jug dhe dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK-ja Tirana Jug në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Pasuria nr. *** është mbyllur dhe vijon me: pasurinë nr. ***, të llojit “apartament” me sip. 120 m², në pronësi të bashkëpronarëve Sh.; pasurinë nr. *** të llojit “apartament” me sip. 120 m², në pronësi të shtetasës L. B. (shitur nga N. Sh.); pasurinë nr. *** të llojit “apartament” me sip. 120 m², në pronësi të shtetasit I. B. (fillimisht kjo pasuri i është shitur vajzës R.Sh. dhe kjo e fundit ia ka shitur shtetasit I. B.).

- Sipas deklaratës për heqje dore nga pronësia nr. ***, datë 18.9.2018, shtetasit P. Sh., R. T. dhe L. B. heqin dorë nga pjesët takuese në apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, në dobi të vëllait të tyre E. Sh. Megjithatë, nga informacioni i marrë nga ASHK-ja, pasuria nr. *** është ende në bashkëpronësi të të gjithë bashkëpronarëve dhe kjo shpjegohet me faktin se ZVRPP-të nuk regjistrojnë pasuri me heqjen dorë nga bashkëpronësia, me përjashtim të rasteve kur heqja dorë bëhet brenda tre muajve nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit.

- Nga deklaratimet e subjektit dhe bashkëjetuesit të saj, konstatohet se: (i) kjo pasuri është deklaruar prej shtetasit E. Sh. në DPV-në e vitit 2014 njësoj si në deklaratën *Vetting*, por pa deklaruar vlerën dhe pjesën takuese; (ii) në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 2.3.2016, subjekti ka deklaruar se *babai i bashkëjetuesit, M. Sh. ka 1/3 e truallit prej 690 m² të dhënë nga Kadastra, pra, 230 m², të fituar sipas kontratës së dhurimit. Sipas saj kjo pasuri në vitin 1997 është rindërtuar dhe aktualisht është me tri kate, e regjistruar në vitin 1999, në emër të znj. N. Sh. (nëna). Kati i parë me sipërfaqe ndërtimi 170 m² dhe oborr 60 m² zotërohet nga z. E. Sh. mbi bazën e kontratës së dhurimit. Më tej, ka sqaruar se kjo është një pasuri e trashëguar që vjen nga babai, te nëna dhe, më pas, në vitin 2014 te katër fëmijët e tyre edhe pse çelja e dëshmisë së trashëgimisë e datës 15.12.2011, e trashëgimlënësës N. Sh. është regjistruar më vonë për shkak të problemeve të pronësisë që vazhdojnë ende nëpër gjyqe dhe certifikata e pasurisë ka dalë më 2.3.2015 dhe se të gjitha veprimet janë kryer prej z. P.Sh. (vëllai i E. Sh.), i cili është marrë me çështjet e pronësisë sipas prokurave të dhëna në kohë të ndryshme nga nëna N., xhaxhallarët F. dhe H. dhe, aktualisht, nga E. dhe dy motrat e tij; (iii) në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar shtëpi banimi në Tiranë, rruga “***”, Nr. ***, sipërfaqe ndërtimi 170 m² dhe 60 m² oborr. Pjesa takuese: 100%.*

- Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka paraqitur shpjegime e dokumente shkresore për sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me origjinën e pasurisë, e kushtëzuar kjo, sipas saj, nga disa rrethana personale, familjare e ligjore, për shkak të zgjidhjes së martesës dhe marrëdhënies së vështirë me bashkëshortin.

- Gjatë pyetjes, në datën 10.3.2022, ish-bashkëshorti deklaroi se pasuria objekt verifikimi është ndërtesë trikatëshe ish-pronë e gjyshërve dhe prindërve të tij, që pas vdekjes së prindërve u ka kaluar trashëgimtarëve të tyre ligjorë. Ndërkohë, duke pranuar se ka deklaruar gabimisht pjesën 100 %, pohoi se ai ka banuar gjithnjë në katin e parë, në katin e dytë ka banuar motra dhe në të tretin një nga vëllezërit e tij dhe se ai ka në pronësi vetëm katin e parë të banesës, kat i cili aktualisht nuk është regjistruar në emër të tij, për shkak se me procedurat është marrë vëllai P. Sh., i cili nuk i ka përfunduar ende këto procedura.

Në përfundim, në analizë të të gjitha provave të administruara si më sipër, duket se z. E. Sh. ka në bashkëpronësi ligjore pasurinë nr. ***, që i përket katit të parë të një ndërtese trekatëshe në rrugën “***”, në të cilën ka banuar me subjektin e rivlerësimit gjatë periudhës së bashkëjetesës. Kjo pasuri u vërtetua ta ketë origjinën shumë kohë përpara bashkëjetesës me subjektin, si dhe përpara se subjekti të ishte në detyrë.

38.4. Pavarësisht sa më sipër, me qëllim evidentimin e investimeve të subjektit dhe bashkëjetuesit të saj gjatë periudhës së bashkëjetesës, paqartësi e evidentuar edhe nga ILDKPKI-ja, nga Komisioni u kryen verifikimet, si vijojnë:

- Subjekti u pyet, i cili në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 nuk ka dhënë sqarime mbi investime të kryera në këtë pasuri gjatë periudhës kur ajo ka banuar në të, duke informuar vetëm mbi faktin se ata kanë jetuar në katin e parë, ndërsa në katin e dytë jeton familja e motrës së z. E. Sh., kurse kati i tretë në dijeninë e saj, për sa kohë ajo ka jetuar në atë ndërtesë nuk ka qenë asnjëherë i banueshëm, por ka qenë në pronësi të motrës tjetër, që më pas është shitur.

- Me kërkesë të Komisionit, ASHK-ja Drejtoria e Përgjithshme⁴⁵ ka informuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi E. Sh. nuk rezultojnë aplikues për legalizim të ndërtimeve pa leje.

- Referuar orotofotove, ndër vite⁴⁶, konstatohet se sipërfaqja dhe lartësia e ndërtesës në ortofoton e vitit 2007 është përafërsisht e njëjtë me ortofoton e viteve 2015 dhe 2018, fakt që tregon se në këtë ndërtesë nuk janë kryer investime në intervalin kohor 2007 – 2018.

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit është vijuar t'i kërkohej subjektit sqarime nëse në këtë pasuri janë kryer investime të tjera të çdolloji gjatë periudhës kur ka bashkëjetuar me z. E. Sh. dhe në parashtrime subjekti deklaroi se për sa kohë ka jetuar në këtë banesë nuk janë bërë investime, përveç investimit në mobilje të cilin e ka deklaruar, si dhe ka paraqitur disa foto të brendshme të shtëpisë në gjendjen aktuale.

Në përfundim të procesit, bazuar në provat e administruara: (i) nuk u vërtetua të jenë kryer investime të qenësishme në pasurinë objekt verifikimi gjatë periudhës së bashkëjetesës 2009 (ose 2012) deri në janar 2017, kur është plotësuar deklarata *Vetting*; (ii) nuk rezultuan të dhëna të çdolloji për lidhje të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, përveç faktit që ajo e ka përdorur atë gjatë periudhës së bashkëjetesës deri në vitin 2020, kur ka zgjidhur martesën ligjore, periudhë gjatë së cilës ka kryer shpenzime mobilimi në vlerën 800.000 lekë, përballuar me kredi në "Raiffeisen Bank", deklaruar në mënyrë të saktë në DPV-në e vitit 2015; (iii) nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm për investime me kontribute të subjektit apo ish-bashkëjetuesit të saj në pasurinë objekt verifikimi.

39. Tokë bujqësore me sipërfaqe 10.000 m², në ***, ***, Shkodër, parapaguar vlera e blerjes në vitin 1996 shtetasi L. B., tokë e paregjistruar (deklarata noteriale), burimi i të ardhurave nga shitja e anijeve. Vlera: 50.000 USD. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja ka konstatuar se mungon burimi financiar, që ka shërbyer për blerjen kësaj pasurie, në shumën 50.000 USD, çka bën deklarimin e rremë.

39.1. Gjatë hetimit nga aktet e administruara⁴⁷ dhe deklarimet e subjektit, lidhur me origjinën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, rezultoi se:

- ASHK-ja nuk ka dhënë informacion në lidhje me këtë pasuri.

- Sipas deklaratës për heqje dore nga pronësia me nr. ***, datë 19.2.2016, shtetasi L. B. deklaroi se në vitin 1996 i ka shitur shtetasi E. Sh. truallin me sip. 10.000 m² dhe se ka marrë prej tij shumën 50.000 USD, pa u përcaktuar koha e likuidimit të kësaj shume. Ai ka deklaruar, gjithashtu, se nuk është bërë asnjë dokument pronësie për kalimin e truallit në emrin e z. E.Sh., pasi janë në marrëdhënie familjare dhe kur të përgatitet dokumentacioni tekniko-ligjor dhe juridik do të bëhet kalimi i pronësisë në emër të z. E. Sh.

- Në DPV-në e vitit 2014, z. E. Sh. ka deklaruar: "Tokë bujqësore në ***, Shkodër, me sip.10.000 m², parapaguar vlera e blerjes që në vitin 1996, blerë nga shtetasi L. B., në shumën 50.000 USD".

- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 2.3.2016, subjekti ka deklaruar se trualli me sip. 10.000 m², megjithëse përfituar me ligjin nr. 7501, është ende i paregjistruar, duke informuar se kontrata e shitblerjes nuk është hartuar për shkak se nuk janë azhurnuar tokat bujqësore dhe nuk ka dalë certifikata e pronësisë në emër të shtetasi L. B.

- Ka një mospërputhje në deklarimet e bashkëjetuesit E. Sh. në lidhje me shitësin e pasurisë, pasi në deklaratën *Vetting* deklarohet shtetasi L. B., kurse në vitin 2014 deklarohet shtetasi

⁴⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.11.2021 nga ASHK-ja Drejtoria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Shihni shkresat kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 24.2.2022 nga ASIG-u në dosjen Komisionit.

⁴⁷Shihni aneksin 4/10 në dosjen ILDKPKI-së.

L.B. E pyetur mbi këtë fakt, subjekti ka sqaruar se në dijeninë e saj kjo është një tokë që zotërohet nga familja e kunatit të ish-bashkëshortit (I. B.) në fshatin ku familja e tij banon, të cilin ajo e njeh me emrin N. B. Ky shtetas është djali i shtetasit L. B. dhe jetojnë në të njëjtën shtëpi. Sipas saj, ndoshta ky fakt ka sjellë konfuzion në deklarimin nga ana e ish-bashkëshortit.

- Në mungesë të dokumentacionit që vërteton blerjen e pasurisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes nga z. E. Sh., subjektit iu kërkua informacion dhe dokumentacion shkresor, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaroi se në vitin 1996, kur është përfituar kjo pasuri, ka qenë në gjimnaz (vitet 1992 – 1996) dhe se në dijeninë e saj, bazuar në informacionin verbal, kjo pronë e familjes B. është e paazhurnuar, e paregjistruar dhe nuk është pajisur me certifikatë pronësie.

- Gjatë pyetjes së tij në datën 10.3.2022, shtetasi E. Sh. deklaroi se këtë pasuri e ka blerë në vitin 1996 nga vjehri i motrës së tij, L. B., me qëllim për të bërë një investim, pasi toka ndodhej buzë liqenit. Duke qenë se investimi nuk u realizua, pas vitit 2017, ia ka shitur përsëri këtij shtetasi. Gjithashtu, deklaroi se nuk disponon dokumente për veprimet e blerjes dhe shitjes së pasurisë dhe se likuidimet e shumës 50.000 USD në të dyja rastet janë kryer *cash*.

- DPPP-ja⁴⁸ ka informuar se në datën 19.2.2016, shtetasi L. B. ka nënshkruar deklaratën nr.***, datë 19.2.2016.

- ASHK-ja Drejtoria e Përgjithshme⁴⁹ ka informuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi E. Sh. nuk rezultojnë aplikues për legalizim të ndërtimeve pa leje.

- Në lidhje me shtetasit L. B. apo L. B. nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara⁵⁰ nga subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi dhe as përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar⁵¹.

39.2. Në lidhje me burimin e të ardhurave për të paguar vlerën 50.000 USD, në vitin 1996, bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar shitjen e anijeve. Sa i takon këtyre të ardhurave u verifikuan aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁵², si dhe u kryen disa veprime hetimore, nga ku rezultoi se:

- Me autorizimin për kalim pronësie nr. *** prot., datë 23.4.1995, Agjencia Kombëtare e Privatizimit autorizon kalimin e pronësisë së objekteve anije “***” dhe anije “***” në administrim të Flotës Tregtare Durrës, me të drejtën e blerjes z. E. Sh. Sipas këtij autorizimi, vlera e përgjithshme e anijes “***” është 82.877.741 lekë, ndërsa vlera e përgjithshme e anijes “***” është 75.320.629 lekë.

- Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23.3.2016⁵³, subjekti ka deklaruar se *blerja e tyre është bërë me një përqindje në lekë (5%) dhe pjesa tjetër me bono privatizimi*, por nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument për të vërtetuar këto deklarime.

- Me prokurën nr. ***, datë 24.5.1996, z. E. Sh. emëron z. S. L. M. për nënshkrimin e kontratës për shitjen e anijes “***” të “***” me qendër në P., Greqi, me çmim shitjeje 105 USD/ton, si dhe 10.000 USD për shpenzime të ndryshme.

- Nëpërmjet një deklaratë me shkrim dore, pa datë, shtetasi E. Sh. ka deklaruar se anijet “***” dhe “***” janë shitur me të njëjtën vlerë për ton, por nuk disponon dokumente.

- Subjektit iu kërkua informacion dhe dokumentacion mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e anijeve, vlerën e shitjes së anijeve, mënyrën e shitjes, pagesën e

⁴⁸Shihni aneks 41 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.11.2021, nga ASHK-ja Drejtoria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

⁵⁰Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dosjen e Komisionit.

⁵¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.12.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁵²Shihni aktet në aneksin 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk zotëron dokumentacion, pasi ato janë dorëzuar në ILDKPKI, si dhe ka sqaruar se nga kërkimi në *Google* këto anije kanë qenë pjesë e flotës tregtare shqiptare që u përdorën në eksodin e vitit 1991, duke iu referuar disa të dhënave mediatike për këto anije. Më tej ka sqaruar se zotëron vetëm prokurën origjinale të dhënë nga ish-bashkëshorti për shtetasin S. L. M., ku e autorizon të nënshkruajë të gjithë dokumentacionin për veprimet e shitjes së anijes “****” në çmimin USD/ton, si dhe 10.000 USD për shpenzimet e ndryshme. Për të mbështetur pretendimet, subjekti ka paraqitur katër foto të printuara nga kërkimi në *Google* dhe kopje njehsuar me origjinalin e prokurës nr. ***, datë 24.5.1996.

- Me deklaratën noteriale me nr. ***, datë 21.4.2017⁵⁴, shtetasi E. Sh. deklaroi se në janar të vitit 1995 ka marrë nga shtetasi A. F. A. letrat me vlerë në shumën 12.000.000 lekë, të cilat janë përdorur për blerjen e anijeve “****” dhe “****”. Kjo vlerë është kthyer në masën 100% në valutë të huaj, afërsisht 120.000 USD në tetor të vitit 1995, pas shitjes së anijeve. Vërehet se deklarata është përpiluar pas plotësimit të deklaratës *Vetting* me kërkesën e shtetasit A. A.⁵⁵.

- Gjatë pyetjes së tij në datën 10.3.2022, shtetasi E. Sh. deklaroi se kishte blerë 4 anije – “****”, “****”, “****” dhe “****”, duke përdorur për 90% të vlerës së tyre me bono privatizimi, të cilat janë blerë në tregun informal. Nga blerjet e bonove të privatizimit janë mbledhur rreth 3.800.000 USD. Më tej deklaroi se zotëron dokumentacion për blerjen dhe shitjen e këtyre anijeve, por nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument shkresor.

39.3. Bazuar në të dhënat e administruara si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se:

- i) është e paqartë origjina dhe vendndodhja e truallit me sip. 10.000 m²;
- ii) është e paqartë koha e saktë dhe mënyra e kalimit të shumës prej 50.000 USD nga shtetasi E. Sh. te shtetasi L. B.;
- iii) nuk ka dokumentacion ligjor mbi mënyrën e kalimit të pronësisë në emër të shtetasit E. Sh.;
- iv) nuk ka informacion mbi përdorimin e kësaj pasurie, investime të kryera apo gjendjen faktike të saj;
- v) është e paqartë përse shitja e pasurisë të pronari dhe shitësi i parë, shtetasi L. B., është bërë pas 21 vjetësh me të njëjtën vlerë (sipas deklarimeve të z. E. Sh. para Komisionit, ai e ka shitur përsëri tek i njëjti shtetas pas vitit 2017) prej 50.000 euro, çka ka sjellë si pasojë një fitim të munguar të konsiderueshëm të shtetasit E. Sh. përgjatë këtyre viteve, për shkak të: ngrirjes së shumës së investuar prej 50.000 euro, investuar nga viti 1996 duke mos marrë asnjë përfitim për 21 vjet; ndikimit të inflacionit⁵⁶ për 21 vjet; si dhe ndryshimit të çmimit të pasurive të paluajtshme⁵⁷ gjatë një periudhe kaq të gjatë kohore;
- vi) në DPV-të e viteve 2017 dhe 2018, ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë te shtetasi L. B.;
- vii) nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës 50.000 euro, e cila është përdorur për blerjen e pasurisë objekt verifikimi pasi mungon: informacioni mbi burimin që ka shërbyer për blerjen e anijeve dhe dokumentacioni ligjor përkatës; informacioni mbi vlerën e shitjes së anijeve dhe mënyrën e përfitimit të të ardhurave; dokumentacioni ligjor për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja.

⁵⁴Shihni dokumentin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje të datës 12.1.2022 nga noteri B. V. në dosjen e Komisionit.

⁵⁵Nga verifikimi në *Google* rezultoi që ky shtetas të jetë biznesmen.

⁵⁶Për shkak të inflacionit, shuma ekuivalente me 50.000 euro, e shpenzuar në vitin 1996, nuk ka më të njëjtën vlerë me atë të përfituar në vitin 2017, por një vlerë relative disa herë më të ulët.

⁵⁷Çmimi i pasurive të paluajtshme ka pësuar një rritje të vazhdueshme për periudhën 1996 – 2017.

Bazuar në sa më sipër, krijohet dyshimi se deklarimi i z. E. Sh. në deklaratën *Vetting* është i pavërtetë.

39.4. Në parashtrimet e saj, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion shkresor, por ka parashtruar ashtu sikurse edhe gjatë hetimit se nuk ka asnjë lidhje apo përfitim në këtë pasuri dhe se në momentin e përfitimit të saj në vitin 1996 dhe shitjes së anijeve nga ish-bashkëshorti, ajo ka qenë nxënëse në gjimnaz. Subjekti i referohet përsëri deklarimeve gjatë pyetjes nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, si dhe marrëdhënieve me ish-bashkëshortin, të cilat janë bërë pengesë për paraqitjen e sqarimeve dhe dokumenteve të mëtejshme në lidhje me këtë pasuri.

39.5. Në përfundim të procesit, vërehet se e vetmja provë shkresore që përmban të dhëna për përfitimin e pasurisë objekt verifikimi në vitin 1996 është deklarata për heqje dore nga pronësia me datë 19.2.2016, lëshuar nga shtetasi L. B., që në fakt nuk zëvendëson kalimin e pronësisë në emër të z. E. Sh. nëpërmjet një kontrate shitjeje me akt noterial sipas parashikimit të nenit 83 të Kodit Civil. Në kushtet e mungesës së një akti noterial që vërteton transaksionin, Komisioni i është referuar deklaramit të z. E. Sh. për vitin 2014, kur atij i ka lindur për herë të parë detyrimi ligjor në cilësinë e bashkëjetuesit, për të deklaruar interesat private, sipas ligjit nr. 45/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar”. Sipas parashikimit të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, kjo deklaratë që është plotësuar dy vjet më parë nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, konsiderohet si provë shkresore, që së bashku me deklaratën e shtetasit L. B., vërtetojnë përfitimin e pasurisë objekt verifikimi në vitin 1996 nga z. E. Sh., pra, shumë kohë përpara fillimit të bashkëjetesës me subjektin. Për rrjedhojë, të gjitha konstatimet në lidhje me origjinën, mënyrën e likuidimit të çmimit në vitin 1996, rishitjen e pasurisë në vitin 2017, mungesën e burimeve të ligjshme me të ardhura nga shitja e anijeve, etj., nuk mund të paralizojnë subjektin e rivlerësimit. Veç kësaj, nuk mund të anashkalohen dokumentet e administruara apo të dhënat mediatike, të cilat hedhin dritë mbi faktin se z. E. Sh. ka pasur në pronësi anije, nga shitja e të cilave ka përfituar të ardhura shumë vite më parë se të fillonte bashkëjetesën me subjektin. Ndërsa fakti i rishitjes së pasurisë tek i njëjti shitës në vitin 2017 dhe në të njëjtin çmim, i cili është deklaruar nga z. E. Sh. vetëm gjatë pyetjes nga Komisioni, i takon periudhës pas deklaratës *Vetting* dhe, si i tillë, nuk sjell ndonjë pasojë për subjektin, sidomos në kushtet kur mbetet tërësisht në nivel deklarativ. Për më tepër, në DPV-në e vitit 2017 e në vijim, derisa subjekti ka zgjidhur martesën me z. E. Sh., nuk janë deklaruar të ardhura nga rishitja e pasurisë. Një vlerësim i përmbledhur në lidhje me të gjitha pasuritë e ish-bashkëshortit, që i përkasin periudhës para bashkëjetesës, është kryer në paragrafin nr. 59.1. të këtij vendimi.

39.6. Bazuar në të gjitha sa më sipër, Komisioni vlerësoi se mungesa e dokumentacionit ligjor që vërteton të ardhura ligjore për blerjen e pasurisë në vitin 1996, në vlerën 50.000 euro, nuk përbën shkak për të konsideruar të rremë deklaramin e z. E. Sh., në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, sikurse ILDKPKI-ja kishte konstatuar, ndërkohë që ai mbetet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë në vlerën 50.000 euro, në vitin 1996. Për më tepër, në kushtet kur nuk u sigurua asnjë e dhënë për investime mbi pasurinë objekt verifikimi apo blerjen e ndonjë pasurie me të ardhura të pretenduara të përfituara nga shitja e saj në vitin 2017, çmohet se jo vetëm që mungon elementi subjektiv dhe pasoja e një deklarimi të mundshëm të pavërtetë, por në respekt të parimit të objektivitetit, Komisioni çmon si element pozitiv deklaramin e blerjes së pasurisë nga z. E. Sh. në DPV-në për vitin 2014 dhe në deklaratën *Vetting*, në kushtet e mungesës së plotë të dokumentacionit që vërteton blerjen e saj.

40. Tokë bujqësore ullishte, ***, ***, sipërfaqe 2.000 m², parapaguar pjesë-pjesë vlera e blerjes, e cila ka përfunduar në gusht 2010, shtetasit E. A., tokë e paregjistruar. Burimi i të ardhurave: shitja e fabrikës. Vlera: 30.000 euro. Pjesa takuese: 0%. ILDKPKI-ja ka konstatuar

se mbetet e paqartë/dyshimtë shitja e kësaj pasurie blerë në vlerën 30.000 euro dhe shitur në vlerën 15.000 euro.

40.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet⁵⁸ e administruara dhe deklaratimet, lidhur me origjinën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie rezultoi se:

- ASHK-ja nuk ka dhënë informacion në lidhje me këtë pasuri.
- Sipas planrilevimit të datës 1.5.2013 pasuria me nr. ***, z. k. ***, me sip. 7360 m² rezulton në pronësi të shtetasit M. A.
- Sipas deklaratës nr. ***, datë 16.3.2016, për heqje dorë nga pronësia, shtetasi E. A. deklaroi se në muajin gusht të vitit 2010 i ka shitur shtetasit E. Sh. truall me sip. 2000 m², ndodhur në ***, Komuna ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***, faqe ***. Ai deklaroi gjithashtu se shumë prej 30.000 euro e ka marrë në dorë dhe pas plotësimit të dokumentit tekniko-ligjor, do të bëhet kalimi i pronësisë në emër të shtetasit E. Sh..
- ZVRPP-ja Tiranë, në datën 7.9.2018, ka informuar ILDKPKI-në se pasuria nr. *** është parcela mëmë, e cila është ndarë në shumë pasuri të tjera. Ndërkohë, nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së, shtetasi E. A. aktualisht ka të regjistruara në bashkëpronësi 4 pasuri dhe në pronësi një pasuri, të ndodhura në z. k. ***, të llojit ullishte dhe truall, me sipërfaqe 7.360 m², 3.060 m², 15.000 m², 10.000 m² dhe 300 m², në ***.
- Në DPV-në e vitit 2014 shtetasi E. Sh. ka deklaruar se tokën bujqësore ullishte në ***, Tiranë, me sip. 2.000 m², parapaguar vlera e blerjes, e peregjistruar, ia ka blerë shtetasit E. A., në vlerën 30.000 euro.
- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se shtetasi E. A. i ka shitur truallin me sip. 2.000 m², por kjo pasuri është e peregjistruar për shkak se nuk janë azhornuar tokat bujqësore në këtë zonë. Nuk ka paraqitur dokumente shkresore.
- Sipas deklaratës nr. ***, datë 18.1.2017, për heqje dorë nga pronësia, shtetasi E. Sh. ka deklaruar se për tokën truall (ullishte) me sip. 2000 m², në Komunën ***, Tiranë, ka marrë nga shtetasi A. S. shumë prej 15.000 euro *cash*, duke deklaruar gjithashtu se heq dorë nga kjo pasuri dhe nje pronar A. S. Në këtë deklaratë deklaroi gjithashtu edhe shtetasi E. A., i cili shprehet dakord për sa më sipër dhe se në momentin që do të pajiset me dokumentacionin e pronësisë do të bëjë kontratën e shitjes me z. A. S.
- Gjatë hetimit administrativ, pasi subjektit iu kërkua informacion, sqarime dhe dokumente në lidhje me këtë pasuri, ajo ka informuar se nga ana e ish-bashkëshortit të saj janë dhënë shpjegime dhe dorëzuar dokumente në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI dhe se nuk ka informacion. Sipas saj, kjo pasuri është fituar prej bashkëshortit në gusht të vitit 2010, kur ajo ende nuk kishte nisur bashkëjetesën me të. Ajo deklaroi, gjithashtu, se nuk disponon informacion të mëtejshëm dhe se nuk e di arsyen e shitjes më lirë të pasurisë.
- I pyetur nga Komisioni në datën 10.3.2022, ish-bashkëshorti i subjektit deklaroi se veprimet e lidhje me këtë pasuri, si dhe likuidimet e shumave përkatëse janë bërë pa akte shkresore, pra, në mirëbesim, për shkak të marrëdhënieve e njohjeve shoqërore me shitësin e pasurisë dhe blerësin e saj. Në lidhje me shitjen më lirë, nga sa ishte blerë, të këtij trualli deklaroi se përveç shumë 15.000 euro, ai kishte rënë dakord me blerësin, shtetasin A. S., edhe për marrjen e një tjetër sipërfaqeje toke prej këtij të fundit, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ.
- Për shtetasit E. M. A. dhe A. I. S. nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara⁵⁹ nga subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi dhe as përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar⁶⁰.

⁵⁸Shihni deklaratën nr. ***, datë 16.3.2016, aneks nr. 4/11; *e-mail* datë 7.9.2018, aneks nr. 28 dhe aneks nr. 42 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.12.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

40.2. Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, të ardhurat nga shitja e fabrikës, nga aktet në dosje⁶¹ dhe deklaratimet e subjektit, rezultoi se:

- Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitet 1994 – 1996, me të ardhurat e përfituara nga emigracioni kam ndërtuar kombinat përpunimi druri në vendin *** dhe në vitin 1995 ky aktivitet është transferuar në ***, fabrikë e shitur në vitin 2006 në shumën 150.000 euro”.*

- Sipas Akt Dorëzanie nr. *** rep., datë 6.5.2005, dorëzanesit N. Sh. (nëna) e I. B. (kunati), pranojnë se janë në dijeni se E. Sh. ka rënë dakord për t’i shitur shtetasit A. P. pasurinë në ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, me sip. 2000 m², nga të cilat 1428 m² fabrikë.

- Në bazë të autorizimit datë 4.10.2005, dorëzanesit janë të autorizuar t’i shesin fabrikën shtetasit A. P. kundrejt shumës 150.000 euro, por duke qenë se autorizimi nuk është akt që i jep tagra përfaqësimi në formën e kërkuar nga ligji, pranojnë të bëhen dorëzanes dhe deri sa të kompletohet me dokumente ligjore, i marrin shtetasit A. P. një këst në shumën 70.000 euro, në emër dhe për llogari të shtetasit E. Sh. Pranuesi A. P. pranon se kanë rënë dakord me z. E. Sh. për shitjen e fabrikës në shumën 150.000 euro dhe shprehet dakord t’i japë nënës dhe kunatit të z. E. Sh. një këst prej 70.000 euro, shumë, e cila, pasi është numëruar është gjetur në rregull.

- Më pas është lidhur kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 7.6.2006, sipas së cilës E. Sh. i shet shtetasit A. P. një truall me sip. 2000 m², nga kjo zënë me ndërtesë 1428 m², me nr. pasurie ***, në shumën 7.000.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës. Kjo vlerë nuk përputhet me çmimin 150.000 euro, që z. E. Sh. e deklaroi si çmimin e shitjes së fabrikës.

- Gjatë hetimit administrativ, për të qartësuar në lidhje me të ardhura të përfituara nga shitja e fabrikës në vlerën e pretenduar prej 150.000 euro, subjektit iu kërkua informacion dhe dokumentacion, e cila ka deklaruar se nuk disponon informacion të mëtejshëm dhe se nuk ka dijeni sa ka qenë investimi për fabrikën për shitjen e së cilës janë dhënë shpjegime dhe dorëzuar dokumente në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI. Sipas saj, të gjitha veprimet janë kryer përpara bashkëjetesës së saj me ish-bashkëshortin.

- Për shtetasit A. S. P. dhe I. L. B. nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara⁶² nga subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi dhe as përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar⁶³.

Bazuar në sa më sipër, rezultoi e vërtetuar se në vitin 2006, nga z. E. Sh. janë përfiturat shumat 70.000 euro dhe 7.000.000 lekë. Nuk ka të dhëna nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat nga shitja. Për rrjedhojë këto të ardhura nuk janë konsideruar të ardhura të ligjshme. Në mungesë të dokumentacionit provues, blerja e truallit objekt verifikimi është konsideruar sipas deklaratimeve të z. E. Sh., i blerë në vlerën 30.000 euro, në vitin 2010, me të ardhura të pajustificuara ligjërisht.

40.3. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se:

i) është e padokumentuar origjina, vendndodhja e truallit me sip.2.000 m² dhe pronësia e shitësit E. A. mbi këtë truall;

ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor që vërteton blerjen e këtij trualli nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2010;

iii) ka mungesë dokumentacioni për kohën e saktë të kalimit të shumës 30.000 euro nga shtetasi E. Sh. te shtetasi E. A. dhe mënyrën e likuidimit;

⁶¹Shihni aneks nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.12.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dosjen e Komisionit.

⁶³Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.12.2021 nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

iv) ka mungesë dokumentacioni në lidhje me shitjen e pasurisë në vitin 2017 dhe është e paqartë përse E. Sh. e shiti këtë pasuri në gjysmën e çmimit të blerjes në vitin 2010, pasi pavarësisht deklarimeve të tij në lidhje me këtë çështje⁶⁴ ai nuk e ka provuar me dokumentacion nëse kjo marrëveshje është materializuar apo jo;

v) nuk vërtetohet koha e saktë e kalimit të shumës prej 15.000 euro nga shtetasi A. S. te shtetasi E. Sh.;

vi) nuk u vërtetua përfitimi i shumës së pretenduar prej 150.000 euro nga shitja e fabrikës, ndërkohë që për të ardhurat në vlerat 70.000 euro dhe 7.000.000 lekë nuk u vërtetua pagimi i tatimit mbi të ardhurat. Për rrjedhojë nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në shumën 30.000 euro, në vitin 2010.

40.4. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se veprimet në lidhje me këtë pasuri të blerë në vitin 2010, si dhe likuidimet e shumave përkatëse janë bërë pa akte shkresore, në mirëbesim, për shkak të marrëdhënieve e njohjeve shoqërore të ish-bashkëshortit me shitësin e pasurisë dhe blerësin e saj. Sipas saj, pasuria është blerë në vitin 2010, pra përpara nisjes së bashkëjetesës, që sipas saj është janari i vitit 2012 dhe jo viti 2009, sikurse është konsideruar nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar dhe vërtetuar se për shumën 7.000.000 lekë është paguar detyrimi tatimor⁶⁵. Në këto kushte, shuma prej 7.000.000 lekësh konsiderohet e ardhur e ligjshme e përfituar nga z. E. Sh. në vitin 2006, ndërsa sa i takon shumën 70.000 euro të pretenduar si pjesa tjetër e shumës totale prej 150.000 euro, të përfituar nga shitja e fabrikës në vitin 2006, nuk është provuar pagimi i tatimit dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme. Gjithsesi, këto fakte nuk e afektojnë subjektin e rivlerësimit, pasi i takojnë periudhës përpara bashkëjetesës.

40.5. Në lidhje me shitjen e këtij trualli te shtetasi A. S. dhe periudhës së saktë të shitjes, subjekti ka deklaruar se nuk është kryer kalimi i pronësisë me akt noterial për shkak se pasuria ka qenë e paregjistruar dhe, për pasojë, nuk ka një kontratë shitjeje. Gjithashtu, subjekti nuk ka sjellë arsye bindëse se përse toka është shitur me ½ e çmimit të blerjes së saj pas 7 vitesh. Në këto kushte, edhe pse subjekti i referohet deklaratës nr. ***, datë 18.1.2017, për heqje dorë nga pronësia, të z. E. Sh., shuma e deklaruar si çmim i shitjes së pasurisë në vlerën 15.000 euro në këtë deklaratë (e cila ka shërbyer si burim për krijimin e likuiditetit *cash* prej 10.000 euro, deklaruar në deklaratën *Vetting* nga z. E. Sh.), nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme (trajtuar hollësisht në paragrafin nr. 52 të këtij vendimi).

40.6. Në përfundim të procesit, Komisioni mori në konsideratë pretendimet e subjektit dhe vlerësoi se periudha e bashkëjetesës së subjektit me z. E. Sh. duhet të konsiderohet se ka nisur nga janari i vitit 2012 dhe jo nga viti 2009, sikurse ishte konsideruar bazuar në dyshimet e ngritura gjatë hetimit administrativ dhe, për pasojë, problematikat në lidhje me pasurinë objekt verifikimi i përkasin periudhës përpara fillimit të bashkëjetesës me z. E. Sh.. Sa i takon faktit që përfitimi i pasurisë është në vitin 2010, subjekti nuk e dokumentoi këtë fakt me ndonjë akt shkresor dhe në mungesë të këtij dokumentacioni, Komision çmoi si prova shkresore deklaratën për vitin 2014 të z. E. Sh., si dhe deklaratën datë 16.3.2016 të shtetasit E. A., sipas të cilave, blerja e pasurisë në çmimin 30.000 euro i përket vitit 2010.

41. *Shitur tokë bujqësore ullishte në ***, ***, e paregjistruar, shtetasit A. S. në datën 18.1.2017. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 100 %* (trajtuar më lart në paragrafin nr. 40).

⁶⁴Në pyetjen para Komisionit në datën 10.3.2022, z. Sh. deklaroi që çmimi i shitjes 15.000 euro është vendosur për shkak të një marrëveshjeje me shtetasin A. S. për marrjen e një tjetër sipërfaqeje toke prej këtij të fundit.

⁶⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2022, të ASHK Tirana Rurale 1, e cila ka paraqitur praktikën e kësaj pasurie dhe, ndër të tjera, edhe mandatarikëtimin datë 26.6.2006 në "Alpha Bank" për pagesën e tatimit, në shumën 210.000 lekë.

42. Truall sipërfaqe 529 m², z. k. *, Tiranë, bashkëpronësi, dëshmi trashëgimie. Pjesa takuese: 25 %. Vlera e pa përcaktuar. ILDKPKI-ja ka konstatuar fshehje të 4 ndërtimeve të paligjshme ndërtuar në truallin me sip. 529 m² në Tiranë, sipas kartelës së pasurisë seksioni “E”. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me ndërtimet e mësipërme, vlerën e shënuar dhe burimin financiar që ka shërbyer për ndërtimin e tyre.**

42.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet⁶⁶ në dosje, rezultoi se:

- Me vendimin nr. ***, datë 2.4.2001, nga KKKP ish-pronarëve është vendosur njohja e pronares N. Sh., pronare e truallit me sip. 2000 m², nga i cili: dy troje të lira me sip. 529 m² dhe 471 m², pra, rreth 1000 m², i kthehen znj. N. Sh. dhe një truall me sip. 1.000 m², kompensohet në natyrë.

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 22.4.2015, pasuria nr. ***, në rrugën “***”, Tiranë, e llojit “truall” me sip. 529 m², figuron në pronësi të znj. N. Sh.

- Nga kartela e pasurisë, pasuria nr. ***, Tiranë, me status aktiv, e llojit “truall” me sip. 529 m², figuron në bashkëpronësi të shtetasve P. Sh., R. Sh., E. Sh. dhe L. Sh., regjistruar më 15.5.2015, me pjesë takuese ¼, me dëshmi trashëgimie⁶⁷. Në seksionin C, “*Të drejtat reale*” të kartelës së pasurisë vërehet shënimi “*Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Lëshuar në datën 11.10.2019 për çështjen civile me nr. akti ***, datë depozitimi 30.9.2019*”, me datë regjistrimi 23.10.2019. Ndërsa, në seksionin E “*Kufizimet e pasurisë*” vërehet shënimi “*Ka 4 ndërtime të paligjshme*” datë regjistrimi 21.11.2014.

- Me prokurat e posaçme nr. ***, datë 14.5.2009 dhe nr. ***, datë 2.5.2013, dy motrat Sh. (R.T. dhe L.B.) dhe E. Sh. caktojnë si përfaqësues vëllain e tyre P. Sh., për t’i përfaqësuar në të gjitha veprimet për kthimin dhe kompensimin e pronave në bashkëpronësi të tyre⁶⁸.

- ASHK Tirana Jug⁶⁹ informoi se në këtë pasuri pozicionohen: (i) ndërtimi i shtetasve E. Q. A., I. Q. A. me nr. *** prot., datë 2.9.2006, numri i kateve 3, periudha e ndërtimit 10.1997; (ii) ndërtimi i shtetasve B. Q. A. dhe Xh. A. A. me nr. *** prot., datë 2.9.2006, nr. i kateve 3, periudha e ndërtimit 8.1996. Më tej, ASHK-ja ka informuar se bazuar në dokumentacionin e administruar nga ky institucion nuk rezulton që bashkëpronarët Sh. të kenë të drejta mbi ndërtimet.

- Nga verifikimi i deklarimeve konstatohet se në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 shtetasi E.Sh. nuk e ka deklaruar pasurinë truall me sip. 529 m², ndërsa në DPV-në e vitit 2016 e ka deklaruar. Në të gjitha DPV-të nuk janë kryer deklarime në lidhje me objektet e paligjshme ndërtuar mbi të.

- Subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi këto ndërtime, e cila informoi se nuk ka mundur të marrë informacion nga ASHK-ja Tiranë, pasi ajo nuk legjitimohet për marrjen e informacionit. Më tej, ajo ka informuar se të gjitha ndërtimet pa leje të referuara nga ZVRPP-ja Tiranë, nuk janë kryer prej ish-bashkëshortit të saj, por nga persona të tjerë dhe, për këtë arsye, në pamundësi për t’u konsultuar me dokumentacionin justifikues ligjor në lidhje me personat që kanë ndërtuar pa leje, e ka të pamundur për të dhënë shpjegime dhe informacione për sa kërkohet nga Komisioni. Në dijeninë e saj, ashtu sikurse është deklaruar në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, të gjitha veprimet noteriale janë kryer prej vëllait të ish-bashkëshortit, shtetasit P. Sh. dhe se në periudhën 2013 - 2014, ish-bashkëshorti nuk ka firmosur asnjë kontratë apo

⁶⁶Shihni aktet në aneksin nr. 4/9 të dosjes së ILDKPKI-së dhe dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷Sipas vendimit nr. ***, datë 16.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶⁸Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje të noterit A. M., protokolluar me nr. *** prot., datë 12.1.2022, në dosjen e Komisionit.

⁶⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2022 nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

dokumentacion noterial. Gjithashtu, subjekti ka informuar se ish-bashkëshorti ka pasur mosmarrëveshje me vëllain e tij, pasi nuk kishte shumë herë informacione për veprimet që kryente ai.

- Nga verifikimi i fotografimeve të paraqitura nga ASIG⁷⁰ konstatohet se kanë ekzistuar ndërtime që në vitin 1999, pa mundur të përcaktohet numri i ndërtesave konkrete. Nga orotofotot e viteve 2007, 2015 dhe 2018 evidentohen dy ndërtime, sipërfaqja dhe lartësia e të cilave është përafërsisht e njëjtë.

42.2. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas informacioneve të administruara nga ASIG, dhe ASHK-ja, mbi truallin objekt verifikimi evidentohen dy ndërtime pa leje dhe jo 4, sikurse është pasqyruar në kartelën e pasurisë, të ndërtuara nga shtetas të tjerë dhe jo nga bashkëpronarët Sh., mbi të cilat, bashkëshortet Sh. dhe as bashkëpronarët e tjerë të truallit nuk kanë të drejta pronësie. Por, pavarësisht kësaj, subjekti i rivlerësimit dhe ish- bashkëshorti i saj mund dhe duhet të jepnin sqarime në DPV-të vjetore dhe në deklaratën *Vetting* në lidhje me ndërtimin e objekteve nga ana e personave të tretë. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente në lidhje me këtë konstatim.

42.3. Në parashtrimet e saj subjekti ka pretenduar se ky konstatim është i pambështetur në nenin 3 në ligjin nr. 84/2016 si dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, pasi ndërtimet pa leje u përkasin personave të tretë dhe mbi to nuk kanë të drejta pronësie bashkëpronarët Sh. Sipas saj, personi i lidhur ka pasur detyrimin të deklaronte në deklaratën *Vetting* pasurinë e paluajtshme truall me sip. 529 m² në bashkëpronësi, por jo ndërtimet pa leje. Sa i takon mungesës së deklarimeve të z. E. Sh. në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 të truallit me sip. 529 m², sipas subjektit kjo ka ardhur si pasojë se vëllai i tij nuk i jepte informacion, pra ka qenë në kushtet e padijenisë. Sipas saj, kjo pasaktësi në deklarime, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁷¹ nuk mund të shërbejë si shkak për penalizim të subjektit.

42.4. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi të bazuar pretendimin e subjektit në lidhje me mungesën e deklarimeve nga ana e z. E. Sh. në deklaratën *Vetting* të ndërtimeve informale të kryera nga persona të tretë mbi truallin objekt verifikimi, për sa kohë nuk u vërtetuan të drejta pronësie apo të drejta reale përdorimi në emër të tij apo në emër të bashkëpronarëve Sh. Gjithashtu, nuk e konsideroi mungesën e deklarimeve të truallit nga ana e ish-bashkëshortit në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, si shkak penalizues për subjektin, për më tepër në kushtet kur pronësia mbi truallin prej 529 m² është fituar nga ish-bashkëjetuesi në këto vite, me trashëgimi ligjore.

43. *Truall me sip. 291 m², z. k. ***, Tiranë, në bashkëpronësi, dëshmi trashëgimie. Vlera: e papërcaktuar. Pjesa takuese: 25 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

43.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁷² rezultoi se:

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 22.4.2015 nga ZVRPP-ja Tiranë, pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 291 m², figuron në pronësi të znj. N. Sh. dhe në kartelën e kësaj pasurie është shënuar V.K.K.P ***.

⁷⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 24.2.2022 nga ASIG në dosjen Komisionit.

⁷¹Shihni vendimin nr. 10, datë 14.4.2022, të Kolegjit.

⁷²Shihni aktet në aneksin nr. 4/9 dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK Tirana Jug; shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2017 nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 4/9 dhe shkresën nr. ***, datë 15.2.2018, të ZQRPP-së në aneksin nr. *** në dosjes e ILDKPKI-së; dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje të noterit A. M., protokolluar me nr. *** prot., datë 12.1.2022, në dosjen e Komisionit; shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 24.2.2022, nga ASIG në dosjen Komisionit.

- Nga dokumentacioni i paraqitur nga ASHK Tirana Jug rezulton se pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 291 m², është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve E. Sh., R. Sh., L. Sh. dhe P. Sh. me pjesë takuese ¼, datë regjistrimi 15.5.2015, me dëshmi trashëgimie⁷³.

- Në DPV-të 2014 dhe 2015, kjo pasuri nuk është deklaruar, ndërkohë që është deklaruar në DPV-në e vitit 2016 si pasuri në bashkëpronësi, me pjesë takuese 25%.

- Nga verifikimi i kartelës së pasurisë konstatohet se në seksionin E “Seksioni i hipotekave, vendimeve të gjykatës, kufizimeve etj.”, gjendet përshkrimi “ka një ndërtim të paligjshëm”, me datë regjistrimi 21.11.2014”, i padeklaruar nga z. E. Sh. as në DPV-në e vitit 2014 dhe as në deklaratën *Vetting*.

- Në mungesë të informacionit mbi gjendjen aktuale të kësaj pasurie dhe përdorimin e saj, subjektit iu kërkuan sqarime mbi gjendjen juridike aktuale dhe faktike, si dhe përdorimin e saj, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se nuk rezulton bashkëpronare dhe, për këtë arsye, nuk legjitimohet për marrjen e informacionit. Më tej, ajo ka informuar se sipas saj të gjitha ndërtimet pa leje të referuara nuk janë kryer prej ish-bashkëshortit të saj dhe, për këtë arsye, në pamundësi për t’u konsultuar me dokumentacionin justifikues ligjor në lidhje me personat që kanë ndërtuar pa leje, e ka të pamundur për të dhënë shpjegime dhe informacione për sa kërkohet nga Komisioni. Në dijeninë e saj, ashtu sikurse është deklaruar në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, të gjitha veprimet noteriale janë kryer prej vëllait të ish-bashkëshortit, shtetasit P. Sh., me të cilin nuk ka pasur marrëdhënie të mira dhe se në periudhën 2013 – 2014, ish-bashkëshorti nuk ka firmosur asnjë kontratë apo dokumentacion noterial.

- Në lidhje me kohën e ndërtimit dhe legalizimin e objektit që ndodhet mbi truallin me nr. pasurie ***, ASHK Tirana Jug informoi se referuar regjistrin dixhital të vetëdeklarimeve, rezulton vetëdeklarues me dy aplikime subjekti P. M. Sh. (vëllai i shtetasit E. Sh.) dhe konkretisht rezultojnë: (i) vetëdeklarimi nr. *** prot., datë 14.11.2006, për objektin me vit ndërtimi 1992, nr. i kateve mbi tokë 3, nr. i kateve nëntokë 1, sipërfaqja e gjurmës 144 m², sipërfaqja e truallit të zënë është 600 m²; (ii) vetëdeklarimi nr. *** prot., datë 7.11.2014, për objektin me vit ndërtimi 2004, shtëpi private.

- Nga verifikimi i fotografimeve të paraqitura nga ASIG konstatohet se kanë ekzistuar ndërtime që në vitin 1994, pa mundur të përcaktohet numri i ndërtesave konkrete. Nga orotofotot e viteve 2007, 2015 dhe 2018 evidentohet një ndërtim, i cili në vitin 2007 nga lartësia duket njëkatësh, ndërsa në vitet 2015 dhe 2018, periudhë në të cilën subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë qenë në bashkëjetesë, duket pjesërisht me dy kate dhe sipërfaqe më e madhe.

- Gjatë deklarimeve në procesverbalin e datës 10.3.2022, ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se nuk ka dijeni për ndërtimet pa leje mbi trojet në bashkëpronësi dhe se me të gjitha procedurat është marrë vëllai i tij P. Sh., me të cilin ai nuk ka marrëdhënie dhe komunikim për shkak të mosmarrëveshjes për pronat e tyre të përbashkëta.

43.2. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se: (i) janë të paqarta investimet e familjes Sh. në truallin objekt verifikimi gjatë viteve që subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj kanë qenë në bashkëjetesë dhe martesë ligjore, kjo me qëllim evidentimin e shpenzimeve të tyre në këtë investim; (ii) ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar në DPV-të vjetore dhe as në deklaratën *Vetting* dy ndërtime të vetëdeklaruar nga përfaqësuesi me prokurë P. Sh. mbi truallin objekt verifikimi;

⁷³Me vendimin nr. ***, datë 16.12.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësës N. Sh., të cilët janë shtetasit: P. Sh., i biri; R. Sh., e bija; E. Sh., i biri; L. Sh., e bija, që trashëgojnë secili ¼ pjesë.

(iii) janë të paqarta të drejtat që gëzon shtetasi E. Sh. mbi këto ndërtime në cilësinë e bashkëpronarit të truallit.

43.3. Në parashtrimet e saj, subjekti, duke pranuar pasaktësinë në lidhje me mosdeklarimin e truallit në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, ka deklaruar se kjo ka ardhur për shkak të padijenisë së personit të lidhur, ndërsa sa i takon mosdeklarimit në deklaratën *Vetting* të dy ndërtimeve pa leje, për të cilat ka dy vetëdeklarime nga ana e vëllait të tij P. Sh., subjekti ka pretenduar se ish-bashkëjetuesi i saj nuk ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte ndërtimet pa leje të personave të tretë, qoftë ky edhe vëllai i tij. Për sa i përket shpenzimeve në këtë investim dhe nëse gëzon të drejta shtetasi E. Sh. si një nga pronarët e truallit, sipas subjektit nuk ka asnjë paqartësi, pasi me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2022, ASHK Tirana Jug ka konfirmuar se vetëdeklarues me dy aplikime është subjekti P. M. Sh. dhe në bazë të dokumentacionit të administruar në dosje nuk rezulton që bashkëpronarët Sh. të kenë të drejta mbi ndërtimet.

43.4. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi të bazuar pretendimin e subjektit dhe nuk gjeti pasoja për shkak të moskryerjes së deklarimeve në deklaratën *Vetting* nga ana e z. E. Sh., në lidhje me dy ndërtimet informale mbi truallin objekt verifikimi, ku vetëdeklarues me dy aplikime rezulton vëllai i tij shtetasi P. M. Sh., ndërkohë që mbi këto ndërtime nuk u vërtetuan të drejta pronësie apo të drejta reale pronësie në emër të tij apo bashkëpronarëve Sh. Për më tepër, të dyja ndërtimet u përkasin përkatësisht viteve 1992 dhe 2004 dhe pas këtyre viteve nuk ka asnjë provë a të dhënë që ish-bashkëshorti i subjektit apo dhe subjekti të kenë kryer investime gjatë periudhës së bashkëjetesës. Gjithashtu, nuk e konsideroi mungesën e deklarimeve të truallit prej 291 m² nga ana e ish-bashkëshortit në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, si shkak penalizues për subjektin, në kushtet kur pronësia mbi këtë truall është fituar nga ish-bashkëjetuesi në këto vite me trashëgimi ligjore.

44. *Truall me sip. 349.3 m², z. k. ***, bashkëpronësi, kontratë pjesëtimi. Vlera: e papërcaktuar. Pjesa takuese: 25%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

44.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁷⁴ rezultoi se:

- Sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 19.3.2012, lëshuar datë 2.4.2012, nga ZVRPP-ja Tiranë, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve P. Sh., E. Sh., etj., pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 8378.5 m².

- Sipas kontratës për pjesëtim pasurie nr. ***, datë 22.11.2012, me objekt pjesëtimin e pasurisë së mësipërme, shtetasit P. Sh., R. Sh., E. Sh. dhe L. Sh. do të marrin 2208.3 m² (që i takon sip. 349.3 m² + 1859 m²).

- Sipas kartelës së pasurisë⁷⁵ lëshuar në datën 9.2.2018, pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 349.3 m² figuron në pronësi të shtetasve E. Sh., L. Sh., P. Sh. dhe R. Sh., me shënimin kontratë pjesëtimi. Nuk ka të dhëna për ndërtime mbi këtë pasuri.

- Kjo pasuri nuk është deklaruar nga bashkëjetuesi E. Sh. në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, por është deklaruar në DPV-në e vitit 2016.

- Në lidhje me këtë pasuri, subjektit iu kërkua informacion mbi gjendjen juridike e faktike, si dhe përdorimin e kësaj pasurie, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, e cila ka deklaruar se nuk ka mundur të marrë të dhëna nga ASHK Tiranë, pasi ajo nuk rezulton bashkëpronare.

⁷⁴Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK Tirana Jug; shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2017 nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 4/9 dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2018, të ZQRPP-së në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁵Sipas dosjes së kësaj pasurie me nr. reference ***, sipërfaqja prej 2208.3 m², që pronarët do të merrnin nga kontrata e pjesëtimit, është regjistruar në dy kartela pasurie, përkatësisht kartela me nr. pasurie *** me sip. 349.3 m² dhe pasuria me nr. *** me sip. 1859 m², pra në total 2208.3 m².

44.2. Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur të dhëna mbi investime të kryera në këtë pasuri, por ka pasaktësi në deklaratimet e bashkëjetuesit për vitet 2014 dhe 2015, për shkak të mosdeklarimit të pasurisë nga ana e tij, në lidhje me të cilën subjektin iu kërkuan sqarime me njoftimin e rezultateve të hetimit. Në parashtrimet e saj, subjekti deklaroi se mosdeklarimi i trullit gjatë këtyre dy viteve është një pasaktësi e karakterit formal në kushtet kur me administrimin e pronave merrej vëllai i ish-bashkëjetuesit dhe se kjo pasaktësi nuk mund të jetë penalizuese për subjektin. Ky pretendim u vlerësua i bazuar për më tepër në kushtet kur pronësia mbi truallin prej 349.3 m² është fituar nga ish-bashkëjetuesi me trashëgimi ligjore dhe nuk u vërtetua që të jenë investime mbi këtë truall.

45. *Truall me sip. 1.859 m², z. k. ***, Tiranë, bashkëpronësi, kontratë pjesëtimi. Vlera nuk deklarohet. Pjesa takuese: 25 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

45.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet⁷⁶ në dosje rezultoi se:

- Sipas vërtetimit hipotekor, lëshuar më 2.4.2012, ZVRPP-ja Tiranë, pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 8378.5 m² figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve P. Sh., E. Sh., etj.

- Sipas kontratës për pjesëtim pasurie nr. ***, datë 22.11.2012, për pronën e mësipërme, shtetasit P. Sh., R. Sh., E. Sh. dhe L. Sh. do të marrin 2.208,3 m² (që i takon sip. 349.3 m² + 1859 m²).

- Me urdhrin nr. ***, datë 15.1.2018, të ZVRPP-së Tiranë, është regjistruar leje legalizimi nr. ***, datë 8.1.2016, në emër të shtetasit S. T., ku objekti i legalizimit rezulton të pozicionohet mbi pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sip. 1859 m², në bashkëpronësi të bashkëpronarëve Sh.. Sipas këtij urdhri, duke qenë se objekti i legalizimit prek pasuri me një sipërfaqe totale prej 514 m², për efekt të regjistrimit të lejes së legalizimit pasuria nr. ***, me sip. 1859 m², duhet të ndahet në dy pasuri: (a) pasuria nr. ***, me sip. 369 m², në pronësi shtet⁷⁷; (b) pasuria nr. ***, me sip. 1490 m², në pronësi të bashkëpronarëve Sh.

- Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Tirana Jug rezulton se shtetasi E. Sh. ka pasur të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 1859 m², regjistruar me kontratë pjesëtimi, në datën 21.11.2014, e cila është ndarë në dy pasuri të veçanta: (i) pasuria nr. ***, me sip. 369 m², në pronësi shtet (pasi janë shpronësuar bashkëpronarët Sh. në shumën 20.928.100 lekë sipas VKM-së nr. ***, datë 20.6.2018) dhe më pas në datën 8.1.2019, në pronësi të shtetasit S. S. T.; (ii) pasuria nr. ***, me sip. 1490 m², në pronësi të bashkëpronarëve Sh.

- Sipas kartelës së pasurisë, pasuria e llojit “truall” me sip 1490 m², me nr. pasurie *** rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve E. Sh., L. Sh., P. Sh. dhe R. Sh., me datë regjistrimi 27.12.2018. Në seksionin D të kartelës së pasurisë vërehet shënimi “Mbi këtë pasuri bie ndërtesa me nr. ***, regjistruar me leje legalizimi në datën 3.8.2018”.

- Në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, z. E. Sh. nuk ka kryer deklaratime në lidhje me truallin në bashkëpronësi.

- E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi gjendjen aktuale dhe përdorimin e pasurisë, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime se për të gjitha këto pasuri nuk disponon informacion të mëtejshëm.

⁷⁶Shihni aneksin nr. 4/9 dhe nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK Tirana Jug në dosjen e Komisionit; shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 4/9 dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2018, të ZQRPP-së në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁷Shpronësuar me VKM-në Nr. ***, datë 20.6.2018.

- ASHK Tirana Jug⁷⁸ informoi se për pasurinë truall me sip. 1859 m² rezultojnë aplikues subjektet si vijojnë:

i) Shtetasi P. A. H. – me deklaratë aplikimi nr. *** prot., viti 2005, për objektin me vit ndërtimi 1998 dhe me dëshmi trashëgimie, u ka kaluar të drejtat familjarëve të tij znj. V. S. H., etj. Subjektet janë pajisur me vendimin nr. ***, datë 10.5.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje për objekt banimi 2 kate + 1kat nëntokë. Në seksionin “E” ndodhet shënimi “vendoset hipotekë ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve”, pasi subjektet nuk i kanë rregulluar marrëdhëniet me truallin.

ii) Shtetasi R. S. D. – është emetuar vendimi për legalizimin e ndërtimit pa leje nr. ***, datë 10.5.2021. Ende nuk është miratuar VKM-ja e shpronësimit. Në seksionin “E” ndodhet shënimi “vendoset hipotekë ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve”, pasi subjektet nuk i kanë rregulluar marrëdhëniet me truallin.

iii) Shtetasja F. H. M. – me deklaratë aplikimi me nr. *** prot., datë 14.9.2006, për objekt me vit ndërtimi 1999 dhe me deklaratë noteriale kanë kaluar të drejtat në emër të shtetasve F. H. M., P. M. dhe G. M. Subjektet janë pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 30.5.2018, për objektin godinë banimi 2 kate.

iv) Shtetasi L. B. – subjektit i është emetuar leja e legalizimit nr. ***, datë 22.9.2011, për objektin godinë banimi 3 kate.

v) Shtetasi S. T. – praktika nuk administrohet.

- Nga Komisioni u administruan prokurat e posaçme të datave 2.5.2013, 23.9.2019, 18.9.2020, 5.10.2020, si dhe deklarata noteriale datë 25.2.2021⁷⁹, nëpërmjet të cilave vërtetohet se shtetasit R. T. (Sh.), L. B. (Sh.), E. Sh. dhe P. Sh., trashëgimtarë ligjorë të z. M. e N. Sh., janë shprehur se janë bashkëpronarë të disa pasurive të paluajtshme truall, në z. k. ***, Tiranë, ku kanë ndërtuar objekte pa leje ndërtimi shtetasit R. D., V. H., P. T. dhe A. T. dhe, për këtë shkak, ata si bashkëpronarë do të shpronësohen kundrejt përfitimit të vlerave monetare nga ATP-ja Tiranë, duke dhënë pëlqimin për shpronësim. Gjithashtu, ata kanë shprehur vullnetin që vlerat monetare të kompensimit t'i kalojnë znj. M. D. dhe se caktojnë si përfaqësues të tyre avokatët A. Ll. dhe K. B. për ndjekjen e procesit të kompensimit.

45.2. Bazuar në sa më sipër, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, u konstatua se: (i) evidentohen disa ndërtime të ndërtuara nga shtetas të tjerë dhe jo nga bashkëpronarët Sh., përpara vitit 2007, dy nga të cilat në vitet 1998 dhe 1999, përpara periudhës së nisjes së bashkëjetesës apo martesës së subjektit me shtetasin E. Sh.; (ii) nuk rezulton që shtetasi E. Sh. të ketë të drejta mbi këto ndërtime. Në përfundim të hetimit administrativ, trupi gjykues vlerësoi se pavarësisht se ndërtimet mbi truallin objekt verifikimi nuk janë kryer nga bashkëpronarët Sh., ish-bashkëshorti i subjektit duhet dhe ka pasur mundësinë të verifikonte ndërtimet nga persona të tretë dhe t'i deklaronte ato në DPV, ndër vite, dhe në deklaratën *Vetting*, në të cilën mund të jepte sqarime. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

45.3. Në parashtrimet e saj, subjekti paraqiti të njëjtat argumente si në pasuritë e mësipërme. Sipas saj, bashkëpronarët Sh. nuk kanë të drejta pronësie në pasuri të ndërtuara nga të tjerë dhe, për këtë shkak, ndërtimet nuk janë deklaruar nga ish-bashkëshorti i saj. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi të bazuar pretendimin e subjektit dhe nuk gjeti pasoja për shkak të moskryerjes së deklarimeve në deklaratën *Vetting* nga ana e z. E. Sh., në lidhje me ndërtimet informale të ndërtuara nga shtetas të tjerë përpara vitit 2007. Ndërkaq, Komisioni nuk e konsideroi mungesën e deklarimeve nga ana e tij të truallit në bashkëpronësi në DPV-të

⁷⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2022, nga ASHK Tirana Jug në dosjen e Komisionit.

⁷⁹Shihni dokumentet e dërguara nga noteri A. M., protokolluar me nr. *** prot., datë 12.1.2012, në dosjen e Komisionit.

e viteve 2014 dhe 2015 si shkak penalizues për subjektin, sidomos në kushtet kur pronësia mbi truallin është fituar nga ish-bashkëjetuesi me trashëgimi ligjore.

46. Truall me sip. 301 m², z. k. *, Tiranë, bashkëpronësi kontratë pjesëtimi. Vlera: nuk deklarohet. Pjesa takuese: 11.1 %. ILDKPKI-ja ka konstatuar se kjo pasuri është e shpronësuar.**

Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁸⁰ në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se:

- Sipas vërtetimit hipotekor lëshuar në datën 10.1.2013, ZVRPP-ja Tiranë figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve P. Sh., E. Sh., etj., pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 8053.5 m², Q. S., Tiranë, origjina e regjistrimit nr. hipotekor ***, datë 9.3.2012, me shënimin shpronësohet subjekti për sip. totale për 626 m² (325 m² + 301 m²) VKM-ja nr. ***, datë 6.12.2011.

- Sipas VKM-së⁸¹ nr. ****, datë 6.12.2011, "Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" rezulton të jenë në listën e pronarëve që përfitojnë shpërblimin N. Sh., H. Sh., R. Sh., R. Sh. dhe B. Sh. për pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sip. 626 m², në shumën 16.967.104 lekë.

- Sipas informacionit të dhënë nga ZVRPP-ja Tiranë me *e-mail* datë 7.9.2018, drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se për këtë pasuri ka një VKM për shpronësim, duke i bashkëlidhur kartelën e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, si dhe vërtetimin hipotekor të pronës mëmë me shënimet përkatëse për shpronësim.

- Në lidhje me statusin aktual të pasurisë, ZVRPP-ja Tiranë⁸² ka konfirmuar se shtetasi E. Sh. ka të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë nr. ***, z. k. ***, truall me sip. 301 m².

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatua problematika në lidhje me këtë pasuri.

47. Truall me sip. 813 m², z. k. *, në bashkëpronësi, dëshmi trashëgimie. Pjesët takuese: 25 %. ILDKPKI-ja ka konstatuar: (i) fshehje të faktit se truallin me sip. 813 m² është vënë në dispozicion të shoqërisë "****" sh.p.k. për ndërtim sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 10.5.2013, sipas kartelës së pasurisë seksioni "D"; (ii) fshehje e dy ndërtimeve pa leje, ndërtuar në truallin me sip. 813 m², në Tiranë, sipas kartelës së pasurisë seksioni "E"; (iii) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për ndërtimet e mësipërme, vlerën e shpenzuar dhe burimin financiar që ka shërbyer për ndërtimin e tyre.**

47.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁸³ në lidhje me këtë pasuri rezultoi se:

- Sipas kartelës së pasurisë, pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit "truall" me sip. 813 m² figuron në pronësi të shtetasës N. Sh., regjistruar më 15.3.2013.

- Sipas vendimit nr. ***, datë 16.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultojnë si trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësës N. Sh. (ndërruar jetë më 17.2.2006) shtetasit: P. Sh. i biri; R. Sh. e bija; E. Sh. i biri; L. Sh. e bija, të cilët trashëgojnë secili ¼ pjesë.

- Nga verifikimi i deklarimeve të bashkëjetuesit të subjektit vërehet se kjo pasuri, pra, truall me sip. 813 m², nuk është deklaruar prej tij në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, por është deklaruar në DPV-në e vitit 2016.

⁸⁰Shihni aneks nr. 4/9 dhe nr.28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸¹Shihni fletoren zyrtare nr. 174, datë 31.12.2011.

⁸²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë në aneksin nr. 4/9 dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2018, të ZQRPP-së në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸³Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2021, nga ASHK Tirana Veri në dosjen e Komisionit dhe aneksin nr. 4/9 dhe nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

- ASHK Tirana Veri⁸⁴ ka konfirmuar se shtetasi E. Sh. ka të regjistruar në bashkëpronësi me shtetasit L. Sh., P. Sh. dhe R. Sh., pasurinë e llojit “truall” me sip. 813 m², z. k. ***.

- Sipas kartelës së pasurisë nr. ***, lëshuar datë 9.2.2018, rezultojnë të dhënat si vijojnë: (i) në seksionin “D” të kartelës vërehet shënimi “*sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 10.5.2013 noterit E. H. dhe shtesës nr. ***, datë 21.1.2014, që ndryshon nenin 3, vihet në dispozicion të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. për ndërtim, datë regjistrimi 23.7.2014*”; si dhe shënimi “*Mbi këtë pasuri është regjistruar ‘Leje zhvillimore’ në favor të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., në vol. ***, f. ***, të regjistrimit të lejeve zhvillimore datë regjistrimi 21.9.2016*”; (ii) në seksionin “E” të kartelës shënohet “*ka 2 ndërtime pa leje, me datë regjistrimi 14.5.2014*”.

47.2. Në lidhje me vënien në dispozicion të truallit për ndërtim shoqërisë “****” sh.p.k. u administruan aktet si vijojnë⁸⁵:

- Dy prokura të posaçme me data 4.5.2009 dhe 2.5.2013, sipas të cilave të përfaqësuarit E. Sh., etj., kanë emëruar si përfaqësues z. P. Sh. për të kryer të gjitha veprimet ligjore që kanë të bëjnë me kthimin e të gjitha pronave të paluajtshme kudo që ndodhen, që ata kanë në bashkëpronësi të trashëguara nga prindërit e tyre M. dhe N. Sh. si: të realizojë shitje pronash, negocime me të tretë, të lidhë marrëveshje, kontrata sipërmarrjeje, deklarata me shoqëri ndërtimi etj.

- Kontratë sipërmarrjeje (për ndërtim godine), nr. ***, datë 10.5.2013, e lidhur mes pronarëve të truallit, E. Sh., etj., përfaqësuar nga z. P. Sh. dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., sipas së cilës trualli me sip. 813 m², i ndodhur në Rrugën e ***, me nr. pasurie ***, i vihet në dispozicion shoqërisë së ndërtimit me qëllim që ajo me shpenzimet e saj të realizojë mbi këtë pronë ndërtimin e një objekti disakatësh dhe në këmbim të tij pronarët e truallit do të përfitojnë 35% të sipërfaqes së përgjithshme të objektit. Sipas kësaj kontrate, afati i sigurimit të lejes së ndërtimit nga ana e sipërmarrësit do të jetë brenda datës 30.12.2013 dhe objekti do të përfundojë së ndërtuari brenda datës 30.12.2014.

- Akti noterial “shtesë kontrate” nr. **, datë 21.1.2014, i kontratës së sipërmarrjes nr. **, datë 10.5.2013, midis pronarëve të truallit E. Sh., etj., përfaqësuar nga z. P. Sh. dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., sipas së cilës, afati i sigurimit të lejes së lejes së ndërtimit nga sipërmarrësi do të jetë brenda datës 15.6.2014, ndërsa objekti do të përfundojë së ndërtuari brenda datës 30.6.2015.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.1.2014, sipas së cilës deklaruesit E. Sh., L. B., P. Sh. dhe R. T., përfaqësuar sipas prokurave përkatëse nga P. Sh., deklarojnë se janë bashkëpronarë në pasurinë truall me sip. 1000 m², i cili është ndarë në dy parcela si vijojnë: (i) truall me sip. 813 m², në Rrugën e ***, me nr. pasurie ***, z. k. ***; dhe (ii) truall me sip. 187 m², në Rrugën e ***, me nr. pasurie ***, z. k. ***. Gjithashtu deklarojnë se janë dakord me studimin PDV që është bërë për zhvillimin e zonës, kurse për truallin me sip. 187 m² (të cilën e përfitojnë si trashëgimtarë të nënës së tyre N. Sh.) nuk pretendojnë për marrje leje ndërtimi as në të ardhmen pasi ky truall përfshihet në studimin e mësipërm.

47.3. Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime lidhur me: (i) mosdeklarimin e faktit se trualli është vënë në dispozicion të shoqërisë “****” sh.p.k. për ndërtim, duke paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 10.5.2013, si dhe çdo marrëveshje tjetër të lidhur me këtë shoqëri, në lidhje me këtë pasuri; (ii) informacion mbi dy ndërtimet pa leje mbi këtë pasuri, në lidhje me kohën e ndërtimeve, investitorin dhe ndërtuesin, numrin e kateve dhe sipërfaqet, shoqëruar me dokumentacion provues si: projekti, preventivat, fotografi, kontrata etj.; (iii) arsyet e mosdeklarimit të këtyre ndërtimeve në deklaratën *Vetting*; (iv) informacion mbi

⁸⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2021, nga ASHK Tirana Veri dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2018, të ZQRPP-së në aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁵Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje të datës 21.01.2022, të noterit E. H. në dosjen e Komisionit.

përdorimin e këtyre dy ndërtimeve. Në përgjigjet e saj subjekti deklaroi se nuk disponon informacion në lidhje me këto pasuri, pasi nuk rezulton bashkëpronare dhe, për këtë shkak, nuk legjitimohet për marrjen e informacionit. Sa i takon ndërtimeve të paligjshme ajo ka deklaruar se këto ndërtime nuk janë kryer nga ish-bashkëshorti dhe se veprimet noteriale janë kryer prej vëllait të ish-bashkëshortit, shtetasit P. Sh..

47.4. Në pyetjen e datës 10.3.2022, shtetasi E. Sh. ka deklaruar se nuk ka informacion mbi ndërtimet, pasi me të gjitha veprimet është marrë vëllai i tij P. Sh., me të cilin nuk ka marrëdhënie dhe komunikim për shkak të mosmarrëveshjeve në administrimin dhe ndarjen e pronave të tyre të përbashkëta.

47.5. Në lidhje me dy ndërtimet pa leje të rezultuara në kartelën e pasurisë nr. *** u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

- Nga informacioni i përcjellë nga ASIG, sipas fotografimeve përkatëse, evidentohen dy ndërtime për vitet 1994, 1999 dhe 2001, ndërsa në vitet 2007 dhe 2015 evidentohet një ndërtesë me sipërfaqe dhe lartësi relativisht të njëjta. Pra, nuk vërehen investime të dallueshme në periudhën 2007 – 2015. Në vitin 2018 evidentohen dy pallate.

- Nga verifikimi në *Google Map*, në qershor të vitit 2016 vërehet ekzistenca e dy pallateve. Pra, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, duket se ndërtimet pa leje janë prishur në funksion të zhvillimit të truallit nga shoqëria “***” sh.p.k.

47.6. Bazuar në të gjitha sa më sipër, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* mbi truallin objekt verifikimi u vërtetua të jenë ndërtuar dy pallate nga shoqëria “***” sh.p.k., me të cilën subjekti dhe bashkëpronarë të tjerë të truallit kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. **, datë 10.5.2013, sipas së cilës ata do të përfitojnë 35% të sipërfaqes së përgjithshme të objektit.

47.7. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për konstatimet, ku duket se: (i) është e paqartë nëse ish-bashkëshorti i subjektit dhe/ose bashkëpronarët e tjerë të truallit e kanë fituar në rrugë ligjore pronësinë mbi 35% pjesë takuese në të dy pallatet e ndërtuar dhe cilat janë pjesët takuese konkrete të tyre; (ii) në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të e vitit 2014 e në vijim, pra gjatë periudhës së bashkëjetesës, nuk është deklaruar fakti i vënies në dispozicion të truallit me sip. 813 m² për ndërtim shoqërisë “***” sh.p.k., sipas shënimit në seksionin D të kartelës; (iii) në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të për vitet 2014 e në vijim nuk janë deklaruar dy pallatet e ndërtuar nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe pjesa takuese e shtetasit E. Sh. në këto pasuri.

47.8. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se kontratat e sipërmarrjes janë hartuar midis shtetasit P. Sh., si përfaqësuesi me prokurë i bashkëpronarëve të truallit dhe shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k. dhe se pjesët faktike nuk janë ndarë për shkak të mosparaqitjes së shtetasit P. Sh. për shkaqe të panjohura. Sipas saj, mosdeklarimi në këtë rast i kontratës së sipërmarrjes është për rrethana tërësisht objektive dhe në kushtet kur pronësia mbi tokën ka burim tërësisht të ligjshëm, mosdeklarimi i marrëdhënies së sipërmarrjes nuk ka se si të ketë ndonjë qëllim të paligjshëm në lidhje me kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje të shoqërisë “***” sh.p.k., e cila e informon se: “... për sa i përket pjesëve takuese të bashkëpronarëve të truallit akoma nuk është nënshkruar një kontratë përfundimtare, pasi edhe pse kemi pasur kontakte të shpeshta me shtetasin z. P. Sh., ai nuk është paraqitur për arsye të panjohura nga ana jonë”.

47.9. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se mosdeklarimi në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 të truallit me sip. 813 m², të fituar me trashëgimi ligjore nga ana e z. E. Sh., si dhe mungesa e deklarimeve në lidhje me vënien në dispozicion të truallit për ndërtim shoqërisë “***” sh.p.k. dhe dy pallateve të ndërtuara në këtë truall, janë pasaktësi për të cilat subjekti duhet të ishte kujdesur që të mos ndodhnin pavarësisht marrëdhënieve me ish-

bashkëshortin. Por, këto pasaktësi nuk mund të penalizojnë subjektin e rivlerësimit në kuadër të kërkesave të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur: (i) nuk u vërtetuan investime apo shpenzime të shtetasit E. Sh. apo bashkëpronarëve Sh. në këto ndërtime, të cilat vijojnë të jenë nën administrimin e shoqërisë ndërtimore. Për më tepër, kontrata e sipërmarrjes parashikon që ndërtimi i pallateve do të bëhej me investim të shoqërisë ndërtimore; (ii) nuk u vërtetua që ata të kenë përfituar dhe regjistruar në rrugë ligjore pjesën e tyre takuese në dy pallatet e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k. apo të kenë shfrytëzuar/përdorur pjesët e tyre takuese në natyrë; (iii) trualli objekt verifikimi është përfituar me trashëgimi ligjore, ndërkohë që nuk u vërtetua asnjë lidhje apo ndërveprim nga ana e subjektit apo ish-bashkëshortit me investimin e kryer nga shoqëria “****” sh.p.k. Në këto rrethana, nga Komisioni vlerësohet se në mosdeklarimet e z. E. Sh. mungon ana subjektive - qëllimi për të fshehur ndonjë pasuri, konkretisht pjesët *ideale* të pandara në pallatet e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në të cilët ai nuk ka kryer asnjë investim që do të bënte të domosdoshëm justifikimin e të ardhurave.

48. *Truall me sip. 187 m², z. k. ***, në bashkëpronësi, dëshmi trashëgimie. Pjesa takuese: 25 %.* ILDKPKI-ja ka konstatuar fshehje të tri ndërtimeve të paligjshme, ndërtuar në truallin me sip. 187 m², sipas kartelës së pasurisë në seksionin E. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me ndërtimet e mësipërme, vlerën e shpenzuar dhe burimin financiar që ka shërbyer për ndërtimin e tyre.

48.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet ⁸⁶në dosje rezultoi se:

- Shtetasi E. Sh. ka të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë nr. ***, z. k. ***, truall me sip. 187 m² dhe se origjina e kësaj pasurie është vendimi nr. *** prot., datë 2.4.2001, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave -ish Pronarëve, Bashkia Tiranë.

- Kjo pasuri nuk është deklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2014, por e ka deklaruar në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën *Vetting*.

- Sipas kartelës së pasurisë nr. ***, z. k. ***, lëshuar në datën 9.2.2018, rezulton se në seksionin “E” është shënuar “*Ka 3 ndërtime pa leje*”, regjistruar në datën 14.5.2014.

- Në DPV-të e viteve 2014 – 2016 dhe në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesi nuk ka deklaruar në lidhje me 3 ndërtime të ndodhura mbi këtë pasuri dhe as dhënien e truallit në bashkëpronësi për ndërtim shoqërisë “****” sh.p.k.

- Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja rezulton se pasuria nr. ***, objekt verifikimi është kufitare me pasurinë nr. ***, z. k. ***, trajtuar në paragrafin 47 të këtij vendimi dhe sa i takon shënimit në seksionin “E” të kartelës së kësaj pasurie në lidhje me tri ndërtimet pa leje, vlen i njëjti trajtim dhe vlerësim si për pasurinë nr. ***.

- Sa i takon shënimit në kartelën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, në seksionin “E”, ku është shënuar se ka 3 ndërtime pa leje, me datë regjistrimi 14.5.2014, nga informacioni i përcjellë nga ASIG-u, referuar fotografimeve ajrore, vërehet se kanë ekzistuar dy ndërtime që prej vitit 1994, ndërkohë që situata ndërtimore sipas fotografimit të vitit 2007 me atë të vitit 2015 duket e njëjtë, me një ndryshim të vogël në sipërfaqe. Pasuria nr. *** është kufitare me pasurinë nr. ***, z. k. *** dhe vërehet se edhe mbi këtë pasuri përkojnë dy pallate sipas fotografimit të vitit 2018, siç u shpjegua më sipër.

48.2. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi truall me sip. 187 m², u vërtetua se: (i) mbi truall evidentohen 2 ndërtime që kanë ekzistuar që nga viti 1994 deri në vitin 2001, ndërkohë në vitin 2007 evidentohet vetëm një ndërtesë, e cila vijon deri në vitin 2015 me sipërfaqe relativisht më të rritur; (ii) këto ndërtime janë prishur dhe në vend të tyre janë ndërtuar dy pallate nga shoqëria “****” sh.p.k. (trajtuar në paragrafin 47), të

⁸⁶Shihni aneksin nr. 4/9 dhe nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

cilët nga verifikimi në *Google Map* rezultojnë të ndërtuara në vitin 2016) dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nga pikëpamja faktike ndërtimet pa leje nuk kanë ekzistuar.

49. *Autoveturë me targa ****, vit prodhimi 2003, blerë me kontratën nr. ***, datë 21.5.2010. *Burimi i krijimit: shitja e fabrikës. Vlera: 6.000 euro. Pjesa takuese: 100%*. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

49.1. Gjatë hetimit administrativ nga aktet⁸⁷ në dosje rezultoi se:

- sipas certifikatës së pronësisë (klubi automobilistik i Italisë) të datës 29.3.2010, mjeti figuron në pronësi të shtetasit E. H.;
- me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 21.5.2010, shtetasi E. Sh. i ka blerë shtetasit E. H. mjetin në çmimin 6.000 euro, të cilin e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014;
- DPSHTRR-ja⁸⁸ ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të shtetasit E. Sh. mjetin me targa ***;
- në lidhje me burimin e krijimit nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme nga shitja e fabrikës dhe, për rrjedhojë, blerja e mjetit në vitin 2010 është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të këtij viti, e cila rezultoi me balancë negative⁸⁹.

49.2. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit se ish-bashkëjetuesi nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin objekt verifikimi në vitin 2010. Në parashtrime subjekti pretendon që analiza financiare e saj duhet të kryhet e shkëputur nga ajo e bashkëshortit, pasi bashkëjetesa me z. E. Sh. ka filluar në vitin 2012, pretendim i cili në përfundim u konsiderua i bazuar. Për rrjedhojë, balanca negative e vitit 2010 e cila i përket periudhës para bashkëjetesës (analizuar dhe pasqyruar në tabelën në paragrafin nr. 20.4. të këtij vendimi), nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

50. Në deklaratën *Vetting* ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Shoqëria ‘****’ sh.p.k. Vlera kapital: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁹⁰ rezultoi se:

- QKB-ja ka konfirmuar se shtetasi E. Sh. figuron administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***, regjistruar me vendimin nr. ***, datë 3.10.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke bashkëngjitur ekstraktin historik të shoqërisë, sipas të cilit, kjo shoqëri është regjistruar në datën 3.10.1994, me kapital 100.000 lekë, me status aktiv dhe shtetasi E. Sh. figuron ortak me 100% të kuotave.
- Në DPV-në e vitit 2014 shtetasi E. Sh. e ka deklaruar vlerën e kapitalit dhe pjesën takuese.
- Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kapitalit.
- Në pyetjen e datës 10.3.2022, z. E. Sh. ka deklaruar se shoqëria “****” sh.p.k. është krijuar qysh në vitin 1994, me të ardhura nga puna në emigracion, por pa provuar burimin e ligjshëm të tyre pasi ka punuar në të zezë. Për rrjedhojë, pagesa e shumës së kapitalit fillestar prej 100.000 lekësh nuk është konsideruar si e krijuar me të ardhura të ligjshme (përfshirë te pasuritë e ish-bashkëshortit për periudhën para bashkëjetesës).

51. Në deklaratën *Vetting* ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Shoqëria ‘****’ sh.p.k. Burimi shitja e anijeve, shitja e fabrikës, investimi i kryer në kohë të ndryshme, përfshirë dhe*

⁸⁷Shihni aneksin nr. 4/12 dhe aneksin nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁸Shihni shkresat nr. *** prot., datë 28.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 12.9.2017, nga DPSHTRR-ja në aneksin nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁹Shihni analizën financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit për periudhën pas vitit 2009.

⁹⁰Shihni aneksin nr. 4/13 dhe aneksin nr. 31 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.8.2017, nga QKB-ja në aneksin nr. 31 në dosjen e ILDKPKI-së.

investimi në natyrë, finalizuar me kontratën e shitjes së kuotave. Vlera: 334.114.740 lekë. Pjesa takuese: 51 %". ILDKPKI-ja ka konstatuar se: (i) mungon burimi financiar i ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e anijeve "****" dhe "****" në vitin 1995 në shumën totale 158.000.000 lekë; (ii) mungon dokumentacioni i plotë justifikues ligjor, lidhur me shitjen e anijeve "****" dhe "****" në vitin 1996, si dhe është e paqartë nëse janë paguar detyrimet tatimore për shitjen e kryer; (iii) mungon burimi financiar i ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e aksioneve në shoqërinë "****" sh.p.k., në pjesën takuese 51 %, në vlerën 170.398.517 lekë në vitin 2006.

51.1. Pavarësisht se ish-bashkëjetuesi i subjektit ka blerë 51 % të kuotave të shoqërisë në vitin 2006, pra përpara fillimit të bashkëjetesës me subjektin, nga Komisioni u kryen disa verifikime⁹¹ në lidhje me shoqërinë "****" sh.p.k., në përfundim të të cilave në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKR-së, është evidentuar se qysh nga themelimi i shoqërisë në vitin 2000, shtetasi F. Gj. ka qenë ortak i vetëm dhe administrator i kësaj shoqërie deri në datën 29.5.2006, datë kur është regjistruar në QKR vendimi nr. *** i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në vendimin nr. **, datë 12.4.2006, të ortakut të vetëm F. Gj., sipas të cilit ai mban 49% të aksioneve, ndërsa 51% e tyre në vlerën 170.398.517 lekë ia shet z. E. Sh., i cili është emëruar edhe administrator i kësaj shoqërie.

- Sipas ekstraktit historik të shoqërisë "****" sh.p.k., me NIPT ***, me datë regjistrimi 28.9.2000, me kapital 334.114.740 lekë, me status aktiv, E. Sh. figuron administrator dhe ortak me 51% të kuotave.

- Shtetasi E. Sh. e ka deklaruar në DPV 2014 shoqërinë "****" sh.p.k. dhe kapitalin fillestar 334.114.740, e cila përbën 100% të vlerës së aksioneve të kësaj shoqërie.

- Sipas kontratës së shitjes së kuotave 12.4.2006, shtetasi F. Gj. administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë "****" sh.p.k. i ka shitur shtetasit E. Sh. 51% të kuotave të kësaj shoqërie në vlerën 170.398.517 lekë, pa u përcaktuar mënyra e likuidimit të shumës.

- Subjektit iu kërkuan sqarime mbi kohën e saktë dhe mënyrën e likuidimit të shumës për blerjen e kuotave dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se nuk ka informacion tjetër për këtë blerje kuotash, e cila ka ndodhur para bashkëjetesës.

- Nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i shoqërisë "****" sh.p.k.⁹²

51.2. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e 51% kuotave në vitin 2006, në deklaratën *Vetting* shtetasi E. Sh., përveç shitjes së anijeve dhe fabrikës, ka deklaruar edhe burimin *investimi i kryer në kohë të ndryshme, përfshirë dhe investimi në natyrë, finalizuar me kontratën e shitjes së kuotave*. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të sqarojë se çfarë përfaqëson burimi i deklaruar *investim i kryer në kohë të ndryshme, përfshirë dhe investimi në natyrë*, për të cilin subjekti nuk dha informacion. Sa i takon blerjes dhe shitjes së anijeve, si dhe fabrikës, nga analiza e fakteve dhe provave të administruara duket se: subjekti nuk ka provuar me dokumentacion të ardhura të ligjshme: (i) për blerjen e fabrikës; (ii) nga shitja e fabrikës; (iii) për blerjen e anijeve; si dhe (iv) të ardhura nga shitja e anijeve dhe, për rrjedhojë, blerja e kuotave të shoqërisë në vitin 2006 (përpara bashkëjetesës) nuk është bërë me burime të ligjshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

⁹¹Shihni aneksin nr. 4/14 dhe aneksin nr. 31, 35 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹²Nga verifikimi i faqes zyrtare të QKR-së nuk është gjendur asnjë bilanc i publikuar i kësaj shoqërie dhe, për rrjedhojë, nuk ka asnjë dokument për të evidentuar të ardhura personale apo dividens të shpërndarë. Gjithashtu, nga shkresat e përcjella nga zyra e tatimeve dhe/ose ISSH-ja nuk është evidentuar përfitim page nga z. E. Sh. nga kjo shoqëri.

51.3. Në parashtrimet e saj, pavarësisht se subjekti është përpjekur të japë disa argumente në lidhje me blerjen e anijeve, të ardhurat nga shitja e anijeve dhe fabrikës, ka vënë theksin te fakti se blerja e kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k. është shumë kohë përpara fillimit të bashkëjetesës me z. Sh. dhe, për këtë arsye, ajo nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar për efekt të ligjit nr. 84/2016 në deklaratën *Vetting* pjesëmarrjen e tij në 51% të kuotave në shoqërinë “*****” sh.p.k., deklarim i kryer që në deklaratën e interesave periodike vjetore për vitin 2014, kur i ka lindur detyrimi. Është e vërtetë se subjekti nuk arriti të vërtetojë me dokumentacion të ardhura të ligjshme të ish-bashkëshortit që kanë shërbyer për blerjen e fabrikës apo të ardhura nga shitja e saj, të ardhura për blerjen e anijeve apo të ardhura nga shitja e tyre dhe, për rrjedhojë, nuk vërtetoi blerjen e kuotave të shoqërisë në vitin 2006 me burime të ligjshme. Por ky fakt nuk mund ta penalizojë atë për shkak se i takon disa viteve përpara fillimit të bashkëjetesës me z. E. Sh. dhe, për më tepër, nuk u vërtetua asnjë lidhje a rrethanë që vërteton lidhje të subjektit me kuotat e shoqërisë “****” sh.p.k.

52. Në deklaratën *Vetting*, z. E. Sh. ka deklaruar: “*Para gjendje cash. Burimi nga shitja e tokës në ***, ***. Vlera: 10.000 euro. Pjesa takuese: 100 %*”. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se ka pasur mundësi për të akumuluar gjendjen *cash*.

Në lidhje me këtë likuiditet *cash*, u konstatua se:

52.1. Sa i takon tokës në ***, z. E. Sh. ka deklaruar se kjo tokë është blerë në vitin 2010, në shumën 30.000 euro me burim të ardhura nga shitja e fabrikës (trajtuar në paragrafin nr. 40 të këtij vendimi). Ndërkohë, me deklaratën për heqje dorë nga pronësia me datë 18.1.2017 (përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, në datën 28.1.2017), shtetasi E. Sh. ka deklaruar se për tokën truall (ullishte) me sip. 2000 m², në Komunën *** Tiranë, ka marrë nga shtetasi A.S. shumën 15.000 euro *cash*, duke deklaruar se heq dorë nga kjo pasuri dhe nje pronar z. A. S.

52.2. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës ku duket se: (i) nuk vërtetohet shitja e pasurisë në *** me një akt kontrate shitje të z. A. S.; (ii) subjekti nuk ka mundur të provojë burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj toke me të ardhura të ligjshme dhe, për këto arsye, të ardhurat e pretenduara nga shitja prej 15.000 euro më 18.1.2017, nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme. Për rrjedhojë, shuma *cash* prej 10.000 euro nuk është krijuar me të ardhura të ligjshme.

52.3. Në parashtrimet e veta, subjekti ka pretenduar se shuma *cash* prej 10.000 euro është krijuar me burime të ligjshme duke parashtruar se si burim për blerjen e pasurisë tokë me sipërfaqe prej 2.000 m², në shumën 30.000 euro, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e fabrikës, nga të cilat, për shumën 7.000.000 lekë është paguar tatimi mbi të ardhurat. Si rrjedhojë, sipas subjektit, edhe të ardhurat në shumën 15.000 euro duhet të konsiderohen si burime të ligjshme dhe, për pasojë, edhe gjendja *cash* në shumën 10.000 euro është krijuar prej tij me të ardhura të ligjshme.

52.4. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se pavarësisht se subjekti ka vërtetuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e fabrikës në vitin 2006 në shumën 7.000.000 lekë, të cilat pretendohet se kanë shërbyer si burim për blerjen e tokës në *** në vitin 2010, kjo nuk mjafton për të konsideruar të ligjshme të ardhurën prej 15.000 euro të pretenduar të përfituar nga shitja e kësaj pasurie më 18.1.2017, pasi: (i) nuk ka dokumentacion që provon blerjen e tokës në vitin 2010; (ii) nuk është provuar shitja e tokës me akt noterial më 18.1.2017 dhe, për rrjedhojë, nuk vërtetohet marrja e shumës prej 15.000 euro në janar të vitit 2017. Në këto rrethana, shuma 15.000 euro, e deklaruar si e përfituar nga shitja e tokës në *** nuk mund të konsiderohet si e ardhur e përfituar, për më tepër si e ardhur e ligjshme dhe, për rrjedhojë,

shuma *cash* prej 10.000 euro e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting* nuk u konsiderua me burim të ligjshëm.

Konstatime të tjera në lidhje me ish-bashkëshortin E. Sh.

53. Në DPV-në e vitit 2014, në rubrikën *“Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit ish-bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar: “Hua shtetasit S. B. në Gjakovë, Kosovë, që nga viti 2008 për biznes. Vlera: 200.000 euro”*. Në DPV-të e viteve 2015-2016 dhe në deklaratën *Vetting* z. E.Sh. nuk ka deklaruar asnjë fakt në lidhje me këtë hua.

53.1. Në lidhje me këtë hua, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikimet si vijojnë:

- Në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 26.3.2016, subjekti ka deklaruar: *“Hua e dhënë shtetasit S. B. prej 200.000 euro nuk janë para në formë likuiditeti, por shërbime të kryera nga shoqëria ‘***’ sh.p.k., për llogari të fabrikës së pasurimit të kromit në Gjakovë ‘***’, detyrime ende të pashlyera, të kryera pa dokumente në mirëbesim”*.

- E pyetur nga Komisioni, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, nuk ka informacione shtesë në lidhje me këtë hua.

- Nga verifikimet e kryera nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi⁹³ me shtetasin S. B., apo përfshirje të tij në veprimtari të krimin të organizuar⁹⁴.

- Ne pyetjen e datës 10.3.2022, z. E. Sh. deklaroi se nuk i ka dhënë hua z. S. B., por ky i fundit duhet t’i japë shumë 200.000 euro për shërbimin e kryer për transport kromi. I pyetur nëse ai e ka marrë këtë shumë nga z. B., z. E. Sh. deklaroi se ka marrë disa shuma pjesë-pjesë, por jo të gjithë vlerën, por pa i vërtetuar këto deklarime me akte shkresore. Sipas z. E. Sh., kjo shumë duhet të konsiderohet si e ardhur që do të paguhej te ai dhe jo një hua e dhënë prej tij.

53.2. Në kushtet kur deklaratimet e subjektit dhe z. E. Sh. mbeten në kuadër deklarativ për shkak mungese të çdolloji dokumentacioni në lidhje me shumë 200.000 euro, Komisioni ka marrë të mirëqena deklaratimet e subjektit në DPV-në për vitin 2014, duke e konsideruar këtë shumë si hua, e cila e ka filluesin që nga viti 2008. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë hua, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se:

i) në DPV-në e vitit 2014 nuk është deklaruar burimi i krijimit të huas prej 200.000 euro dhe as të jenë dhënë sqarime se kjo shumë nuk është një hua e mirëfilltë;

ii) ka mospërputhje në deklaratimet e dhëna, pasi në DPV-në për vitin 2014 shuma 200.000 euro deklarohet si hua e dhënë, ndërsa gjatë hetimit administrativ deklarohet si e ardhur e pritshme për shërbime të kryera;

iii) nuk ka një dokument shkresor që provon huan apo ndonjë marrëdhënie tjetër mes palëve, si dhe nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme që të justifikojnë dhënien e saj;

iv) nuk ka deklarime në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016, në lidhje me shlyerjen e huas nga shtetasi S. B. dhe asnjë dokument shkresor që të vërtetojë dhënien e ndonjë shume prej tij dhe, për pasojë, nuk ka informacion nëse kjo hua është shlyer ose jo;

v) në deklaratën *Vetting*, ku subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e çdo detyrimi financiar si dhe i është dhënë mundësia për të paraqitur një deklaratë të re dhe të detajuar në lidhje me interesat pasurore, nuk ka kryer deklarime në lidhje me huan e deklaruar në DPV-në e vitit 2014, si dhe nuk ka paraqitur asnjë rrethanë të pretenduar gjatë hetimit administrativ;

⁹³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.12.2021 nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në dosjen e Komisionit.

⁹⁴Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.12.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

vi) nuk ka informacion nëse kjo marrëdhënie ka lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., apo me individin E. Sh., pasi mungojnë të dhënat analitike në bilancet e shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2008 e në vijim.

Për rrjedhojë, veprimet e deklaruara nga subjekti në DPV-në e vitit 2014 ashtu si dhe në deklaratimet gjatë hetimit janë për veprime të pajustificuara ligjërisht dhe financiarisht. Gjithashtu, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të paraqesë të dhëna analitike në lidhje me regjistrimin e veprimeve kontabël për vitin 2008 dhe të çdo viti tjetër, kur shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë vlera monetare nga z. S. B. ose nga fabrika e pasurimit të kromit në Gjakovë, sikurse z. E. Sh. pretendon.

53.3. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se shuma e deklaruar në DPV-në e vitit 2014 nga z. E. Sh. i përkiste tërësisht shoqërisë “****” sh.p.k. dhe nuk ishte një e ardhur personale e tij. Sipas saj, në pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. nuk ka një të drejtë ndaj fabrikës së pasurimit të kromit “****”, Gjakovë, pasi për këtë ndërmjetësim nuk u nënshkrua asnjë dokument ligjor apo kontratë shërbimi. Subjekti pretendon se deklarimi i huas në DPV-në e vitit 2014, kur ka qenë edhe hera e parë e deklarimit, deklarimi i huas është një pasaktësi e kryer prej bashkëjetuesit të saj, pasi kjo shumë nuk ishte një e ardhur personale e tij. Në deklaratimet vijuese të viteve 2015 dhe 2016, kur ajo kishte kuptuar natyrën e transaksionit i ka shpjeguar ish-bashkëjetuesit se kjo marrëdhënie nuk duhej deklaruar për shkak se i përkiste shoqërisë dhe jo atij si individ dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar as në deklaratën *Vetting*.

53.4. Në përfundim të procesit, Komisioni ndodhej në pamundësi të plotë për të vlerësuar në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti dhe ish-bashkëjetuesi i saj, se shuma prej 200.000 euro nuk është një hua e mirëfilltë dhe se kjo shumë është për shkak të kryerjes së shërbimeve të pretenduara nga shoqëria “****” sh.p.k. për llogari të fabrikës së pasurimit të kromit “****”, Gjakovë. Në këto kushte, Komisioni i është referuar DPV-së së vitit 2014, ku ish-bashkëjetuesi i subjektit si vit të dhënies së huas ka deklaruar vitin 2008. Kjo deklaratë është e vetmja provë shkresore, e cila tregon se marrëdhëniet e huas apo çdolloj marrëdhënie tjetër e pretenduar i përket periudhës përpara bashkëjetesës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Sa i takon mungesës së mëtejshme të deklarimeve, duke përfshirë edhe deklaratën *Vetting*, pavarësisht pretendimit të subjektit se huaja nuk ka lidhje me shtetasin E. Sh. si individ dhe se huaja ishte deklaruar gabimisht prej tij në DPV-në e vitit 2014, Komisioni çmon se ka pasaktësi në deklarime, pasi ish-bashkëshorti i saj ka pasur detyrimin ligjor të deklarimit në lidhje me detyrimet financiare të huas, ndërkohë që, gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting* subjekti apo ish-bashkëshorti kanë pasur të gjithë mundësinë të jepnin shpjegime në lidhje me sa kanë pretenduar për huan objekt verifikimi, gjë të cilën nuk e kanë bërë. Por, në vlerësim të përgjithshëm të të gjitha rrethanave, Komisioni i gjen pa pasoja mosdeklarimet, në kushtet kur, si në DPV ashtu edhe në deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk ka pretenduar të ardhura të përfituara nga kthimi i huas apo shlyerja e detyrimit të lindur që në vitin 2008, pra përpara fillimit të bashkëjetesës me z. E. Sh.. Për më tepër, në zbatim të parimit të objektivitetit, mungesa e deklarimeve vlerësohet se ka ardhur edhe për shkak të marrëdhënieve të subjektit me z. E. Sh..

54. Në DPV-në e vitit 2014 bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar: *“Hua 200.000 euro nga fabrika e pasurimit të kromit, Bulqizë, B. K. Nga kjo hua janë shlyer 105.000 euro dhe 4.000.000 lekë”*. Në DPV-të e viteve 2015-2016 dhe në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesi i subjektit nuk ka deklaruar asnjë fakt në lidhje me këtë hua.

54.1. Në lidhje me këtë hua, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikimet si vijojnë:

- Në deklaratimet në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 26.3.2016, subjekti ka sqaruar se: *“Për huan e marrë nga fabrika e pasurimit të kromit, Bulqizë, në shumën 200.000 euro ****”*

sh.p.k. ka paraqitur akt rakordimin e datës 3.4.2015, ku pasqyrohet detyrimi për demontim anijeje, si dhe nxjerrje llogarie ku rezulton kreditimi në datën 18.3.2013, pra duke i cilësuar si veprime mes shoqërive”.

- Me qëllim sqarimin e këtyre rrethanave subjektit, si dhe çdo fakti në lidhje me huan, subjektit iu kërkua të paraqesë shpjegime e dokumentacion, sikurse iu kërkua të japë sqarime mbi mosdeklarimin e këtij detyrimi në DPV-të e viteve 2015-2016, si dhe në deklaratën *Vetting*. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i është referuar përsëri deklarimeve në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, ku dhe është dorëzuar akti i rakordimit midis shoqërive. Më tej, ajo ka informuar se pas marrjes së pyetësorit ka kontaktuar shtetasin B. K., i cili i ka konfirmuar verbalisht se detyrimet janë midis shoqërive. Për këtë arsye, sipas saj, për sa kohë detyrimi ndërmjet tyre është midis shoqërive, nuk duhet të deklarohet si në DPV ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.

- Nga verifikimet e kryera nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi⁹⁵ me shtetasin B. K. apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar⁹⁶.

- Sipas akt rakordimit datë 3.4.2015, lidhur midis shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe fabrikës së pasurimit të kromit, Bulqizë, kjo e fundit: (i) ka paguar Ministrisë Financave të Malit të Zi me shumën 200.000 euro në nëntor të vitit 2012; (ii) i ka dhënë shoqërisë “*****” sh.p.k. shumën prej 12.857.385 lekësh; (iii) z. B. K. i ka dhënë hua *cash* z. E. Sh. shumën 25.000 euro. Në këtë dokument janë pasqyruar edhe disa likuidime të kryera nga shoqëria “*****” sh.p.k., si dhe detyrimi i mbetur.

- Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë në “Raiffeisen Bank” të shoqërisë “*****” sh.p.k. rezulton se në datën 18.10.2013 ka hyrë në llogari të kësaj shoqërie shuma 12.857.385 lekë nga fabrika e pasurimit me përshkrimin “*dhënie huaje*” dhe në të njëjtën datë, e njëjta shumë është transferuar te dega e thesarit Tiranë me përshkrimin “*zhdoganim anije jashtë përdorimi skrap TVSH...taxa doganore, ‘***’ sh.p.k.*”.

- Në pyetjen e datës 10.3.2022, i pyetur mbi huan e marrë dhe shumat e shlyera, z. E. Sh. deklaroi se këto veprime janë pasqyruar në bilancet e shoqërisë “*****” sh.p.k.

54.2. Nga analiza e provave të administruara si më sipër u vërtetua se:

i) Nga verifikimi i bilancit për vitin 2013 të shoqërisë “*****” sh.p.k. rezulton se shuma prej 12.857.385 lekësh është e regjistruar si hua e shoqërisë në pasqyrat financiare të këtij viti⁹⁷.

ii) Nga aktrakordimi datë 3.4.2015 konstatohet se z. E. Sh. ka marrë prej z. B. K. një hua prej 25.000 euro, që i bashkëngjitet huas prej 200.000 euro, dhënë te shoqëria “*****” sh.p.k. nga fabrika e pasurimit të kromit.

iii) Nga shqyrtimi i bilancit të shoqërisë “*****” sh.p.k. për vitin 2015 rezulton e regjistruar si hua shuma 35.762.764 lekë ose rreth 260.000 euro⁹⁸. Në bilancin e viteve 2016 – 2020, rezulton e regjistruar si hua shuma 12.857.385 lekë, çka provon se në vitin 2016 është shlyer një pjesë e huas.

54.3. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, është vërtetuar që shoqëria “*****” sh.p.k. ka marrë hua në total shumën 260.000 euro, nga të cilat 225.000 euro prej fabrikës

⁹⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.12.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në dosjen e Komisionit.

⁹⁶Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.12.2021 nga SPAK në dosjen e Komisionit.

⁹⁷Shihni pasqyrat financiare të shoqërisë “*****” sh.p.k. për vitin 2013, Kapitulli Pasivi, zëri “detyrime kreditore”, Deb.Kred. të tjerë.

⁹⁸Shihni faqen 11 “Informata dhe sqarime të nevojshme” të bilancit financiar të vitit 2015, të shoqërisë “*****” sh.p.k., ndodhur në faqen e QKB-së.

së pasurimit të kromit Bulqizë dhe zotit K., të cilat janë transaksione të lidhura me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe jo me bashkëshortin e subjektit si individ dhe, për rrjedhojë, kjo hua e cila nuk do duhej të ishte deklaruar nga ana e z. E. Sh. nuk mund të jetë objekt i vlerësimit nga Komisioni.

55. Në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit tip “Jeep”, me targa ***, me kontratë nr. ***, datë 13.1.2016, në shumën 5.000 euro. Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje⁹⁹ rezultoi se:

- Ky automjet ishte blerë nga shtetasi E. Sh., sipas deklaratës së shitjes (vërtetuar përkthimi nga serbishtja) të datës 12.4.2010, në shumën 3.000 euro dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2014 prej tij, por pa deklaruar vlerën dhe burimin e krijimit.

- Automjeti i është shitur në vitin 2016 shtetasit N. L. B. (burri i motrës) në shumën 5.000 euro, me kontratë shitjeje të datës 13.1.2016.

- DPSHTRR-ja nuk e ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të z. E. Sh. këtë automjet.

- E pyetur mbi arsyen përse ky automjet i blerë në vitin 2010 në shumën 3.000 euro është shitur pas 6 vitesh rreth 1.7 herë më shtrenjtë, subjekti ka deklaruar se nuk ka informacion lidhur me këtë fakt. Sipas saj, ky është një veprim juridik personal i ish-bashkëshortit të saj dhe se ky automjet dhe të ardhurat nga shitja e tij bëjnë pjesë në pasuritë vetjake të tij të përfituara përpara bashkëjetesës.

- Në pyetjen e datës 10.3.2022, z. E. Sh. deklaroi se në fakt e ka blerë lirë automjetin nga një miku i tij, ndërkohë që kushtonte 8.000 ose 9.000 euro. Ai ka qenë një automjet shumë i mirë dhe kur e kishte shitur vlente në shumën 5.000 euro.

- Vlera e blerjes së këtij automjeti ishte përfshirë në analizën financiare të vitit 2010, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit.

- Me ndryshimin e fillimit të vitit të bashkëjetesës, vlera e blerjes së automjetit nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 2010.

- Meqenëse bashkëshorti i subjektit nuk ka provuar burimin e ligjshëm të blerjes së këtij automjeti në vitin 2010 përpara bashkëjetesës, asnjë e ardhur nga shitja e tij nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 2016.

56. Në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar shitjen e mjetit tip “Chrysler” me targa ***, sipas kontratës nr. ***, datë 27.10.2016, në shumën 40.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje¹⁰⁰ rezultoi se:

- Ky automjet ishte blerë nga shtetasi E. Sh. në shumën 300.000 lekë prej shtetasit D. S. T., sipas kontratës së shitblerjes datë 21.3.2011, deklaruar në DPV-në e vitit 2014, por pa deklaruar vlerën e burimin e krijimit.

- Në vitin 2016 ky automjet iu shit shtetasës D. D. në shumën 40.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes datë 27.10.2016.

- DPSHTRR-ja konfirmoi të regjistruar në emër të z. E. Sh. automjetin me targa ***. E pyetur mbi faktin përse automjeti deri në datën 28.1.2017 rezultoi ende në pronësi të z. E. Sh., subjekti ka deklaruar se nuk ka informacion për këtë fakt, por sipas saj, personi që ka blerë automjetin nuk ka bërë ndryshimet në institucionin përkatës. Edhe në parashtrime, pas kërkesës për të

⁹⁹Shihni aneksin nr. 4/15, nr. 4/16, nr. 30 dhe nr. 42 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.11.2021, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁰Shihni aneksin nr. 4/15, nr. 4/16, nr. 30 dhe nr. 42 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.11.2021, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

dhënë sqarime të mëtejshme, subjekti është shprehur vetëm mbi faktin se ish-bashkëjetuesi i saj ka pasur mundësi për blerjen e automjetit në vitin 2011 dhe zhdoganimin e tij.

- Vlera e blerjes prej 300.000 lekësh, plus pagesa e tarifës doganore prej 64.212 lekësh, ishin përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

- Në përfundim të procesit të rivlerësimit, meqenëse bashkëshorti i subjektit nuk ka provuar burimin e ligjshëm të blerjes së këtij automjeti në vitin 2011, shuma prej 40.000 lekësh e përfituar nga shitja e tij nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të subjektit për vitin 2016.

57. Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së¹⁰¹ konstatohet një kontratë shitjeje automjeti me nr.***, datë 27.4.2005, sipas të cilës z. E. Sh. ka blerë nga shtetasit F. Gj. automjetin me targa ***, vit prodhimi 1998, në shumën 250.000 lekë.

57.1. Duke qenë se as në DPV-në e vitit 2014 dhe as në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar ky automjet nga ana e z. E. Sh., nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:

- Automjeti me targa *** figuron në pronësi të z. E. Sh.¹⁰².

- Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 23.3.2016, e pyetur në lidhje me mosdeklarimin e automjetit objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar se në vitin 2008 ky automjet i është dhuruar shtetasit L. B. (vjehtëri i motrës së z. E. Sh.), por nuk e disponojnë kontratën e dhurimit. Ajo ka paraqitur pranë ILDKPKI-së deklaratën për heqje dore nga pronësia me nr. ***, datë 19.2.2016.

- Sipas kësaj deklaratë, z. E. Sh. deklaron se i ka dhuruar shtetasit L. B. automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në vitin 2008, ndërsa shtetasi L. B. deklaron se e ka zotëruar automjetin që nga nënshkrimi i kontratës së dhurimit.

- Subjektit iu kërkua të paraqesë kontratën e dhurimit të këtij automjeti dhe të japë informacion përse ky mjet është ende në pronësi të bashkëjetuesit dhe si e ka përdorur automjetin shtetasi L. B. që nga momenti i dhurimit në vitin 2008. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka informacion mbi këtë fakt, përveç asaj që ka deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitin 2016.

- Nga të dhënat e sistemit *TIMS* ka rezultuar se z. E. Sh. e ka përdorur këtë automjet deri në maj të vitit 2008.

- Nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të z. E. Sh. për blerjen e automjetit në vitin 2005.

57.2. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime, ku duket se: (i) ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2005; (ii) nuk provohet dhurimi i automjetit në vitin 2008 shtetasit L. B.; (iii) ky automjet nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2014 dhe në deklaratën *Vetting*. Në parashtrimet e datës 8.7.2022, subjekti ka deklaruar se ish-bashkëshorti i saj nuk figuron përdorues i këtij automjeti dhe gjatë gjithë bashkëjetesës nuk e ka përdorur këtë automjet të blerë shumë kohë përpara se ajo të njihej me të, dhuruar përpara se të fillonte bashkëjetesën.

57.3. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se mungesa e të ardhurave të z.E. Sh. për të blerë automjetin në vitin 2005, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Sa i takon mungesës së deklarimeve në DPV-në e vitit 2014 dhe atë *Vetting* të këtij automjeti, pavarësisht mungesës së një kontrate dhurimi të automjetit në vitin 2008, Komisioni nuk mund

¹⁰¹Shihni aneksin nr. 4/18 dhe nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

të anashkalojë ekzistencën e deklaratës noteriale të datës 19.2.2016, e cila është një provë shkresore që vërteton dhurimin e automjetit në vitin 2008 të shtetasi L. B., i cili nuk e ka regjistruar në emër të tij, dhe për këtë shkak automjeti figuron në emër të z. E. Sh.. Për më tepër, as në sistemin e AMF-së dhe as në sistemin *TIMS* nuk ka të dhëna që z. E. Sh. të ketë përdorur automjetin pas vitit 2008. Referuar këtyre fakteve, mosdeklarimi i automjetit të blerë disa vite përpara bashkëjetesës me subjektin në vlerën 250.000 lekë nga ana e z. E. Sh., vlerësohet se nuk është me qëllim fshehjen e automjetit, por për shkak se i ishte dhuruar në mënyrë verbale shtetasi L. B. Në këtë vlerësim, në respektim të parimit të objektivitetit, Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se z. E. Sh., jo në pak raste ka kryer deklarime për fakte e veprime juridike të pavërtetuara me asnjë dokument shkresor.

58. Nga lëvizjet e llogarive bankare individuale të z. E. Sh., në ISP Bank janë evidentuar disa veprime depozitimi, konkretisht:

- Për vitin 2010 janë depozituar në total shumat 2.900.000 lekë dhe 10.000 euro, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të këtij viti si likuiditete, që ka rezultuar me balancë negative¹⁰³.

- Për vitin 2011 janë kryer dy depozitime në *cash* në total në shumën 2.000.000 lekë dhe nga gjendja e depozitave të krijuara gjatë viteve 2010 dhe 2011, shuma 3.922.406 lekë është transferuar nga llogaria individuale e z. E. Sh. në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 23.9.2011 dhe për ketë arsye është konsideruar si shpenzim për vitin 2011.

- Për vitin 2012, nga gjendja e krijuar llogarisë prej 25.000 euro në fund të vitit 2011, shuma 23.000 euro është transferuar nga llogaria individuale e z. E. Sh. në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimet “*pagesa mjetesh dhe pagesa të ndryshme*”. Shuma 23.000 euro është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të subjektit për vitin 2012, vit i cili ka rezultuar me balancë pozitive.

58.1. Nga analiza e vitit 2011, përmbledhur në tabelën si më poshtë vijon, i cili në përfundim të hetimit administrativ ishte konsideruar si vit bashkëjetese midis subjektit dhe z. E. Sh., ka rezultuar se ata nuk kanë pasur mundësi të krijojnë depozitimet në shumën 2.000.000 lekë.

Përshkrimi	2011
PASURI	291 508
Automjet “Chrysler GY Voyager” e zezë, me targa ***, datë 21.3.2011	364 212
<i>Ndryshimet e likuditeteve</i>	-72 704
Gjendja e likuditeteve	5 110 117
TË ARDHURA dokumentuar	2 765 273
Të ardhura të subjektit nga paga	808 355
Të ardhura të bashkëjetuesit	975 400
Të ardhura nga vendimi i gjykatës	981 518
SHPENZIME	5 323 957
Shpenzime jetese	273 240
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	188 253
Shpenzime transporti të brendshëm	140 057
Dhënë <i>cash</i> babait para bashkëjetesës	800 000
Kaluar shuma parash tek shoqëria “****” sh.p.k.	3 922 407
Mundësia për kursime	-2 850 192

¹⁰³Shihni tabelën në paragrafin nr. 20.4. të këtij vendimi.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

58.2. Në parashtrimet e veta, subjekti ka pretenduar se burimi i shumave të llogarive personale të z. E. Sh. vjen nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe, për këtë arsye, ato nuk mund të trajtohen si shpenzim personal i tij, pretendim i cili nuk është i bazuar financiarisht. Pavarësisht kësaj, vitet 2010 dhe 2011, kur janë kryer depozitimet e mësipërme në llogarinë e z. E. Sh., në përfundim të procesit, u konsideruan jashtë periudhës së bashkëjetesës, sikurse subjekti pretendoi dhe, për rrjedhojë, balancat negative të këtyre viteve nuk e afektojnë analizën financiare të rishikuar të subjektit për këto vite, vite në të cilat kjo e fundit është analizuar me familjen e origjinës.

Analizë financiare

59. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në provat e administruara, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka analizuar:

59.1. Pasuritë e bashkëjetuesit E. Sh., të krijuara nga viti 1995 deri në fund të vitit 2008¹⁰⁴, në vlerën totale 335.682.914 lekë, përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Shuma (lekë)	Burimi i deklaruar i të ardhurave
1	Shtëpi banimi në Tiranë, sip. ndërtimi 170 m ² dhe 60 m ² oborr. Përfituar në vitin 1997	-	Dhuruar nga prindërit
2	Tokë 10.000 m ² në ***, v. 1996	6 895 095	Nga shitja e anijeve në vitin 1996
3	Tokë me sip. 2.000 m ² , ***, Tiranë, gusht 2010 (30.000 euro) <i>Shitur në datën 18.1.2017 për 15.000 euro</i>	4 164 300	Nga shitja e fabrikës në vitin 2006
4	Kombinat përpunim druri 1994 - 1996 ***/transferuar *** 1995. <i>Shitur në vitin 2006 për 150.000 euro</i>	-	-Nga emigracioni 1994 - 1996 -Nga shitja e anijeve në vitin 1996
5	Blerë anije ***, datë 23.4.1995 <i>Shitur 1996</i>	75 320 629	-5% cash të ardhura nga emigracioni Austri-Gjermani -95% me bono privatizimi
6	Blere Anije *** 23.04.1995 <i>Shitur në vitin 1996</i>	82 718 673	-5% cash të ardhura nga emigracioni Austri-Gjermani -95% me bono privatizimi
7	Truall sip. 529m ² Tiranë, në bashkëpronësi	-	Trashëguar
8	Truall me sip. 291m ² , Tiranë, në bashkëpronësi	-	Trashëguar
9	Truall në bashkëpronësi 349.3 m ² TR	-	Shpronësuar
10	Truall në bashkëpronësi 1.859 m ² TR	-	Shpronësuar
11	Truall në bashkëpronësi 301m ² TR	-	Shpronësuar
12	Truall në bashkëpronësi 813 m ² TR	-	Trashëguar
13	Truall në bashkëpronësi 187 m ² TR	-	Trashëguar
14	Shoqëria “****” sh.p.k. (Kapitali)	100 000	Nuk dihet burimi

¹⁰⁴Duke qenë se në përfundim të hetimit administrativ, bashkëjetesa u konsiderua e filluar në vitin 2009.

15	Shoqëria “****”, datë 12.4.2006 aksione 51%	170 398 517	-Nga shitja e anijeve në vitin 1996 -Nga shitja e fabrikës në vitin 2006 -Investimi i kryer në kohë të ndryshme, përfshirë investimi në natyrë
16	“Mercedes-Benz” model i vitit 1998, me targa ***, blerë në vitin 2005	250 000	Nuk është deklaruar asnjëherë
Total pasuri		335 682 914	

Bazuar në të dhënat e administruara, nuk u vërtetuan burime të ligjshme të të ardhurave të z.Sh. për të krijuar pasuritë përpara fillimit të bashkëjetesës, pasi nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të burimeve të deklaruara prej tij, konkretisht nga: (i) emigracioni në Austri dhe Gjermani; (ii) bono privatizimi; (iii) shitja e anijeve në vitin 1996; (iv) shitja e fabrikës në vitin 2006; (v) të ardhura nga investime të kryera në kohë të ndryshme, përfshirë investimin në natyrë; (vi) të ardhura nga angazhime dhe veprimtari private të shoqërisë “****” sh.p.k. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto konstatime.

59.2. Analiza financiare për pasuritë e subjektit për periudhën e rivlerësimit: (i) nga viti 2003 kur ka filluar detyrën deri në fund të vitit 2008 kur ka qenë pjesë e familjes prindërore; dhe (ii) për vitet 2009 - 2016, periudhë e cila është konsideruar në bashkëjetesë me z. E. Sh., është përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Sipas kësaj analize, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi të justifikojë me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet për shkak të një balance negative prej 12.468.433 lekësh. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	PASURI	DETYRIM E	PASURI NETO (1-2)	TË ARDHURA	SHPENZI ME	Mundësia për kursime 4-3-5
<i>Deri në fund 2003</i>	0	0	0	374 201	133 186	241 015
2004	428 000	0	428 000	1 266 492	437 045	401 447
2005	264 019	0	264 019	1 450 870	499 282	687 569
2006	398 796	0	398 796	1 527 734	595 038	533 900
2007	-528 323	0	-528 323	1 820 803	890 897	1 458 228
2008	666 480	962 521	-296 042	1 771 262	1 141 757	925 547
2009	313 335	-85 735	399 071	1 848 266	705 078	744 117
2010	10 082	-876 786	10 958 889	1 942 116	601 467	-9 618 241
2011	291 508	0	291 508	2 765 273	5 323 957	-2 850 192
2012	-4 935	0	-4 935 414	1 411 478	4 654 097	1 692 794
2013	30 297	0	30 297	1 702 581	1 028 760	643 524
2014	100 010	0	100 010	1 423 419	764 588	558 821
2015	854 993	1 536 803	-681 810	1 068 960	1 463 969	286 801
2016	-993 490	-173 773	-819 717	1 397 640	1 388 662	828 695

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme të ish-bashkëshortit për të justifikuar pasuritë përpara fillimit të bashkëjetesës

60. Në analizë të parashtrimeve të subjektit rezultoi se:

60.1. Përveç faktit që ka pretenduar se si vit i fillimit të bashkëjetesës duhet të konsiderohet viti 2012 dhe jo viti 2009, subjekti ka dhënë sqarime bazuar në informacionin që dispononte në lidhje me çdo pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga ish-bashkëshorti i saj, duke pretenduar konsiderimin e tyre si të ligjshme, por nuk arriti të vërtetojë me dokumente shkresore të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, me përjashtim të të ardhurave nga shitja e fabrikës në vitin 2006.

60.2. Subjekti ka sjellë edhe një herë në vëmendje rrethanat e marrëdhënies së saj me ish-bashkëshortin, z. E. Sh., dhe komunikimin e vështirë mes tyre, çka sipas saj ka sjellë si pasojë vështirësi dhe pamundësi për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit. Ajo ka informuar Komisionin se pas lindjes së vajzës së tyre të vogël në maj të vitit 2015, mes tyre kishin lindur kontradikta të mëdha, për shkak të konsumimit në mënyrë të vazhdueshme të alkoolit prej tij. Kjo sipas saj kishte ardhur prej problemeve dhe dështimeve të tij në biznes në këtë periudhë. Më tej ajo ka informuar se për shkak të këtyre problemeve ai nuk sillte as të ardhura në shtëpi dhe për këtë arsye ishte detyruar të merrte edhe *overdraft* nga “Credins Bank”. Për të mbështetur faktin që z. Sh. ka qenë dhe është konsumues alkooli dhe ka pasur sjellje të paqëndrueshme, midis të tjerash, subjekti i referohet:

- dosjes gjyqësore mbi bazën e së cilës është dhënë vendimi nr. ***, datë 22.2.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me dëmin e shkaktuar shoqërisë “*****” sh.a. nga një aksident i ndodhur në shkurt të vitit 2016, me pasoja dëme materiale të kryer nga z. Sh. nën ndikimin e alkoolit;

- deklarimeve të kunatit të tij I. B. dhe mësueses së pianos së vajzës, shtetases M. T. (V.), të cilët deklarojnë se ishin në dijeni të problematikave familjare për shkak të përdorimit të alkoolit nga z. Sh.;

- ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës me z. Sh. në datën 14.1.2020, në të cilën subjekti është shprehur në lidhje me shkaqet që kanë cenuar bashkëjetesën në martesë;

- raportit të vlerësimit psiko-ligjor, të hartuar nga psikologia klinike V. T., pa u kryer intervista me z. Sh., pasi ai nuk i është përgjigjur kërkesave për takim. Në këtë raport psikologia është shprehur se z. E. Sh. fillimisht i përgjigjet në telefon se do të paraqitet dhe më pas nuk i përgjigjet telefonatave e mesazheve të dërguara derisa raporti është hartuar pa praninë e tij.

Për të mbështetur pretendimet e saj subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore¹⁰⁵.

60.3. Veç sa më sipër, subjekti kërkon nga Komisioni që në vlerësimin përfundimtar të mbajë në konsideratë rrethanat e përmbledhura, si vijojnë:

¹⁰⁵Shihni dosjen e plotë nga përmbartuesi privat G. G., në të cilën ndodhen urdhra, lajmërimi dhe vendosje të sekuestros konservative mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të z. E. Sh.; akte nga dosja gjyqësore e vendimit nr. ***, datë 4.11.2020, mbi zgjidhjen e martesës mes Elsa Sh. dhe E. Sh.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.7.2022, e shtetasit I. B. (kunati) në të cilën ai deklaroi fillimin e bashkëjetesës së subjektit me shtetasin E. Sh. në vitin 2011 dhe divorcin e tyre si pasojë e përdorimit të alkoolit nga z. E. Sh.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.7.2022, e shtetases M. V., e cila deklaroi se ka dëshmuar edhe vetë situata familjare problematike; kërkesëpadi e datës 29.5.2017, me palë paditëse “*****” dhe palë e paditur E. Sh., ku referohet fakti i një aksidenti të ndodhur në vitin 2016 për shkak se shtetasi E. Sh. drejtonte mjetin nën ndikimin e alkoolit + akte nga dosja gjyqësore, ku çështja është mbyllur me pajtim në vitin 2018; dokument i OSHEE-së me datë 12.12.2017, “Pyetjet e palës paditëse OSHEE sh.a. për ekspertin kontabël” përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, palë e paditur shoqëria “*****” sh.p.k., përmes të cilës kërkohet të llogaritet vlera e detyrimit të papaguar nga ana e palës së paditur, shoqëria “*****” sh.p.k., vlera e kamatëvonesave dhe vlera e penaliteteve.

- Po analizohet për deklaratime e pasuri të shtetasit E. Sh. të përfituara në kohën e fejesës, pasuri në të cilat nuk ka ndikuar dhe as është përfituese.
- Po analizohet për deklaratime dhe për pasuri të ish-bashkëshortit të përfituara me trashëgimi, për të cilat nuk është përfituese ligjore në asnjë moment.
- Në këtë histori ka hyrë vetëm dhe ka dalë tre persona, që jetojnë me qira dhe me një kredi mbi supe.
- Nuk ka asnjë përfitim financiar nga pasuritë e shtetasit E. Sh., përkundrazi, nuk përfiton as detyrimin ushqimor për fëmijët, i cili është fare minimal.
- Veç sa më sipër, subjekti vijon t'i referohet marrëdhënies së ndërlikuar dhe të paqëndrueshme me z. Sh. dhe se po vijojnë procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të gjykatës për sa i takon detyrimin ushqimor të tij për vajzat e tyre të mitura, pikërisht për shkak të mospërmbushjes nga ana e tij të këtij detyrimi¹⁰⁶.

60.4. Po kështu, subjekti kërkon nga Komisioni që në vendimmarrjen e tij t'i referohet edhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit mbi problematikat që lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesë, si vendimet nr. 15/2021, nr. 17/2022, si dhe shkurtimeve të vendimeve nr. 19/2022 dhe 20/2022.

Vlerësimi i Komisionit

61. Në lidhje me pasuritë e ish-bashkëshortit të krijuara përpara bashkëjetesës, në vlerësimin përfundimtar Komisioni iu referua Kodit të Familjes dhe jurisprudencës së Kolegjit, si më poshtë vijon:

- Në nenin 77 të Kodit të Familjes përcaktohen pasuritë të cilat konsiderohen si “pasuri vetjake”. Konkretisht, kjo dispozitë ligjore sanksionon se: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë; c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake; ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare; d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë; dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura; e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes”*.

- Në vendimin nr. 15/2021, Kolegji arsyeton se: *“Problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit”*.

- Po kështu, të njëjtin qëndrim Kolegji ka mbajtur edhe në vendimet e shkurtuara nr. 19, datë 10.6.2022 dhe nr. 20 datë 14.6.2022.

62. Në lexim dhe interpretim të nenit 77 të Kodit të Familjes, pasuritë e ish-bashkëjetuesit/ish-bashkëshortit Sh., të cilat janë krijuar përpara periudhës së bashkëjetesës me subjektin, të përfituara prej tij me trashëgimi apo me të ardhurat e tij nga biznesi etj., për të cilat nuk u evidentua asnjë lidhje apo shprehje vullneti nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerësohen të

¹⁰⁶Sipas shkresës së përmbartuesit nr. *** regj. nr. *** prot., datë 30.5.2022, “Për vendosjen e sekuestros konservative mbi pjesën takuese të shtetasit E. Sh. të pasurisë “apartament”, z. k. ***, nr. pasurie ***, rruga “****”, Tiranë.

jenë pasuri vetjake të z. E. Sh.. Për rrjedhojë, problematikat e evidentuara në to, si mungesa e dokumentacionit që vërteton blerjen apo shitjen, dhënien apo marrjen hua në disa raste, pamundësia për të vërtetuar të ardhura të ligjshme financiare të z. E. Sh. për t'i krijuar këto pasuri apo pasaktësitë në deklarime, parë nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit referuar më sipër, nuk konsiderohen si shkaqe objektive e proporcionale për të ngarkuar me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, nuk u vërtetua në asnjë rast blerja e pasurive apo investime të çdo lloji të kryera nga subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj gjatë periudhës së bashkëjetesës, si dhe nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit me pasuri të përfituara nga z. Sh. përpara bashkëjetesës, një pjesë e konsiderueshme e të cilave me trashëgimi ligjore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit dhe balancën negative prej 12.468.433 lekësh

63. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, rezultoi se:

63.1. Subjekti ka kundërshtuar këtë balancë negative, e cila sipas saj vjen për shkak të konsiderimit nga ana e Komisionit të fillimit të bashkëjetesës me z. Sh. që në vitin 2009 dhe jo në vitin 2012, ashtu sikurse ka deklaruar në DPV, si dhe gjatë hetimit administrativ. Subjekti ka ritheksuar faktin se bashkëjetesa e saj me z. Sh. ka nisur në nëntor të vitit 2011, kur është shpërngulur fizikisht nga shtëpia prindërore dhe është konsoliduar në janar të vitit 2012 kur ka bërë edhe ndryshimin e adresës në gjendjen civile. Sipas saj, fakti i udhëtimit me z. E. Sh. në Maqedoninë e Veriut në vitin 2008 dhe transaksioni i kryer prej saj në llogarinë e z. E. Sh. në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 300 euro në vitin 2008, tregojnë njohjen dhe shoqërinë me këtë shtetas, por jo që ata bashkëjetonin. Sa i takon deklarinë të adresës së të fejuarit si adresë dytësore në DPV-të e viteve 2009 - 2011, apo edhe deklarimi në përdorim i automjetit me targa *** në pyetësin standard, kanë qenë për t'u treguar sa më e sinqertë dhe e saktë me organet e kontrollit të pasurisë, për shkak se qëndronte herë pas here tek i fejuari. Po kështu, sipas saj, as dhënia e shumës 800.000 lekë për mbylljen e kredisë (e cila u vërtetua që t'i jetë kthyer z.Sh. në vitin 2012 me të ardhura nga pagat) nuk tregon se ata kanë qenë në bashkëjetesë, pasi hua mund t'i marrësh një shoku, të dashuri, miku apo të fejuari.

63.2. Me qëllim vërtetimit të faktit se bashkëjetesa e saj me z. Sh. ka nisur në nëntor të vitit 2011 dhe është konsoliduar në janar të vitit 2011, subjekti ka parashtruar disa fakte e rrethana, sipas të cilave:

- i) fejesa me z. Sh. ka ndodhur në periudhën maj-qershor 2009, periudhë kur u bë edhe prezantimi i familjeve përkatëse;
- ii) që prej muajit gusht 2010, duke qenë se shoqëria “***” sh.p.k. kishte fituar ankandin e zhvilluar nga flota detare për shitjen e nëndetësëve, i fejuari E. Sh. ka qëndruar në ***, Vlorë, në banesën e marrë me qira nga shtetasi N. A., me qëllim zbatimin e kontratës, e cila ka vijuar deri në fund të shtatorit 2011;
- iii) në periudhën e fejesës ajo shkonte e vinte nga fshati ***, *** në Tiranë dhe anasjelltas me autobusa të linjës, ndërsa me ditë të caktuara ose fundjavave qëndronte në Tiranë në banesën e të fejuarit, ndërkohë që ai ishte në ***, Vlorë;
- iv) pas konfirmimit të shtatzënisë në gusht 2011, e cila ishte me probleme, e për këtë arsye nuk u zhvillua ceremonia martesore, nisi shkëputjen nga mjeku i familjes për t'u transferuar në Tiranë, ku dhe nisi bashkëjetesën faktike në 13 nëntor 2011;
- v) me konsolidimin e bashkëjetesës në janar 2012 ka kryer edhe regjistrimin në Gjendjen Civile Nr. ***, Tiranë;
- vi) në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar pagesën e bërë nga i fejuari (pra jo bashkëjetuesi) për mbylljen e kredisë tek “Raiffeisen Bank”;

vii) qendra e saj e votimit për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009 dhe ato vendore të vitit 2011 ka qenë qendra e votimit me nr. ***, e cila i përket fshatit ***, Bashkia ***, pra vendbanimit të familjes prindërore.

63.3. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur si prova një numër të konsiderueshëm dokumentesh shkresore, si vijojnë:

- foto të vjetra nga fejesa e subjektit me z. Sh. dhe martesa e vëllait apo dy motrave;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.6.2022, nga Qendra Shëndetësore Sukth, sipas të cilës pas verifikimeve të kryera në regjistrin themeltar të mjekut të përgjithshëm të familjes së Ambulancës Sukth, rezulton se Elsa Kareçi, e datëlindjes 22.5.1978, me nr. *** të regjistrimit themeltar, është larguar nga Ambulanca Sukth, në datën 12.9.2011;
- kopje e faqes së regjistrimit themeltar i mjekut të përgjithshëm dhe familjes, në të cilën evidentohet se Elsa Kareçi është transferuar në rrugën “****”, Tiranë, dr. B. E., në datën 12.09 (viti nuk dallohet);
- vërtetim me datë 28.6.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr. ***, Tiranë, sipas të cilit vërtetohet që znj. Elsa Kareçi, e datëlindjes 22.5.1978, është regjistruar pranë kësaj qendre shëndetësore në datën 12.9.2011, me mjek familje B. E., ardhur nga Qendra Shëndetësore Sukth;
- shënim më shkrim dore nga mjekja N. M., që mban datën 12.9.2011, me përmbajtje “Z. B., Elsa Kareçi ka kodin *** dhe është bërë transferimi i kodit”;
- kartelë personale nr. ***, nr. kodi ***, në emër të znj. Elsa Kareçi, mjeku i familjes B. E., ku si datë e krijimit të kartelës evidentohet data 12.9.2011;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.6.2022, e shtetases M. C., në të cilën kjo shtetase, duke konfirmuar shoqërinë 23-vjeçare me subjektin Elsa Kareçi, deklaron se nga dijenia e saj që buron prej miqësisë së tyre, bashkëjetesa e subjektit Elsa Kareçi me shtetasin E. Sh. ka nisur për shkak të shtatzënisë së saj me vajzën e parë, e datëlindjes 9.3.2012, dhe problemeve të kësaj shtatzënie, rreth muajit nëntor të vitit 2011;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.6.2022, e shtetasit N. N., në të cilën deklaron se ka pasur një linjë pasagjerësh H*** - S** dhe anasjelltas, dhe ka pasur si pasagjere të rregullt shtetasen Elsa Kareçi nga viti 2008 deri në fund të vitit 2011;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.7.2022, e shtetasit I. B. (kunati i ish-bashkëshortit), në të cilën ky shtetas deklaron se bashkëjetesa e subjektit Elsa Kareçi me shtetasin E. Sh. ka filluar rreth vitit 2011, ku znj. Elsa Kareçi ka pasur probleme serioze me shtatzëninë;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.6.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas të cilës në zgjedhjet e përgjithshme të qershorit të vitit 2009 dhe zgjedhjet vendore të majit të vitit 2011, znj. Elsa Kareçi ka votuar në qendrën e votimit nr. ***.
- ekstrakt i regjistrimit tregtar të subjektit “****” sh.p.k., me NUIS ***, regjistruar në vitin 2004, me zyra qendrore Sukth, Durrës, me administrator N. N., subjekt i cili kryente aktivitet transporti dhe ka lëshuar deklaratë noteriale për të mbështetur pretendimin se deri në fund të vitit 2011 subjekti udhëtonte çdo ditë nga Sukthi për në Tiranë;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.7.2022, nga Komisariati i Policisë Nr.*** Tiranë, sipas të cilës konfirmohet se pas verifikimeve të kryera në Njësitë Administrative Nr. *** dhe Nr. *** Tiranë, rezulton se kjo shtetase për periudhën 1.6.2009 – 26.1.2012 juridikisht ka banuar në ***, Durrës dhe nga fillimi i vitit 2012 ka banuar në adresën: rruga “****”, Nr. ***, Q. S.;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** regj., datë 6.7.2022, nga Komanda e Forcës Detare Durrës, sipas të cilës konfirmohet kontrata me nr. ***, datë 6.8.2010, lidhur midis autoritetit shitës, Komanda e Forcës Detare, dhe shoqërive “****” sh.p.k. dhe “*****” sh.p.k., me objekt “shitje e tre nëndetëseve për skrap”, të shpallur fitues me ofertën e paraqitur në datën 31.5.2010 në ankand publik. Sipas kësaj shkrese, fillimi i punës për realizimin e kontratës ka qenë data

18.10.2010 dhe gjatë periudhës tetor 2010 – shtator 2011 janë përfituar skrap çelik dhe skrap bronzi. Kjo kontratë ka përfunduar në datën 23.9.2011 me shitjen e tre nëndetëseve;

- kontratë shitjeje publike nr. ***, datë 6.8.2010, e lidhur mes Komandës së Forcës Detare dhe shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. + aneks nr. 1 + specifikime teknike;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.7.2022, e shtetasit N. A., në të cilën deklaroi se në shtator të vitit 2010, në ambientin e punës së tij në ***, Baza Detare Vlorë, është njohur me shtetasin E. Sh., përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k., për realizimin e kontratës me objekt “nxjerrjen dhe copëtimin e tre nëndetëseve” dhe se ky shtetas së bashku me disa punonjës të tjerë të shoqërisë “****” sh.p.k., nga shtatori i vitit 2010 e deri në shtator të vitit 2011 kanë banuar me qira në shtëpinë e tij në ***, Vlorë, lagjja “****”, rruga “****”;
- leje legalizimi e vitit 2018, me objekt “legalizimin e godinës banimi dy kate” dhënë shtetasit N. M. A., në ***, Bashkia Vlorë;
- kontratë qiraje e datës 26.11.2009, e lidhur mes qiradhënësit, shoqëria “****” sh.p.k., dhe qiramarrësit, shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “dhënie me qira të shesheve të depozitimit të skrapeve”, përkatësisht në Durrës, Kamëz, Kurbin, për një periudhë kohore e cila tregon se shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur aktivitet edhe jashtë Tiranës dhe se z. Sh. ka qenë i angazhuar në këtë aktivitet.

63.4. Bazuar në të gjitha faktet e parashtruara më sipër, subjekti ka pretenduar se konsiderimi i fillimit të bashkëjetesës në vitin 2009 nga ana e Komisionit është i padrejtë, duke kërkuar që analiza financiare deri në fund të vitit 2011 duhet të kryhet e ndarë nga ajo e bashkëjetuesit dhe se si periudhë e fillimit të bashkëjetesës duhet të konsiderohet viti 2012, sikurse ajo ka deklaruar. Përveç sa më sipër, në parashtrimet e veta, referuar analizës financiare të paraqitur për secilin prej konstatimeve të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se ka provuar në mënyrë bindëse krijimin e pasurive me burime të ligjshme gjatë periudhës së rivlerësimit dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka arritur nivel të besueshëm të kriterit të pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit

64. Në lidhje me periudhën e nisjes së bashkëjetesës, në vlerësimin përfundimtar, Komisioni iu referua legjislacionit në fuqi mbi bashkëjetesën, si dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

64.1. Neni 163 i Kodit të Familjes, parashikon se: *“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas, që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”*. Për analogji, në ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në nenin 3 parashikohet se: *“Anëtar i afërt i familjes nënkupton bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga gjaku apo martesë, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim”*.

64.2. Në analizë të të gjitha provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ushtrim të barrës së provës, Komisioni vlerësoi se subjekti nëpërmjet shpjegimeve që ka dhënë dhe dokumenteve shkresore të paraqitura, ka arritur të heqë dyshimet në lidhje me fillimin e bashkëjetesës në vitin 2009, pasi:

i) Ka vërtetuar bindshëm se pavarësisht elementeve që i krijojnë këto dyshime, bashkëjetesa me z. Sh., në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes, ka filluar *de facto* në fund të vitit 2011 dhe *de jure* në janar të vitit 2012, kur është bërë edhe ndryshimi i gjendjes civile prej subjektit. Gjithashtu, subjekti ka vërtetuar se z. Sh. ka qenë i angazhuar dhe ka banuar jashtë Tiranës deri në fund të vitit 2011, që tregon pamundësinë objektive të bashkëjetesës fizike të tyre.

ii) Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit konstatohet se ajo ka qenë konsistente në deklaratimet e saj lidhur me periudhën e nisjes së bashkëjetesës, si dhe të gjitha deklaratimet e

saj janë në koherencë dhe në përputhje të plotë me deklaratimet gjatë hetimit administrativ dhe me të dhënat që përmbajnë provat dhe dokumentet shkresore të administruara gjatë gjithë procesit të rivlerësimit.

64.3. Në përfundim të procesit, në analizë të të gjitha sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë konceptin ligjor të bashkëjetesës, sipas të cilit: *“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”*, por edhe në konsideratë të faktit që bashkëjetesa është një ngjarje e cila vetëdeklarohet dhe nuk materializohet në ndonjë akt të posaçëm, faktet dhe rrethanat që vërtetohin marrëdhënien midis subjektit dhe z. Sh. përpara vitit 2012 nuk u çmuan si prova të mjaftueshme që vërtetojnë fillimin e bashkëjetesës nga viti 2009, sikurse ishte konsideruar në përfundim të hetimit administrativ. Këto rrethana të cilat nuk konkurrojnë me provat e dokumentet shkresore që subjekti paraqiti në ushtrim të barrës së provës, vlerësohen si elemente që tregojnë një marrëdhënie normale në fejesë të subjektit me z. Sh., e cila është deklaruar që në DPV-në për vitin 2009 nga subjekti, e cila ka përfunduar në fund të vitit 2011, kur është vërtetuar dhe dokumentuar shkëputja e saj nga familja prindërore për të banuar së bashku me z. Sh. në Tiranë në banesën me adresë: rruga “***”. Për rrjedhojë, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë fillimin e bashkëjetesës me z. Sh. në vitin 2012 dhe si periudhë e nisjes së bashkëjetesës u konsiderua janari i këtij viti.

65. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi të konsiderojë si periudhë të fillimit të bashkëjetesës muajin janar të vitit 2012, çka afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën financiare të subjektit për periudhën e rivlerësimit. Kështu, analiza financiare e rishikuar ka ndryshuar për shkak të mospërfshirjes së pasurive/likuiditeteve të z. Sh. të krijuara gjatë viteve 2010 - 2011, pasi këto vite i përkasin periudhës jashtë bashkëjetesës. Për rrjedhojë, në analizën e rishikuar në përfundim të procesit, balanca negative bëhet nga -12.468.433 lekë në -1.372.900 lekë¹⁰⁷. Kjo shumë përfaqëson gjendjen *cash* prej 10.000 euro të deklaruar nga ish-bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting*, krijuar në datën 18.1.2017¹⁰⁸, pra disa ditë para plotësimit dhe dorëzimit të kësaj deklarate. Pavarësisht se subjekti ka dështuar të dokumentojë burimin e krijimit të këtij likuiditeti, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka çmuar se kjo nuk mund të përbëjë shkak për penalizim, jo vetëm në konsideratë të standardit të mbajtur në lidhje me balancat negative që bëhen shkak për penalizim të subjekteve, por edhe në kushtet kur është evidentuar se subjekti nuk ka pasur asnjë lidhje me pasurinë tokë në ***, përfituar përpara bashkëjetesës nga z. Sh., shitja e së cilës është deklaruar si burim për krijimin e këtij likuiditeti. Akoma më tej, mosdeklarimi i këtij likuiditeti nga ana e subjektit në deklaratën *Vetting*, sikurse ligji e kërkon, ndërkohë që ajo ka qenë shumë e saktë në deklaratimet e veta ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*, hedhin dritë mbi faktin se z. Sh. dhe subjekti kanë plotësuar deklaratën *Vetting* në mosrakordim të plotë njëri tjetrit, pikërisht për shkak të marrëdhënieve të tyre jo normale të bashkëjetesës. Këto fakte krijojnë bindjen se likuiditeti prej 10.000 euro i përkiste tërësisht z. Sh. dhe nuk është krijuar me të ardhura të paligjshme të subjektit për shkak të ushtrimit të detyrës, dhe jo vetëm.

KONTROLLI I FIGURËS

66. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2006. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin

¹⁰⁷Kursi i këmbimit 1 euro = 137.29 lekë, datë 18.1.2017, Banka e Shqipërisë.

¹⁰⁸Data e përfitimit të shumës 15.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 18.1.2017, trajtuar në paragrafin nr.52 të këtij vendimi, e deklaruar si burim për krijimin e gjendjes *cash* prej 10.000 euro.

nr. *** prot., datë 26.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Elsa S. Kareçi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 15.2.2022, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Elsa S. Kareçi. Komisioni ka kërkuar përditësim informacioni për subjektin Elsa Kareçi dhe nga të dhënat konfidenciale të organeve ligjzbatuese nuk kanë rezultuar të dhëna të përditësuara për këtë subjekt. Për rrjedhojë, subjekti është vlerësuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

67. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Elsa Kareçi, bazuar në: (i) raportin nr. *** prot., datë 30.5.2022, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.5.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

68. Raporti për analizimin e aftësive profesionale i kryer nga Këshilli i Lartë Prokurorisë është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

69. Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, KLP-ja ka evidentuar: (i) saktësinë e formularit të vetëdeklarimit; (ii) përvojën profesionale; (iii) detyrat e kryera për periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016; (iv) trajnimet në 3 vitet e fundit, si dhe ka analizuar tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short, nga ku nuk janë evidentuar problematika.

70. Sipas të dhënave arkivore, është konstatuar se: (i) ndaj prokurores Elsa Kareçi nuk është dhënë asnjë masë disiplinore; (ii) subjekti është vlerësuar “shumë mirë” nga vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016; (iii) ka pasur një kallëzim penal për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe një ankesë e cila, pas shqyrtimit nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka rezultuar me problematika.

71. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi, si vijon:

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore: subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit, aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

Arsyetimi ligjor: subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi shfaq aftësi në arsyetim ligjor, organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar, bën analizë të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurorja ka trajtuar 533 çështje. Nga ana e prokurores Elsa Kareçi tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore: prokurorja Elsa Kareçi kryen veprime procedurale hetimore produktive. Respekton njoftimet e vendimmarrjeve. Qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e saj të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

Aftësia për të administruar dosjet: prokurorja ka aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë: gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurores.

Integriteti: për subjektin konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia: nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurores Elsa Kareçi, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit: komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar: në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Elsa Kareçi rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

Gatishmëria për t’u angazhuar: subjekti Elsa Kareçi ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

72. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar informacionet e marra nga:

72.1. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

72.2. Pesë denoncimet nga publiku, të administruara për subjektin e rivlerësimit, katër¹⁰⁹ prej të cilave nuk përmbushin kushtet e nenit 53 të ligjit nr.84/2016 mbi denoncimet nga publiku.

¹⁰⁹Shihni denoncimet: nga shtetasi E. K., protokolluar me nr. *** prot., datë 14.1.2022, nr. *** prot., datë 19.1.2022 dhe nr. *** prot., datë 10.5.2021, nr. *** prot., datë 26.1.2021, në dosjen e Komisionit; nga shtetasi F. H., protokolluar me nr. ***

Në këto denoncime nuk referoheshin shkeljet konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe më së shumti ngriheshin pretendime ndaj vendimmarrjes së subjektit ose pas analizimit të akteve përkatëse, pretendimet e denoncuesit nuk qëndronin.

73. Për një nga denoncimet e paraqitura nga shtetasit M. L. dhe N. L.¹¹⁰, Komisioni çmoi të kryejë verifikime të mëtejshme, si vijojnë:

73.1. Këta shtetas denoncojnë prokurorët S. S., Gj. K. dhe Elsa Kareçi, të cilët kanë vendosur pushimin e hetimeve në çështjen që i përket vdekjes së vajzës së tyre V. L. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi, pretendohet se ajo nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 28.1.2009, lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 3.6.2009, konkretisht: (i) nuk ka marrë në pyetje personat që kanë nxjerrë viktimën nga makina për ta dërguar në spitalin më të afërt; (ii) nuk ka marrë në pyetje të pandehurin A. N. etj.; (iii) nuk ka rindërtuar ngjarjen, ka anashkaluar qëllimisht aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, detyra të cilat të çojnë në zbardhjen e saj.

73.2. Me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e pretendimeve të denoncuesve, nga ana e Komisionit u administrua dosja e procedimit penal nr. ***, nga aktet e së cilës rezultoi se:

- Në datën 30.5.2006 është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2006, në ngarkim të shtetasit A. N., për veprën penale “shkeljes të rregullave të qarkullimit rrugor”, i cili është regjistruar në datën 30.5.2006 dhe i është ngarkuar për hetim prokurorit S. S. e më pas prokurorit Gj. K.

- Të dy prokurorët kanë vendosur pushimin e hetimeve, vendime të cilat janë prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimet nr. ***, datë 8.8.2008 dhe nr. ***, datë 28.1.2009, ka vendosur vazhdimin e hetimeve të mëtejshme nga ana e organit të Prokurorisë.

- Në vendimin nr. ***, datë 28.1.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit Gj. K. për pushimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve, duke lënë si detyrë:

i) të bëhet rindërtimi i vendit të ngjarjes sipas deklarimeve të drejtuesit të automjetit, veprim i cili do të ndihmojë në kryerjen e e një aktekspertimi të plotë;

ii) të merren në pyetje punonjësit e policisë së qarkullimit rrugor Tiranë, të cilët kanë vajtur të parët në vendngjarje dhe me deklaratimet e tyre mund të hedhin dritë mbi rrethanat e kësaj ngjarjeje;

iii) të merren në pyetje familjarët e viktimës dhe familjarët e drejtuesit të automjetit, të cilët me deklaratimet e tyre mund të japin të dhënat e sakta për drejtimin e lëvizjes së tyre, si dhe për marrëdhëniet që kanë pasur drejtuesi i automjetit A. N. dhe viktimë V. L.;

iv) të merren në pyetje personat që kanë shoqëruar viktimën për në spital;

v) pasi të kryhen këto veprime hetimore organi i Prokurorisë duhet të kryejë edhe një riekspertim auto-teknik me grup ekspertësh, duke thirrur specialistë të DPQRR-së pranë Ministrisë së Brendshme, si dhe specialistë pranë Ministrisë së Transporteve. Kjo është e nevojshme pasi aktet e mëparshme të ekspertimit auto-teknik kanë kontradikta thelbësore njëri me tjetrin. Akti i parë i ekspertimit drejtuesin e automjetit e ka nxjerrë me shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, ndërsa në dy aktet e tjera është nxjerrë fajtor një person i paidentifikuar dhe kjo vetëm sipas deklarimeve të drejtuesit të automjetit.

- Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 3.6.2009, dhe ka marrë formë të prerë në datën 19.6.2009.

prot., datë 23.1.2018, në dosjen e Komisionit; nga shtetasi A. Q., protokolluar me nr. *** prot., datë 16.3.2018, në dosjen e Komisionit; nga shtetasja S. A., protokolluar me nr. *** prot., datë 29.5.2019.

¹¹⁰Protokolluar me nr. *** prot., datë 22.6.2021, në dosjen e Komisionit.

- Hetimi i çështjes, pas vendimit të gjykatës, ka vijuar nga prokurori V. M., i cili në datën 2.7.2009 ka urdhëruar, duke i renditur, kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata, duke caktuar si afat për kryerjen e tyre datën 30.9.2009.

- Ky procedim i është ngarkuar për hetim prokurores Elsa Kareçi në datën 16.7.2009, e cila e ka dërguar procedimin në ngarkim të të pandehurit A. N. për gjykim, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në datën 24.9.2010.

- Prokurorja Elsa Kareçi ka vendosur 5 herë zgjatjen e afatit të hetimeve, me argumentin se nuk është administruar aktekspertimi auto-teknik.

- Në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata janë kryer veprimet hetimore, si vijojnë: është kërkuar nga DPPSH-ja lista e specialistëve të Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor; është vendosur kryerja e riekspertimit auto-teknik dhe caktimi i ekspertëve për kryerjen e riekspertimit auto-teknik; janë pyetur prindërit e viktimës M. L. dhe N. L.; janë pyetur punonjësit e policisë që kanë shkuar të parët në vendngjarje, shtetasit D. L. dhe A. M.; është pyetur i ati i të pandehurit N. N.; është pyetur pronari i agjencisë funerale që ka kryer transportin e viktimës nga SQU në morgun e IML, shtetasi N. K.; është pyetur personi pritës në morg, shtetasi A. L.; është pyetur punonjësi i policisë, shtetasi I. J.’; është këqyruar libri i shënimeve ditore të Sallës Operative në Komisaratin e Policisë Rrugore Tiranë; është këqyruar libri i shënimeve ditore të urgjencës së kirurgjisë së SQU ku evidentohen dy emra, pa mbiemra, “***”, “***”; është këqyruar libri i hyrje-daljeve të kufomave në morgun e IML Tiranë; është administruar aktekspertimi auto-teknik.

- Në fazën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, organi i Prokurorisë është përfaqësuar nga prokurori A. C.

73.3. E pyetur mbi pretendimet e denoncuesve, subjekti ka sqaruar se¹¹¹:

- Për sa i përket pyetjes së personave që kanë nxjerrë viktimën nga automjeti për ta dërguar në spital, deklaroi se nuk është bërë e mundur identifikimi i tyre me gjithë veprimet hetimore të kryera. Ajo ka sqaruar se ka një shënim në librin e shënimeve të urgjencës së kirurgjisë, i pasqyruar në këqyrjen, ku janë dy emra, pa mbiemra, “***”, “***”, por këta persona nuk janë identifikuar (sipas sqarimit më lart).

- Për sa i përket pyetjes së të pandehurit, ka deklaruar se ky veprim është bërë më parë nga prokurori që ka pasur fillimisht çështjen, ndërsa gjatë kohës që ajo ka pasur dosjen, i pandehuri ka qenë në mungesë, i përfaqësuar nga mbrojtësi. Sipas saj është në vullnetin e të pandehurit të paraqitet ose jo dhe ai nuk mund të detyrohet të jetë i pranishëm në proces.

- Për sa i përket pretendimit se nga ana e saj është anashkaluar qëllimisht aktekspertimi mjeko-ligjor, ky pretendim, sipas saj, nuk qëndron. Aktekspertimi mjeko-ligjor është kryer më parë, fillimisht në hetimin e parë dhe më pas në hetimin e dytë, ku është bërë edhe zhvarrimi i kufomës. Në aktekspertimin mjeko-ligjor ekspertët kanë konkluduar se dëmtimet e konstatuara në trupin e shtetases V. L. janë karakteristike për traumat të ndodhura brenda kabinës së automjetit të përfshirë në një aksident automobilistik dhe kjo gjë është përmendur prej saj dhe në kërkesën për gjykim.

- Përveç sa më sipër, subjekti ka informuar se denoncuesit kanë bërë ankesa në ILD në lidhje me këtë çështje për të gjithë magjistratët e përfshirë në këtë proces, e cila, me vendimet nr. *** prot., datë 24.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 11.1.2002, ka vendosur për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit.

¹¹¹Shihni përgjigjet e pyetësorit mbi denoncimet në dosjen e Komisionit.

73.4. Në përfundim të verifikimeve të kryera, nga analiza e akteve të dosjes dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti, u konstatua se pretendimi i denoncuesve për mospërbushje të detyrave të lëna nga gjykata qëndron pjesërisht, pasi nga ana e subjektit nuk është kryer veprimi hetimor i pyetjes së të pandehurit A. N. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

73.5. Në parashtrimet e saj të datës 8.7.2022, subjekti ka sqaruar se pyetja e të pandehurit A.N. është realizuar më parë në dosjen hetimore nga prokurorët që e kanë pasur çështjen në hetim para saj dhe se gjatë kohës që ajo e ka hetuar këtë çështje, i pandehuri ka qenë në mungesë dhe në të gjitha aktet ka nënshkruar mbrojtësi i tij.

73.6. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmon se pyetja e të pandehurit nga prokurorët e mëparshëm nuk është një argument i mjaftueshëm për ta përjashtuar ripyetjen e të pandehurit nën dritën e rrethanave dhe fakteve të reja të dala nga hetimi, e në këto kushte subjekti duhet të kishte marrë të gjitha masat për pyetjen e tij. Megjithatë, vlerësohet se kjo problematikë nuk përbën shkak për penalizim të subjektit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që edhe nga institucioni kompetent, ILD, pas shqyrtimit të ankesës, nuk janë evidentuar mangësi apo shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

74. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

74.1. Në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

74.2. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

IV. SEANCA DËGJIMORE

75. Në datën 12.7.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Elsa Kareçi, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elsa Kareçi dhe shpalli vendimin në seancën e datës 18.7.2022, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

76. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues i subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

77. Përpos konkluzioneve të rezultuara në përfundim të procesit të rivlerësimit për të tria kriteret si më sipër, gjatë procesit të vendimmarrjes, në respektim të plotë të parimit të objektivitetit dhe propocionalitetit, ashtu sikurse edhe Kolegji orienton Komisionin në disa prej vendimeve të tij, trupa gjyquese është bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave/rrethanave për të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, referuar edhe fakteve si vijojnë:

- Subjekti nuk ka blerë asnjë pasuri me të ardhurat e ish-bashkëjetuesit/bashkëshortit, si dhe nuk u evidentua asnjë pasuri në bashkëpronësi me të. Konkretisht, gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, objekt i deklarimeve të saj kanë qenë: (i) tri pasuri të përfituara përpara periudhës së bashkëjetesës me z. Sh., që janë: një tokë e përfitur sipas ligjit nr. 7501 nga familja e origjinës dhe dy automjete të blera në vitet 2008 dhe 2004, përkatësisht në vlerat 200.000 lekë dhe 300.000 lekë me të ardhura të ligjshme; (ii) mobilje të përdorura në vlerën 800.000 lekë, blerë gjatë bashkëjetesës në vitin 2015, për të cilat ka kryer deklarime të sakta dhe ka pasur burime financiare me të ardhura të ligjshme nga pagat dhe kredi bankare.

- Nuk u evidentuan deklarime të ndryshme apo kontradiktore të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Përkundrazi, deklarimet e saj kanë qenë në përputhje dhe koherencë të plotë me deklarimet ndër vite, deklarimet pranë ILDKPKI-së në procesverbalin e vitit 2016, si dhe me dokumentet shkresore të administruara.

- Të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. E. Sh., të përfituara përpara bashkëjetesës me subjektin (një pjesë e të cilave janë përfitur me trashëgimi ligjore), si dhe të ardhurat e deklaruara prej tij, nuk u evidentuan të jenë me kontribute apo pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit dhe në asnjë rast nuk u evidentuan lidhje të drejtpërdrejta ose jo të subjektit të rivlerësimit.

- Nuk u vërtetua dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm për ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe të drejta reale të pronësisë, të rrjedhura nga marrëdhënie juridike të cilitdo lloji të parashikuara nga Kodi Civil, të përfituara nga subjekti dhe/ose z. Sh., të ndryshme nga ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

- Kodi i Familjes, në nenin 74 të tij, parashikon që vetëm pasuritë e fituara gjatë martesës ligjore i nënshtrohen regjimit pasuror të bashkëshorteve, si rrjedhim, pasuritë e vëna veç e veç nga dy bashkëjetues janë 100 % në pronësi të tyre. Pavarësisht këtij fakti, si ligji nr. 84/2016 ashtu edhe neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kanë parashikuar detyrimin e subjekteve të rivlerësimit që të deklarojnë pasuri e interesa private edhe të bashkëjetuesit. Ky parashikim ligjor është bërë pikërisht me qëllim që nëpërmjet deklarimeve periodike dhe nëpërmjet procesit të rivlerësimit, të konstatohen ndikime të paligjshme të subjekteve të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksioneve të tyre në krijimin e pasurive në emër të bashkëshortëve/bashkëjetuesve apo pasurive në bashkëpronësi me ata, ligjshmëria e të cilave vihet në dyshim, duke evidentuar fshehjen e çdo lloj pasurie e deklarime të rremë, të cilat në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan, ashtu sikurse nuk rezultoi që ajo të gjendej në kushtet e konfliktit të interesit.

- Është e vërtetë se subjekti duhet të ishte treguar e kujdesshme në deklaratimet e ish-bashkëjetuesit/bashkëshortit për të qenë korrekte dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Por, pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e z. Sh. për pasuri të krijuara përpara bashkëjetesës me subjektin dhe mungesa e të ardhurave të ligjshme të tij për të justifikuar likuiditetin *cash* prej 10.000 euro, vlerësuar me objektivitet dhe në proporcion me të gjitha faktet e rrethanat arsyetuar hollësisht në këtë vendim, nuk mund të konsiderohen si deklaratime të pamjaftueshme të subjektit, të tilla që të kenë sjellë pasoja të parashikuara nga neni 33 i ligjit nr. 4/2016 apo të kenë cenuar besimin e publikut te zonja Kareçi, si pjesë e sistemit të drejtësisë, ashtu sikurse edhe Kolegji ka cituar në vendimin nr. 17, datë 27.5.2022: *“Parashikimi kushtetues i nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës e lidh gjithmonë defektin në deklaratime me përpjekje për të fshehur apo mos deklaruar saktë, që do të thotë se duhet të ekzistojë një qëllim për të defektuar deklaratimin¹¹²”*.

- Komisioni u njoh me rrethanat që kanë çuar në zgjidhjen e martesës së subjektit me z.Sh. apo rrethana që tregojnë komunikimin e vështirë midis tyre, të cilat vlerësohet se kanë ndikuar në kryerjen e deklaratimeve të paqarta e të padokumentuara nga e z. Sh., si dhe në mosdhënien e përgjigjeve shteruese të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.

- Nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit me të gjithë shtetasit e deklaruar nga ana e z. Sh. në cilësinë e shitësve, blerësve, huadhënësve, huamarrësve, etj., si udhëtime në sistemin *TIMS*, raste të konfliktit të interesit me këta shtetas gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe, për asnjë prej tyre nuk u evidentua përfshirje në veprimtari kriminale.

- Nuk ka pasur asnjë të dhënë qoftë nga organet ligjzbatuese, qoftë nga mediat *online* a të dhëna publike të çdo lloji, në lidhje me veprimtari korruptive të subjektit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- Ndaj subjektit ka pasur vetëm pesë denoncime nga publiku, pretendimet e të cilave nuk qëndronin.

VII. KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Elsa Kareçi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës

¹¹²Shihni paragrafin 19.3 të këtij vendimi.

1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elsa Kareçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli